

**UNIVERSITETI I EJL
ЈНЕ УНІВЕРЗИТЕТ
SEE UNIVERSITY**



**UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
FAKULTETI I BIZNESIT DHE EKONOMISË
MASTER – KONTABILITET DHE FINANCA**

PUNIM MAGJISTRATURE

TEMA:

**“EFEKTET E PËRKRAHJES FINANCIARE TË BE-SË (IPA) PËR
REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, ANALIZË KRAHASUESE ME
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËN E KOSOVËS”**

Mentori:

Prof. dr. NASIR SELIMI

Kandidati:

BEDIJA RAMADANI

Tetovë, 2020

Titulli punues i temës:

“EFEKTET E PËRKRAHJES FINANCIARE TË BE-SË (IPA) PËR REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, ANALIZË KRAHASUESE ME REPUBLIKËN E SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËN E KOSOVËS”

Përkthimi i titullit punues në maqedonisht:

“EFEКТИТЕ НА ФИНАНСИСКАТА ПОДРШКА НА ЕУ (ИПА) ЗА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА, КОМПАРАТИВНА АНАЛИЗА СО АЛБАНИЈА И КОСОВО”

Mentori: NASIR SELIMI

Kandidatja: BEDIJA RAMADANI

ABSTRAKTI

Ky punim shkencor i përgatitur në nivel të punimit të magistraturës ka për qëllim që të hulumtojë ndikimin financiar të fondeve të BE-së në zhvillimin ekonomik të Maqedonisë së Veriut, krahasimin dhe matjen e rezultateve financiar të fondeve të BE-së me Shqipërinë, avancimin e politikave financiare si dhe arritjen e përfundimeve për përmirësimin e politikave financiare, që do të kenë në të ardhmen fondet e Bashkimit Evropian - Instrumentet e Para-anëtarësimit (IPA), si mekanizmi kryesor i BE-së për rritjen e kapaciteteve publike, ekonomike dhe shoqërore për vendet candidate dhe aspirante për anëtarësim në BE.

IPA është një instrument financiar i krijuar nga BE-ja me të vetmin synim, të ndihmojë vendet që janë në procesin e anëtarësimit në BE. IPA ka filluar të funksionojë në vitin 2007 dhe do të vazhdon të funksionoj deri sa vendet e Ballkanit Perëndimor të bëhen pjesë e BE-së. Para krijimit të IPA, BE-ja ka përdorur disa programe siç: PHARE, ISPA, SAPARD dhe CARDS për t'i ndihmuar vendet anëtare dhe candidate për anëtarësim në BE.

Këtu kemi të bëjmë me një studim dhe analizë të ndihmës që ofrohet në kuadër të dokumenteve të cilat rregullojnë marrëdhëniet e një vendi me Komisionin Evropian, kryesisht Partneriteteve Evropiane për vendet candidate potenciale dhe Partneriteteve të Anëtarësimit për vendet candidate. Dimë se edhe shteti jonë është para anëtarësimit andaj një temë e tillë do të paraqiste një interes të veçantë studimor, një analizë të mirëfilltë financiare dhe krahasuese me shtetet përreth që në fakt ndajnë një fat të ngjashëm ekonomik.

Çështja e aftësisë së një shteti për të përfituar mbështetje financiare prej Bashkimit Evropian është një çështje e hapur jo vetëm e shteteve të cilat janë tashmë anëtare të Unionit, por kjo është veçanërisht e rëndësishme edhe për vendet që janë candidate për anëtarësim në këtë familje evropiane. Maqedonia e Veriut si vend kandidat i BE-së në periudhën e kaluar kishte qasje në Fondet financiare evropiane, por përvoja e deritanishme e ka treguar se shteti ynë nuk ka aftësi të mjaftueshme thithëse për t'i përdorur ato në mënyrë efektive.

Qëllimi i kësaj temë të magistraturës është shqyrtimi i kriterëve dhe masave për të përforcuar kapacitetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në përdorimin sa më efektiv të fondeve strukturore të BE-së; të identifikojmë aftësitë e nevojshme që duhet të zotërojë shteti ynë për fondet evropiane dhe mundësitë e krijimit të mekanizmave institucionale për menaxhim financiar me projekte të IPA-s. Prandaj, përgjatë punimit dhe hulumtimit do të përcaktojmë situatën reale të përdorimit të ndihmës evropiane si një kriter para-pranues dhe para anëtarësues

për Republikën e Maqedonisë së Veriut. Përgjatë punimit do të shohim dhe në çfarë niveli është kapaciteti i Maqedonisë si një vend kandidat për në BE për të thithur këto fonde. Kjo pjesë studimore do të hulumtohet brenda marrëdhënies që ka shteti ynë me programimin e fondeve Evropiane, menaxhimin dhe zbatimin e strukturave financiare të këtyre fondeve dhe Fondet e kohezionit të BE-së: Fondi Evropian për Zhvillimin Rajonal, Fondi i Kohezionit dhe Fondi Social Evropian.

HYRJE DHE QASJA TEORIKE

Vendet e Ballkanit Perëndimorë, ose shpesh të quajtura si shtete të Evropës juglindore, janë brenda një ekonomie financiare në tranzicion, me një gjendje ekonomike dhe financiare të ngjashme në varësi të regjimeve politike që kanë shtetet. Janë fatet e ngjashme politike që lidhen me situatat dhe historitë e përbashkëta të shteteve ballkanike. Studimet e fushës së financave sugjerojnë se, pikërisht tranzicioni ka qenë një ndër kushtet e para që kanë ndikimin kryesor në progresin ekonomik dhe financiar të shteteve. Më pas, varësisht kohës dhe pjekjes së kushteve politike dhe financiare, varësisht rimëkëmbjes financiare të shteteve të dala nga luftërat, mund të themi se gjithçka varet kryesisht nga politikat e ndjekura dhe nga reformat e ndërmarra.

Në bazë të karakteristikave të përafërta, qoftë politike dhe ekonomike, ky studim synon të veçojë në analizë disa nga vendet e Ballkanit Perëndimor, fillimisht duke u ndalur në Maqedoninë e Veriut, pastaj në Shqipëri dhe Kosovë.

Transformimi i vendeve të Evropës Juglindore nga shtete me ekonomi të centralizuara dhe planifikim qendror në ekonomi të tregut, ka qenë dhe mbetet një sfidë e madhe për politikëbërësit në këto vende të sapo dala nga tranzicioni si dhe për komunitetin ndërkombëtar të përfshirë në financimin dhe monitorimin e programeve të tyre ekonomike.

Në kuadër të këtij studimi, një syth i veçantë studimor do të dedikohet sektorit financiar dhe reformat e ndërmarra në të, duke marrë për analizë Maqedoninë e Veriut, Shqipërinë dhe Kosovën. Në fokus të veçantë të kësaj pjese të rëndësishme studimi krahasues do të analizojmë shumat e fondeve përgjatë kohës dhe periudhave të caktuara për sektorë të paracaktuar.

Për ta prezantuar të veçantën e kësaj teme të magjistraturës, fillimisht kemi dhënë një përmbledhje të punës që bën Bashkimi Evropian në RMV-në, ky përshkrim nuk është vetëm teorik por i plotësuar me tabela ku shihet qartë fotografia financiare. Në këtë vijë përmes elementeve dhe grafikoneve do jepet edhe imazhi i qartë financiar që na tregon se sa e

rëndësishme ka qenë për shtetin tonë ndihma financiare e BE-së dhe aleatëve të saj, sa shumë ka fituar shteti jonë por edhe sa janë efektet financiare në shtet, dhe në fund do sqarohet se si qëndrojnë këto statistika me shtetin e Shqipërisë dhe Kosovës, shtete më të cilët ndajmë fatin e ngjashëm të problemeve financiare.

Dimë se Bashkimi Evropian ka qenë pjesë integrale e përpjekjeve ndërkombëtare për ndërtimin e një të ardhmeje të re për Maqedoninë e Veriut si shtet kandidat dhe si i tillë ka qenë përherë një dorë e shtrirë për ndihmesa të llojllojshme.

Bashkimi Evropian – shtetet anëtare dhe institucionet e tij, veçanërisht Komisioni Evropian – që nga viti 1991, kanë luajtur një rol të rëndësishëm në rindërtimin dhe zhvillimin e Maqedonisë së Veriut në aspektin financiar duke i ofruar ndihma të llojllojta. Bashkimi Evropian është donatori më i madh që i ofron ndihmë shtetit tonë dhe rajonit të Evropës Juglindore në tërësi, si dhe udhëheq përpjekjet e rindërtimit dhe rimëkëmbjes financiare për gjitha shtetet që synojnë në të ardhmen të jenë pjesë e familjes së madhe evropiane.

Sipas Zyrës së Komisionit Evropian në Shkup, RMV-ja ka marrë mbi €70 milionë nga BE-ja në vitin 2020, si ndihmë për tejkalimin e krizës së rënduar financiare¹. Nga kjo shumë 2.9 milion për bashkëpunim kufitar mes Maqedonisë Veriut dhe Shqipërisë. Këto fonde mund të shfrytëzohen nga organizata si komuna, ndërmarrje publike, ndërmarrje të vogla dhe të mesme dhe organizata joqeveritare për projekte, me të cilat do të stimulohet zhvillim më i balancuar, inkluziv dhe i qëndrueshëm ekonomik-social në sferat tejkuftare të të dy vendeve.² Për ilustrim do të paraqesim tabelën nr. 1 e cila paraqet numrin e subjekteve aktive të biznesit sipas sektorëve në RMV, për vitin 2012 por që publikimi i të dhënave është bërë në vitin 2013.

AKTIVITET SIPAS SEKTORËVE	nr	%	Numri bizneseve në bazë personave					
Totali	71290	100	4415	60599	2989	1787	1291	250+
Agrokulturë	2866	4	158	2608	35	30	33	2

¹ Shin linkun: <https://www.gazeta-shqip.com/2020/04/07/me-ne-fund-nje-lajm-i-mire-shqiperia-dhe-maqedonia-e-veriut-drejt-anetaresimit-ne-be/>

² Në konferencën për shtyp me rastin e promovimit të thirtjes së parë për propozime për shfrytëzim të këtyre mjeteve, ambasadori i BE-së, Samuel Zhbogar theksoi se Programi përmban tre prioritete edhe atë turizëm dhe kulturë, përforsim i mundësive për konkurrencë dhe mbrojtje të mjedisit jetësor, burimi: agjencia e lajmeve INA, shikuar më 03.11. 2020

Xehe	164	0.2	9	106	25	16	4	4
Prodhim	7918	11.1	371	6004	666	468	347	62
Gas, rrymë elektrike	132	0.2	21	93	4	4	7	3
Furnizim me ujë	306	0.4	16	211	21	22	27	9
Ndërtim	4322	6.4	191	3595	287	166	75	5
Shitja me shumicë dhe pakicë	25429	35.5	765	765	23273	820	341	115
Transport	6095	8.5	80	5623	24	100	100	44
Ushqim	4482	6.3	138	3918	300	102	27	25
Informim	1446	2	209	1081	87	87	37	25
Financa aktivitete të sigurimeve	390	0.5	58	273	11	19	17	17

Burimi: SSO 2012, i publikuar në vitin 2013³


Nëse ndihmat në fillim ishin të përqendruara në aksione emergjente dhe rindërtim, tani këto ndihma përqendrohen kryesisht në mbikëqyrjen e Maqedonisë së Veriut në ndërtimin e institucioneve të qëndrueshme dhe zhvillimit stabil ekonomik për një të ardhme të sigurt Evropiane. Janë 17 shtetet anëtare të BE-s vazhdojnë të kenë përfaqësitë e tyre në Maqedoninë e Veriut dhe disa organizata joqeveritare nga shtetet e BE-së janë aktive në vend. Kjo përbën sigurimin e stabilitetin ekonomik dhe financiar të shtetit.

BE e ka përsëritur (së fundmi në Këshillin Evropian në dhjetor 2012) që RMV-ja ka një perspektivë të qartë evropiane së bashku me të gjitha shtetet e Ballkanit. Komisioni Evropian thotë se BE-ja mbetet e vendosur të luajë rolin udhëheqës në sigurimin e stabilitetit të RMV-së përmes misionit për sundimin e ligjit në kuadër të Politikës së Sigurimit dhe Mbrojtjes Evropiane (ESDP), përmes Përfaqësuesit Special dhe zyrat të posaçme për projektet dhe menaxhim financiar të fondeve. Komisioni Evropian potencon se e përcjell Maqedoninë e Veriut në përpjekjen e saj për reforma evropiane dhe ofron ndihmë dhe rekomandime për të arritur synimet që Këshilli i BE-së ka caktuar në Partneritetin Evropian për Maqedoninë e Veriut. Nga programi IPARD Maqedonia e Veriut mund të fitojë deri 25 milionë euro në vit. Megjithatë kjo varet nga aftësitë thithëse dhe stafi i kualifikuar për të konkurruar në këto projekte dhe për ti zbatuar në mënyrë sa më efektive këto fonde. Nëse analizojmë raportin e buxhetit të sapo përfunduar të Ministrisë së financave të Republikës së Maqedonisë Veriut, na del se 49% e buxhetit të saj për muajin Shator 2020 mbushet nga donacionet: ja burimi: Realizmi i buxhetit për vitin 2020⁴

³ https://ipard.gov.mk/ep-content/uploads/2019/08/IPARD-Programme-2014-2020_08.08.2019_EN.pdf, f.19

⁴ <https://finance.gov.mk/sq>, Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut (Buxheti qendror dhe Buxhetet e fondeve, për muajin shtator 2020)

Donacione të huaja	5,54	5,54	5,15	29	16	13	31	49	23	36	13	19	2,34	45.49
	1	1	9	9	8	7	7	7	3	9	4	3	7	%



Grafikoni sipas përqindjes

Sipas Komisionit Evropian IPA është një instrument fleksibil i cili përdoret për të ndihmuar vendet që aspirojnë anëtarësimin në BE gjithnjë duke nënkuptuar që masat të cilat financohen nga IPA janë pjesë e një kornize rajonale, ndërkufitare, ndërshtetërore dhe ndërkombëtare.

Gjatë trajtimit të kësaj teme paraprakisht janë hulumtuar edhe efektet financiare të IPA-s në pesë komponentët e saj kryesor:

1. *Përkrahjen gjatë tranzicionit dhe ndërtimin e institucioneve;*
2. *Bashkëpunimin ndërkufitar;*
3. *Zhvillimin Rajonal;*
4. *Zhvillimin e burimeve njerëzore*
5. *Zhvillimin Rural*

Pjesë e hulumtimit do të jetë edhe ndihmesa përmes IPA-s që bazohet në planifikimin strategjik shumëvjeçar e cila përfshinë Kornizën Indikative Financiare Shumëvjeçare - dokument ky që përcakton shumën të cilën Komisioni Evropian synon ta shpenzojë në një vend për një periudhë të caktuar si dhe fushat prioritare në të cilat alokohen fondet e IPA-s. Po ashtu, do të hulumtohet edhe planifikimi strategjik i cili bëhet përmes programeve që mund të jenë vjetore ose shumëvjeçare.

Ndihma nga IPA, përpos tjerash, ndahet në formë investimi, subvencioni, bashkëpunimi administrativ, pjesëmarrje në programet e BE-së dhe ndihmës buxhetore. Kjo e fundit ndahet në raste të rralla dhe i nënshtrohet mbikëqyrjes.

Pjesë e hulumtimit do të jetë edhe ndikimi në zhvillimin e Maqedonisë së Veriut, Shqipërisë dhe Kosovës, alokimi i fondeve të IPA-s, i cili për çdo vjet zhvillohet nga një cikël i programimit të IPA-s, gjatë të cilit përcaktohen projektet të cilat do të financohen përmes këtij instrumenti.

Esenca e këtij studimi do të jetë përdorimi i metodave të krahasimit të rezultateve të fondeve IPA në Maqedoninë e Veriut, Kosovë dhe Shqipëri, si dhe nxjerrja e pikave të forta dhe dobësive. Gjithmonë duke pasur qëllim aspektin financiar e jo atë diplomatik.

Realizimi dhe menaxhimi i programeve të IPA-s mvaret nga kapacitetet e një vendi për zbatim. Në Maqedoni, institucioni që kryen menaxhimin e programeve të IPA-s është Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian, prandaj puna e Zyrës së KE-së ka një vend me rëndësi në këtë hulumtim.

Meqenëse nga Bashkimi Evropian është konstatuar se rendi dhe ligji janë sektorët në Maqedoni me më së shumti ngecje, atëherë edhe fondet e IPA-s për Maqedoninë e Veriut përqendrohen në fushën e sundimit të ligjit që përfshin në përgjithësi organet e rendit sikurse policinë dhe gjykatat, reformën e administratës publike, por edhe zhvillimin ekonomik. Këto fusha prioritare janë përcaktuar në Dokumentin Indikativ Planifikues Shumëvjeçar, i cili njëherësh është edhe dokumenti kryesor referues për projektet e IPA-s. Kjo pikë ndërlidhet kryekëput me Grupin Kërkimor: Përfaqësive të shteteve anëtare të BE-së (ambasadave dhe zyrave ndërlidhëse) Pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës, Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian, së bashku me mandatin e PSBE janë bashkuar në Zyrën e Bashkimit Evropian në RMV. Para shkrirjes në Zyrën e Bashkimit Evropian në RMV, Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian ka funksionuar që herët.

Zyra e BE-së luan një rol esencial në përmbushjen e agjendës evropiane në RMV me qëllim që të promovojë RMV-në drejt përafritit me Bashkimin Evropian. Duke qenë pjesë integrale e Shërbimit Evropian për Veprim të Jashtëm si dhe e përfaqësimit të Komisionit Evropian me seli në Shkup, zyra siguron se dialogu i përhershëm politik dhe teknik mbështetet nga institucionet në Bruksel.

Me që studimi është krahasues, duhet të theksojmë se pas Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë, në rastin e shtetit më të ri në Ballkan, në Kosovë, Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) është misioni më i madh civil i ndërmarrë ndonjëherë nën platformën e Politikës së Sigurisë dhe Mbrojtjes Evropiane. Ky është një instrument matës i

ndihmesës financiare që merr ky shtet nga BE-ja. Këto ndihmesa financiare, kanë për qëllim kryesor ndihmën dhe përkrahjen e autoriteteteve në Maqedoninë e Veriut dhe shteteve përreth në sundimin e ligjit, veçanërisht në polici, drejtësi dhe dogana. Nëse në Kosovë EULEX-i është një mision teknik i cili monitoron dhe këshillon, ndërkohë që mban edhe disa funksione ekzekutive të kufizuara, Maqedonia e Veriut ka institucionet e shtetit të krijuara nga qeveria me drejtor të emëruar po nga qeveria për të realizuar platformat e politikave financiare që janë miratuar në programet e partive politike gjatë fushatave.

Shqipëri, sa për ilustrim kemi situatë tjetër, realisht njeh mirëfilli efektin e ndihmave financiare përmes fondeve IPA dhe ka një përparësi të madhe, sepse ka detin dhe turizmin e zhvilluar. Këto janë dhe kritere të forta për një balancë të fuqishme ekonomike dhe financiare, për një stabilitet të qëndrueshëm ekonomik. Këto dy kritere mund të krijojnë hapësira për thithje të fondeve dhe ndihmesave tjera nga BE-ja në fushën e turizmit, mund që fondet të delegohen në këto dy sfera të rëndësishme të ekonomisë së Shqipërisë, IPA fondet dhe ndihmesat tjera nga BE-ja mund të jenë të mirëseardhur edhe në doganat dhe portet detare. Jo rastësisht thuhet se Shqipëria jeton nga deti - turizmi.

SHTRIMI I PROBLEMIT

Maqedonia e Veriut përdor transfere të mëdha fiskale në planin nacional dhe rajonal me qëllim të inkurajimit financiar ekonomik dhe kohezionit shoqëror. Në vendet anëtare të BE-së, fondet përbëjnë pjesën më të madhe të shpenzimeve financiare të BE-së. Të dhënat që vijnë nga ky sektor, pra nga kjo zonë tregon rëndësinë e çështjeve që lidhen me thithjen e fondeve në rastin tonë të studimit IPA - fondet. Kapaciteti i thithjes është shumë i rëndësishëm për mirëqenien financiare të një vendi për të marrë ndihmë nga fondet evropiane dhe e njëjta gjë për ta përdorur atë në mënyrë efektive. Vendet në zhvillim dhe me demokraci të brishtë siç është edhe Maqedonia e Veriut, shpesh nuk kanë mjaft aftësi thithëse, kapacitete për të konkurruar dhe fituar në këto konkurse fondesh të mëdha, ku kjo sferë është e lënë anësh, pa trajnues financiar dhe pa konkurrim serioz në këtë fushë, ose kemi improvizime.

Në këtë punim të masterit hulumtimi përqendrohet edhe në faktorët që ndikojnë në thithjen e dobët të fondeve evropiane në Republikën e Maqedonisë Veriut. Veçanërisht në kushtet e krizës aktuale ekonomike dhe financiare. Këto aktivitete janë të propozuara për të përmirësuar aftësinë për të përthithur këto fonde dhe rritjen e efektit të klimës pozitive gjatë

marrjes së fondeve. Fondet strukturore të BE-së dhe më herët por dhe në të tashmen përbëjnë një investim në nivele shtetesh dhe janë përmirësuesit e mëdhenj të situatave të rënuara financiare të shteteve aplikuese në to. Investimi në sektorin financiar zakonisht njihet si një prej tyre ose thënë më mirë si nxitësi më i rëndësishëm i rritjes dhe përmirësimit ekonomik të vendit aplikues.

Kushtet e krijuara politike edhe për zgjidhjen e kësaj çështjeje, perspektivat e kushteve të tjera ekonomike, të sigurisë dhe të qëndrueshme të shtetit ngriti më tej pyetjen se si të zgjidhet problemi me kapacitetin e pamjaftueshëm të absorbimit të RMV-së për përdorimin e fondeve të BE-së. Pikërisht për shkak të kësaj, në këtë punim kërkimor kemi përqendruar vëmendjen tonë në pyetjen se çfarë niveli është kapaciteti ekzistues për të shfrytëzuar kërkesat për mjetet financiare dhe si t'i zgjidhim problemet ekzistuese?

Kjo do të thotë që vendet duhet të zbatojnë në mënyrë thelbësore reformat ekonomike, politike dhe sociale. Kriteret, të cilat BE-ja i kërkon dhe vendet anëtare ose kandidatë duhet t'i plotësojnë ato, më shumë ndjekin agjendën evropiane sesa përparësitë lokale të vendeve. BE-ja përcakton përparësitë në mënyrë që të çojë në funksionimin dhe rregullimi i një ekonomie të hapur.⁵

Prandaj, forcimi i kërkimit në institucionet arsimore dhe trajnuese janë shumë të rëndësishme në përmirësimin e kapacitetit thithës të një vendi. Mundësia e përdorimit të fondeve evropiane varet gjithashtu edhe nga shkalla e ndërgjegjësimit për mundësitë dhe mënyrën e përdorimit të fondeve financiare evropiane, të cilat lidhen në mënyrë të pashmangshme edhe me nivelin politik të shtetit, kapacitetin institucional, arsimor dhe menaxherial në vendet që realisht janë anëtare të BE-së ose vende kandidatë.

Sa për ilustrim nën statusin e Vendet Kandidat Potencial, Shqipëria ka përfituar nga Komponenti I dhe II i IPA-s, një total prej afërsisht 594 milion euro.⁶ Si rezultat i programimit nën komponentin IPA TAIB, Qeveria Shqiptare ka nënshkruar me Komisionin Evropian (KE) marrëveshjet vjetore përkatëse për çdo vit programues, duke i hapur rrugën zbatimit të 101 projekteve kombëtare (shiko tabelën 1), që adresojnë kriteret ekonomike, politike dhe standardet evropiane dhe bashkëpunimin rajonal. Mbështetja me fondet IPA kishte si qëllim të përgatiste vendet kandidatë potenciale dhe ato kandidatë të Ballkanit Perëndimor në menaxhimin e fondeve të ardhshme strukturore dhe ato të kohezionit, njëherë që ato bëheshin vende anëtare. Fondet janë

⁵ Pridham G. „Projektimi i Demokracisë: Zgjerimi i BE dhe ndryshimi i Regjimit në Evropën Post Komuniste”, *Designing Democracy: EU Enlargement and Regime change in Post Communist Europe*, (2005)

⁶ <http://www.eupolicyhub.eu/>, shikuar 3.10.2020

dhënë në bazë të koherencës me politikat e BE-së dhe në mbështetje të përafrimit të legjislacionit të Bashkimit Evropian.

Kjo tezë e modeste në nivel të magjistraturës do të merret pikërisht me këtë problematikë, do të analizojë dhe mat efektet e përkrahjes financiare të BE-së në Maqedoninë e Veriut, si dhe do të vjen në përfundime se çka do të duhet të përmirësohet në këtë proces, pasi që përkrahja financiare nga BE-ja do të vazhdojë derisa vendet e Ballkanit, respektivisht Maqedonia e Veriut, Kosova dhe Shqipëria të anëtarësohen në BE. Qëllimi i BE-së është të financojë disa projekte evropiane për të kontribuar në zvogëlimin e ndryshimeve në zhvillim ndërmjet rajoneve individuale dhe në këtë mënyrë forcojnë ekonominë dhe kohezionin shoqëror. Prandaj mundësitë për zhvillim ekonomik të Republikës së Maqedonisë së Veriut janë në përpjesëtim të drejtë me kapacitetin e tij thithës për përdorimi i fondeve evropiane. Ky hulumtim duhet identifikon masat dhe aktivitetet kryesore që ndikojnë në forcimin e Kapaciteti thithës të Maqedonisë së Veriut.

Për këtë arsye nëpërmes këtij punimi do të synohet që të arrihet një vlerësim empirik nëse ndihma e BE-së për RMV-në, Kosovën dhe Shqipërinë ka dhënë rezultatet e pritura dhe cilat procese duhet të përmirësohen.

Fjalë kyçe: fonde strukturore dhe kohezive, thithje e financave, aftësia thithëse, aftësia institucionale dhe menaxheriale, arsimi dhe trajnimi.

QËLLIMI I STUDIMIT

Qëllimi i parë është që nëpërmes hulumtimit të të dhënave të BE-së, për Maqedoninë e Veriut, Shqipërinë dhe Kosovës, të arrihet në përfundim për shumën e investuar dhe efektin e investimeve të BE-së në ekonominë, administratë publike, sektorin privat dhe rritjen e kapaciteteve teknike në përgjithësi.

Qëllimi i dytë do të jetë që të identifikohet të maten përparësitë dhe ngecjet gjatë realizimit të fondeve të BE-së në Maqedoninë e Veriut, Kosovë dhe Shqipëri.

Qëllimi i tretë do të jetë i bazuar në të gjeturat e dy objektivave të para të bëhen sugjerime konkrete për Brukselin, Shkupin, Prishtinën dhe Tiranën, që të rriten efektet e IPA II, shuma e të cilave do të jetë rreth 2.9 miliardë euro për gjithë rajonin.

Qëllimi i katërt i këtij studimi do të jetë dhënia e kontributit që shtetet përreth Maqedonisë së Veriut, Kosova dhe Shqipëria të përfitojnë sa më shumë nga IPA II, pasi që nga shuma totale 2.9 miliardë euro, ekziston një konkurrencë ndërmjet vendeve të rajonit për të përfituar nga këto фонде.

HIPOTEZA / HIPOTEZAT E PUNIMIT

Hipoteza e përgjithshme është se nëse ekziston përfaqësimi i faktorëve administrativ dhe menaxherial me kusht që zhvillimi i kapacitetit arsimor, institucional dhe menaxherial, atëherë ekziston ndikim pozitiv në forcimin e kapacitetit për të përdorur fondet e BE-së, që do të thotë: shkalla e ndërgjegjësimit për mundësitë dhe njohuritë e nevojshme për të përdorur fondet e BE-së.

Hipoteza lidhur më punim ka dy variabla: **e para** do të merret kryesisht me reformën dhe realizmin e ndihmës financiare në sektorët ekonomikë, dhe **e dyta** do të merret shumën e mjeteve financuara të fituara si ndihmëse financuara nga IPA.

Hipoteza 1: Ndihma financiare për Maqedoninë e Veriut nga Bashkimi Evropian nëpërmes Fondeve të para-anëtarësimit a ka dhënë efekte të mjaftueshme në zhvillimin ekonomik, reforma publike, rritje të financave dhe përmirësime të mirëqenies ekonomike dhe financiare të shtetit dhe qytetarit?

PYETJET KERKIMORE TE PUNIMIT

1. Cilat kanë qenë efektet e mbështetjes financiare dhe teknike të BE-së për Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë? Si ndikojnë ato në mirëqenien ekonomike të qytetareve?
2. Bazuar në praktikat e deritanishme çka duhet përmirësuar për të rritur efektet e fondeve të BE-së?
3. Bazuar në praktikat e deritanishme dhe ato nga vendet e rajonit, çka duhet të ndryshojnë Kosova dhe Shqipëria për të përfituar më tepër nga Fondet e IPA në vlerë 2.9 miliardë euro të dedikuara për rajonin?

METODAT DHE METODOLOGJIA E KËRKIMIT

Metodologjia i takon tipit të përzier të hulumtimit sasior dhe cilësor, ndërsa metoda e kërkimit shkencor do të jetë metoda statistikore dhe ajo përshkruese e hulumtimit.

Përmes këtij studimi dhe hulumtimi, do të analizoj dhe vlerësoj marrëdhëniet apo ndërlidhjen në mes Maqedonisë së Veriut, Kosovës dhe Shqipërisë me Bashkimin Evropian dhe efektet e përkrahjes financiare. Këto shtete kanë fat të ngjajshëm ekonomik dhe financiar.

Do të analizohet edhe struktura e investimeve në aspekt të financave hyrje - daljet, përmirësimi i kapaciteteve teknike financiare dhe humane si rezultat i fondeve të investuara, ndërsa do të arrihet deri te përfundimi cilat kanë qenë pikat e forta dhe mangësitë në rezultatet e pritura.

Pjesëmarrësit dhe mostra: Do të merren në Maqedoninë e Veriut dhe do analizohet më ato të Kosovës dhe Shqipërisë të cilat tashmë i kemi siguruar në forme librave dhe studimeve të ngjashme shkencore.

Instrumentet: Të dhënat sasiore do të mblidhen nëpërmjet pyetësorëve, ndërsa ato cilësore nëpërmjet intervistimit të aktorëve kryesorë në Maqedoninë e Veriut, duke përfshirë edhe prezencën e BE-së në këto tri shtete më shumë nevojë për përkrahje financiare.

Analiza e të dhënave: Analizimin e pyetësorëve do ta bëj përmes programit SPSS, duke përdorur metodën e korrelacionit për të gjetur ndërlidhjet në mes fondeve të investuara dhe efekteve që janë arritur, kurse ato cilësore nëpërmjet analizës tematike. Në këtë tezë të magjistraturës janë përdorur metodat empirike, grumbullimin e materialit, analizimin, strukturimin dhe përpilimin e tezës së magjistraturës.

Para fillimit të punimit të kësaj teze kemi siguruar qasje në thesarin informativ të BE-së, www.europa.eu nëpërmes një *user-i* të siguruar në Zyrën e Komisionit Evropian në Shkup. Ky thesar i të dhënave për BE-në ka qenë burimi kryesor për grumbullimin e materialeve për analizimin dhe shkrimin e kësaj teze. Burim tjetër i të dhënave kanë qenë edhe këto institucione: Zyra ndërlidhëse e BE-së në RMV, Shqipëri dhe Kosovës, Ministria e Financave e tri shteteve, Ministria e Integritimit Evropian, OJQ si mundësi trajnuese dhe shkollë për përgatitjen e projekteve...

MUNDËSITË DHE KUFIZIMET

Ekziston një thesar i madh i të dhënave lidhur me investimet e Bashkimit Evropian në vendet e Ballkanit dhe më konkretisht për Maqedoninë e Veriut, Kosovës dhe Shqipërinë.

Mundësia e përdorimit të fondeve evropiane varet gjithashtu shkalla e ndërgjegjësimit për mundësitë dhe mënyrën e përdorimit

Kapaciteti institucional, arsimor dhe menaxherial në vendet anëtare të BE-së dhe vendet kandidate. Ka me qindra analiza dhe raporte të Bashkimit Evropian për investimet që kanë bërë në RMV dhe Shqipëri dhe qëllimet që kanë pasur për investimin e këtyre fondeve.

Ekzistojnë edhe të dhëna individuale të autorëve të ndryshëm, kryesisht ndërkombëtarë për fondet e BE-së dhe efektin e tyre.

Këto të dhëna nëpërmes kësaj teze në nivel magistrature do të hulumtohen, përpunohen sipas modelit të lartpërmendur dhe të arrihet deri te një përfundim se çka duhet të përmirësohet për të rritur efikasitetin e fondeve të investuara në të ardhmen dhe për të shikuar mënyra për rritjen e përfitimeve nga këto fonde, pasi që ekziston një garë ndërmjet vendeve të rajonit tonë për të përfituar sa më shumë projekte që investohen nga BE-ja.

Kufizimi kryesor do të jetë vëllimi i jashtëzakonshëm i të dhënave të kësaj fushe dhe do të jetë sfida për seleksionimin dhe përdorimin e tyre në këtë punim shkencor.

RËNDËSIA E STUDIMIT

Fondet e Bashkimit Evropian, përkrahja e tillë financiare, ka rëndësi jetike për zhvillimin ekonomik e financiar, reformat për zbatimin efektiv të politikave financiare dhe rritjen e konkurrueshmërisë së sektorit privat në Maqedoninë e Veriut.

Me përparimin në rrugën e anëtarësimit evropian, do të vijë deri te konkurrenca në rritje që vjen nga hapja e tregjeve me Bashkimin Evropian, prandaj ka nevojë për rritje të kapaciteteve të brendshme në ekonomi për të mbijetuar në treg. Fondet e BE-së nëpërmes IPA kanë qëllim prioritar reformat publike dhe rritjen e konkurrencës së brendshme. Do të varet shumë nga mënyra e menaxhimit të këtyre mjeteve për të arritur efektet e pritshme.

Kjo tezë e magistrature synon që të japë kontribut në këtë drejtim, duke i matur efektet e ndihmës financiare, duke i analizuar rezultatet dhe duke dhënë sugjerime konkrete me bazë shkencore për përmirësimin e menaxhimit dhe alokimit të këtyre fondeve, në mënyrë që Kosova dhe Shqipëria të përfitojnë më shumë mjete nga IPA dhe të arrijnë efekte maksimale.

KREU I

1.1 IPA - PROGRAMI DHE PËRKRAHJA FINANCIARE NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Në këtë pjesë të studimit që shënon dhe hyrjen në studim më të thelluar të temës, do të parashtrijmë disa pyetje. A ka dhe në ç' nivel është përkrahja financiare për Maqedoninë e Veriut, Kosovën dhe Shqipërinë? Gjatë gjithë kohës mediet raportojnë se zgjerimi i Bashkimit Evropian ka qenë gjithmonë proces dydrejtësh, sepse duhet kushte e kushte që të plotësohen që ne të jemi pjesë e këtij ekipi bashkë me shtetet tjera që janë anëtare të BE-së. Po cila është gjendja faktike dhe cilat janë format e ndihmesave financiare që jep BE-ja për ne.

Shtetet që janë dhe ato që tentojnë të janë anëtare të reja përfitojnë nga fakti i anëtarësisë në këtë organizatë unike, blloku më i madh tregtar i botës dhe ushtrimi më i avancuar në qeverisjen e përbashkët. BE-ja fiton duke u zgjeruar në territore më të gjëra, duke mirëpritur kultura të reja, dhe duke u lidhur me tregje të reja. Përgjatë viteve të fundit, ky proces dydrejtësh ka marrë një dimension shtesë pasi që BE ka filluar të integrojë vende nga Evropa Qendrore dhe Lindore. Shumë shtete kandidate është dashur të ndërmarrin reforma rrënjësore-ekonomike, politike dhe sociale, për tu kualifikuar për anëtarësim në BE.

Reformat në fushën e sundimit të ligjit, drejtësisë, ekonomisë, financave sjellin përfitime në vendet të cilat i plotësojnë kriteret, por shpesh kërkojnë investime të kushtueshme dhe paraqesin sfida afatshkurta për vendet në rrugën e tyre drejt anëtarësimit. Si përgjigje, BE ka ofruar shumë forma të ndryshme të asistencës në para dhe ekspertizë- për vendet që i marrin detyrat e anëtarësimit.

Kjo ka sjellë një fokus të ri të BE-së për asistencë zgjerimit. Këto të dhëna arrita ti sigurojë nga studimet e deritanishme që janë bërë. Ndërkohë që sipas ekspertëve këto të dhëna janë po të njëjtat me pak ngritje dhe në vitet që pasuan. Shifrat janë të përafërta. Nëse në 2013 ka qenë kjo tabelë në 2020 mund të ketë një ngritje +5% por jo më shumë së çdo vit aplikohet njëjtë me pako të njëjtë. Sipas agjencisë financiare të IPA- për periudhën e poshtëshënuar në total na del kjo e dhënë e paraqitur në tabelën nr.1

Asistenca Financiare e IPA-s (2007-2013) në total

Programi	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Totali i programit të vendeve	1.109.4	1.308.6	1.303.9	1.399.4	1.547.0	1.680.0	1.749.0
Programi për tranzicion	108.9	135.7	166	138.9	173.4	168.8	183.8
Programi për bashkëpunim	0	0	0	4.9	5.2	5.6	6
Mbështetja për shpenzime	44.7	51.9	47.6	52.9	75	80.5	84.5
Totali	1.263.2	1.496.2	1.517.6	1.592.7	1.796.8	1.935.7	2.023.8

Tabela nr1, Burimi, Komisioni Evropian, faqja zyrtare f.9, Bruksel 2011

ASISTENCA FINANCIARE E BE-së nën IPA për 2007-2013 në EUR milione							
	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2007- 2012
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT	58.5	70.2	81.8	92.3	98	105.8	507.3
SHQIPËRIA	61	70.7	81.2	93.2	95	96.9	498
KOSOVA	68.3	184.7	106.1	67.3	68.7	70	565.1
MALI I ZI	31.4	32.6	33.3.	34	34.7	35.4	201.4
SERBIA	189.7	190.9	194.8	198.7	202.7	206.8	1.183.6
MBËSHTETJA PËR SHUMË VENDE	109.3	190.9	194.8	198.7	202.7	206.8	1.183.6
TOTALI	1.218.4	1.444.3	1.463.9	1.557. 1	1.707. 8	1.849. 2	9.240.7

Burimi: nëntor 2008⁷

⁷ http://www.eas.europa.eu/archives/delegations/kosovo/documents/publications/ipa_sq.pdf

1.2 Çka është IPA?

Po çka në fakt është IPA? IPA ofron asistencë në forma të ndryshme për vendet që ndërmarrin reforma politike dhe ekonomike në rrugën e tyre drejt anëtarësimit në BE: investime, kontrata prokurimi apo subvencione; Ekspertë të Shteteve Anëtare për të ndërtuar bashkëpunim administrativ; veprime në mbështetje të vendit përfitues; ndihmë në implementimin dhe menaxhimin e programeve; në raste të jashtëzakonshme, mbështetje buxhetore. Asistenca lidhet me përmirësimin e kushteve në vendet përfituese dhe afrimi i tyre dhe qytetarëve të tyre me BE-në. Në qershor 2007, Komisioni Evropian ka finalizuar planin e parë strategjik të asistencës nën IPA për vitet 2007-2009. Ky ishte i bazuar në nevojat specifike të secilit vend, dhe i ka renditur prioritetet për asistencën financiare. Programi për shumë vende po ashtu mbështetë projektet e përbashkëta rajonale të bashkëpunimit, infrastrukturës, drejtësisë dhe çështjeve të brendshme, tregut të brendshëm dhe tregtisë, ekonomisë së tregut, mbështetjes së shoqërisë civile, arsimimit, rinisë dhe hulumtimit. Planifikimi strategjik freskohet çdo vit.⁸

Studimi jonë mbështetë mbi ndihmesën financiare, efektet e saj në përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe stabilitetin financiar të shtetet. Shtetet e varfra si Maqedonia e Veriut mbijetojnë përmes këtyre ndihmesave. IPA – Instrumenti për Asistencë të Para-Anëtarësimit, është një mekanizëm i bashkëdyzuar i krijuar nga BE-ja, për të ofruar ndihmë në mënyrë efektive Ballkanit Perëndimor ku bën pjesë dhe Maqedonia e Veriut. IPA është dizajnuar në atë mënyrë që t'i plotësojë në mënyrë precize këto nevoja me një instrument të vetëm por fleksibil përmes formularëve të përgatitur me kujdes nga ato dhe për tu plotësuar nga ekspertë të projekteve të tilla.

“Asistenca e ofruar do të përdoret në fushat në vijim: forcimi i institucioneve demokratike, sikur edhe sundimit të ligjit, përfshirë forcimin e tij; promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore dhe respektin e rritur për të drejtat e pakicave, promovimin e barazisë gjinore dhe jo-diskriminimit; reformën e administratës publike; reformën ekonomike; zhvillimin e shoqërisë civile; përfshirjen sociale; pajtimin, masat për ndërtimin e besimit dhe rindërtimin; bashkëpunimin rajonal dhe ndërkufitar.”⁹

⁸ IPA - Instrumenti për Asistencë të Para-Anëtarësimit 3 Fokusi i ri i Asistencës së BE-së për zgjerim, Të dhënat e katalogimit mund të gjenden në fund të këtij publikimi (<http://europa.eu.int/comm/enlargement/>). ISBN-13 978-92-79-11333-8, f.2




⁹ - Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme të BE-së, Bruksel, 17 korrik 2006.

Është shënuar që të përfitojnë qytetarët në mënyrë të drejtpërdrejtë. Projektet që i mbështetë janë të përgatitur në atë mënyrë që vendet candidate t'i afrojnë në linjë me standardet e BE-së. IPA ka hyrë në fuqi në fillim të 2007 , dhe do të ofrojë afërsisht 11.5 miliardë euro për këto vende për vitet 2007-2013. Alokimi për secilin vend për periudhën 2007-2012, është si në vijim të paraqitur në tabelën nr.2.

Asistenca financiare e BE-së nëpërmes IPA 2007-2012 (në EUR)

	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2007-2012
Kroacia	141.2	146	151.2	154.2	157.2	160.4	910.2
Maqedonia	58.5	70.2	81.8	92.3	98.7	105.8	507.3
Shqipëria	61	70.7	81.2	93.2	95	96.9	498
Bosnja dhe Hercegovina	62.1	74.8	89.1	106	108.1	110.2	550.3
Kosova	68.3	184.7	106.1	67.3	68.7	70	565.1
Mali i Zi	31.4	32.6	33.3	34	34.7	35.4	201.4
Serbia	189.7	190.9	194.8	198.7	202.7	206.8	1183.6
Vende të tjera	109	135.7	160	157.7	160.8	164.2	887.4
Totali	1218.4	1444.3	1463.9	1557.1	1707.8	1849.2	9240.7

Tabela nr2 , Tabela Zyra e Komisionit Evropian në Shkup,



Grafikone sipas përqindjes.

Sipas komisionarit të BE-së për Financa, thelbi i çështjes në procesin e zgjerimit të BE-së është në reformat politike, ekonomike dhe institucionale që çojnë në rezultatet në terren, në secilin vend. “Ata duhet të reagojnë në këtë proces sfidues. Por ata nuk janë vetëm. BE qëndron në anën e tyre me mbështetje politike, këshilla teknike dhe asistencë të konsiderueshme financiare për t’iu ndihmuar atyre t’i ndërmarrin këto reforma”.

Karakteristikat kryesore të IPA-s janë disa. Një nga karakteristikat kryesore të IPA-s është se vendet nuk konkurrojnë njëra me tjetrën për fonde të IPA-s. Komisioni Evropian përcakton paraprakisht shumën që e fiton secili vend kandidat ose aspirant. - Fundi i programeve të IPA-s Programi i IPA-s përfundon kur ballkanik dhe shtetet e saja të bëhet anëtare e Bashkimit Evropian. - Alokimi i fondeve Është praktikë evropiane që alokimet e fondeve të IPA-s nuk janë automatike. Secili vend veç e veç duhet të justifikojë dhe shpjegojë se si do t’i shpenzojë të hollat. Informacionet duhet të jenë vënë përpara në procesin e programimit vjetor; procesi i programimit vjetor, duhet të sqarohet në detaje më vonë në këtë dokument. - Ndryshimi i destinacionit të fondeve Është e pamundshme që gjatë zbatimit të programeve të bëhet ndërrimi i destinacionit të fondeve të alokuara nga IPA. Por këtu ka një përjashtim. Nëse është e nevojshme, shumat brenda një programi mund të ndryshohen. Sistemi është fleksibël do të thotë se alokimet mund të rishikohen në bazë vjetore dhe do të merren parasysh sipas vlerësimit të nevojave, kapaciteteve absorbuese, kushteve dhe kapacitetit të menaxhimit, por gjithashtu në përgjigje të kërkesave specifike që mund të ndodhin në periudhën përkatëse, siç mund të jetë ndryshimi në statusin e vendeve përfituese. - Menaxhimi i fondeve të IPA-s Është e përcaktuar shumë qartë mënyra e zbatimit të fondeve të IPA-s.

Si zbatohen këto projektet dhe programe financiare? Kjo pyetje kërkon sqarim me të thellë teorik dhe shkencor.

Programet e IPA-s zbatohen në tri mënyra: të centralizuara, decentralizuara ose të menaxhimit të përbashkët. Qasja e menaxhimit të centralizuar do të thotë se Komisioni ka përgjegjësinë e plotë.

Kjo ka të bëjë menaxhimin e fondeve në emër të vendit përfitues për IPA-në. Në rastin e Maqedonisë së Veriut e kemi Zyrën Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Shkup, si autoritet kontraktues.

Ka kapacitete për programim autonom dhe burime po ashtu edhe njohuri për të gjitha nivelet e menaxhimit të IPA-s. Në këtë situatë Zyra e BE-së bëhet përgjegjëse për kontrollet e nevojshme. Qasja e Menaxhimit të përbashkët është kur ajo përgjegjësi i dorëzohet një organizatë të tretë. Kjo mënyrë është praktikuar më së shumti në Kosovë. P.sh., për ndërtimin e Pallatit të

Drejtësisë në Kosovë, është zgjedhur një kontraktorë për realizimin e punimeve. - Prioritetet e IPA-s Në Maqedoninë e Veriut ndihma e BE-së duke përfshirë edhe projektet e IPA-s përqendrohet në zhvillimin e një Maqedoni të Veriut të qëndrueshme, moderne, demokratike dhe të shoqërisë shumetnike të bazuar në respektimin e të drejtave të njeriut, sundimin e ligjit dhe të interesave të të gjitha komuniteteve. Forcimi i sundimit të ligjit është një nga prioritetet në programin e IPA-s për Maqedoninë e Veriut, së bashku me përkrahjen për procesin e kthimit të refugjatëve nga vendet e BE-së, riintegrimin e tyre dhe mirëmbajtjen e trashëgimisë kulturore. Prioritete të tjera janë ndërtimi i një ambienti ekonomik për të gjitha komunitetet në Maqedoninë e Veriut, infrastruktura rrugore, mbështetje për qeverinë lokale, arsimit, energjisë, sigurinë e ushqimit dhe shërbimeve veterinarë dhe përkrahjen e prokurimit publik.

IPA ofron edhe bursa të BE-së për përmirësimin e aftësive profesionale të shërbimeve publike në Maqedoninë e Veriut përmes ofrimit të arsimit universitar në shtetet anëtare të BE-së. Me fjalë të tjera BE i ka përmbledhur në katër prioritetet aktivitetet e IPA:

Kriteret politike –

Fokusohen në përmbushjen e kriterëve politike të BE, duke përfshirë forcimin e sundimit të ligjit dhe mbështetje për reformën e administratës publike, për komunitetet, kulturë dhe media dhe për të rinjtë dhe sportin.

Kriteret ekonomike-

Fokusohen në çështjet më të gjera sociale-ekonomike, duke përfshirë tregtinë dhe zhvillimin rajonal, arsimin dhe punësimin, mbështetje për administratën tatimore dhe bujqësinë.

Standardet evropiane-

Përqendrohen në ngritjen e kapaciteteve, përafrimin e legjislacionit dhe afrimin me standardet evropiane, të identifikuar në Partneritetin Evropian, duke përfshirë mbështetjen për mjedisin, transportin dhe energjinë.

Aktivitetet mbështetëse-

Ky prioritet është përdorur për të arritur objektivat dhe veprime tjera relevante të përcaktuara në këtë program, duke përfshirë fizibilitetin dhe studimet e tjera, trajnime, seminare, shërbime mbikëqyrëse dhe ndihmë tjetër teknike. Kushtet për përfitimin e fondeve nga IPA janë disa. Ngjashëm me vendet tjera autoritetet në Maqedoninë e Veriut duhet të miratojnë zyrtarisht projekt final të përgatitur si aplikacione për projektet e IPA-s, duke përfshirë angazhimet e bashkëfinancimit paralel. Bashkëfinancimi është një nga elementet kryesore për financim nga IPA. Institucionet e Maqedonisë së Veriut duhet të sigurojnë që institucionet përfituese kanë burime të mjaftueshme për të përdorur mbështetjen financiare të BE-së në mënyrën më efektive

dhe të qëndrueshme. Institucionet përfituese duhet të marrin pjesë në hartimin e dizajnit dhe dokumenteve të tenderit, duke përfshirë termat e referencës, dhe t'i miratojnë zyrtarisht ato para tenderëve. Përfituesit duhet gjithashtu të marrin pjesë në komisionet e përzgjedhjes për prokurim dhe grante. Institucionet e Maqedonisë e Veriut duhet të garantojnë hapësirat e sipërfaqeve të tokës, pa konteste pronësore, në vendin ku do të zbatohet projekti. Ata duhet të sigurojnë qëndrueshmërinë afat-gjate të veprimit duke alokuar burimet e nevojshme, duke përfshirë kostot për shpenzime dhe kostot e mirëmbajtjes. Institucionet përfituese duhet të organizojnë, zgjedhin dhe emërojnë anëtarët e grupeve të punës, drejtuese, monitorimit dhe komitetet e koordinimit dhe seminarët, siç kërkohet nga aktivitetet e projektit (duke siguruar një balancë gjinore dhe etnike). Nëse këto kushte nuk janë plotësuar, autoritetit implementues do të shqyrtojnë pezullimin ose anulimin e projektit apo aktiviteteve të veçanta. Objektivat e IPA-s për kapacitetet administrative janë disa. Një nga objektivat kryesore të IPA-s është forcimi i kapaciteteve administrative për të gjitha vendet përfituese.

Forcimi i kapacitetit administrativ në të vërtetë do të thotë kombinimi i shumë iniciativave të tilla si trajnime, stërvitje, si dhe të mësuarit duke punuar për të siguruar që zyrtarët publik të kuptojnë në tërësi kornizën për anëtarësim në BE. Forcimi i kapaciteteve administrative do të thotë që zyrtarët publik mund të menaxhojnë legjislacionin e BE-së (*Acquis communautaire*) dhe të jenë të përgatitur mirë për të justifikuar plotësisht asistencën përmes procesit të programimit, të punojnë në një mënyrë efektive proaktive, të administrojnë procesin në mënyrë efikase dhe të kenë burime të mjaftueshme njerëzore për të mbështetur proceset.

Përfituesit mund të marrin mbështetje për rritjen e kapaciteteve administrative dhe të vendosin strukturat e menaxhimit që janë të nevojshme për të marrë përgjegjësinë për menaxhimin e asistencës së IPA-s për Maqedoninë e Veriut. Në vendet kandidatë potenciale, zhvillimet e tilla do të jenë thelbësore si përgatitje për statusin e kandidatit.

- Jodiskriminimi - mundësitë e barabarta po ashtu është një kriter i rëndësishëm. Për të krijuar shërbimi civil efikas, barazi gjinore dhe ligje kundër diskriminimit, projektet e IPA bazohen në konsultim me Zyrën për Qeverisje të Mirë, Agjencinë për Barazi Gjinore dhe rrjetin ekzistues të zyrtarëve për barazi gjinore në ministrinë dhe komunat. Një fokus i veçantë i kushtohet nevojave dhe interesave të grave në të gjithë projektet dhe aktivitetet e organizimit për të lehtësuar pjesëmarrjen e grave (p.sh. trajnime). Institucioneve dhe shoqërisë civile ju jepet ndihmë për të siguruar se barazia gjinore është e integruar në mënyrë adekuate në legjislacion, strategjitë e qeverisë dhe politikat.

-Përkrahja për grupet e pambrojtura po ashtu paraqet një kriter të rëndësishëm. Problematika në integrimin e pakicave në RMV në jetën sociale, ekonomike dhe politike është një nga synimet kryesore që synon t'i përmirësojnë projektet e IPA-s. Vëmendje e veçantë i kushtohet adresimit të nevojave dhe interesave specifike të pakicave në të gjithë projektet dhe aktivitetet e organizimit për të lehtësuar pjesëmarrjen e tyre, në veçanti: Arritja e përfaqësimit adekuat të minoriteteve në trajnim dhe stërvitje, Favorizimi adekuat i rekrutimit të pakicave dhe përfaqësimin në shërbimin civil dhe në:

- aspektet e administratës qendrore dhe vendore, Përdorimin e gjuhëve zyrtare në RMV, siç përcaktohet nga ligji në fuqi për gjuhët,
- Trajtimin e kërkesave të veçanta të çështjeve të minoriteteve në çështjet taktike,
- strategjike dhe operacionale të policisë; Plotësimin e nevojave specifike të komunitetit serb, rom, turq dhe të tjerë.
- Mbrojtja e mjedisit Politika e zgjerimit e Komisionit Evropian i kushton rëndësi të jashtëzakonshme fushës së mbrojtjes së mjedisit .

Projektet e IPA-s për Maqedoninë e Veriut sistematikisht gjejnë mënyra për të përmirësuar mbrojtjen e mjedisit në rajon. Në veçanti, rindërtimi i infrastrukturës dhe aktivitetet tjera kushtëzohen të jenë në përputhje me rregulloret përkatëse dhe Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit. Një vlerësim i ndikimit të mjedisit është i nevojshëm në një fazë më të hershme dhe në një nivel më shumë strategjik duke i bërë një vlerësim të qëndrueshmërisë duke përdorur mjetin e Vlerësimit Mjedisor Strategjik, i cili mund të ndihmojë për të analizuar efektet mjedisore kumulative të programeve të ndryshme.

- Qeverisja e mirë Qeverisja e mirë, me theks të veçantë në luftën kundër korrupsionit është prioritet i fondeve të IPA. Komponenta e forcimit të rendit dhe ligjit zë vendin kryesor në fondet e BE-së për Maqedoninë e Veriut si shtet kandidat. Rëndësia është e theksuar në zhvillimin e një shërbimi të përgjegjshëm dhe profesional duke zbatuar parimin e ligjshmërisë, transparencës, konsultimit publik dhe integritetit, në mënyrë për të siguruar zbatimin e duhur të projekteve dhe të qëndrueshmërisë së reformave të ndërmarra.

1.3 Fusha e financimit nga IPA

Po cila është fusha apo më mirë thënë në shumës cilat janë fushat e financimit? IPA ofron asistencë në forma të ndryshme për vendet që ndërmarrin reforma politike dhe ekonomike në rrugën e tyre drejt anëtarësimit në BE:

Investime, kontrata prokurime apo subvencione,

Ekspertë të shteteve anëtare për të ndërtuar bashkëpunim administrativ, Veprime në mbështetje të vendit përfitues, Ndihmë në implementimin dhe menaxhimin e programeve; në raste të jashtëzakonshme, mbështetje buxhetore dhe Asistenca që lidhen me përmirësimin e kushteve në vendet përfituese dhe afrimi i tyre dhe qytetarëve të tyre me BE-në.

Në qershor të vitit 2007 Komisioni Evropian ka finalizuar planin e parë strategjik të asistencës nën IPA për vitet 2007-2009. Ky program ishte i bazuar në nevojat specifike të secilit vend, dhe i ka renditur prioritetet për asistencën financiare.

Programi për shumë vende po ashtu mbështetë projektet e përbashkëta rajonale. Projektet kryesore mbështeten në këto fusha:

Projektet e përbashkëta të bashkëpunimit, Infrastrukturës,

Drejhtësisë dhe çështjeve të brendshme, Tregut të brendshëm dhe tregtisë,

Ekonomisë së tregut,

Mbështetjes së shoqërisë civile,

Arsimit,

Rinisë dhe hulumtimit,

Planifikimi strategjik freskohet çdo vit.

“Asistenca e ofruar do të përdoret në fushat në vijim: forcimi i institucioneve demokratike, sikur edhe sundimit të ligjit, përfshirë forcimin e tij; promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore dhe respektin e rritur për të drejtat e pakicave, promovimin e barazisë gjinore dhe jodiskriminimit; reformën e administratës publike; reformën ekonomike; zhvillimin e shoqërisë civile; përfshirjen sociale; pajtimin, masat për ndërtimin e besimit dhe rindërtimin; bashkëpunimin rajonal dhe ndër-kufitar.”¹⁰

BE-ja mbështetë projekte për sigurinë e transportit detar edhe në Shqipëri. Punëtorët përballen me rreziqe të sigurisë me nivel të lartë të lëndimeve aksidentale në vendin e punës. Në maj 2008 është lansuar një projekt 18-muajsh për të përmirësuar kapacitetin inspektues për shëndetësi dhe siguri të autoriteteve turke, financuar me 1.3 milion euro nga IPA.

IPA fokusohet në nevoja të qartë. Kështu që prioritetet e saj janë të bazuara në vlerësime të qarta. Elemente kryesore janë Partneritetet Evropiane/të anëtarësimin që BE i ka lidhur me çdo

¹⁰ Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme të BE-së, Bruksel, 17 korrik 2006.f. 25

vend përfitues, dokumenti strategjik i Komisionit për zgjerim, dhe raportet vjetore për secilin shtet. Kriteri i shpërndarjes merr parasysh kapacitetin e çdo vendi për të përdorur dhe menaxhuar me fondet, dhe respektimin e kushteve të anëtarësimit. Dispozita e suspendimit mund të aplikohet nëse nuk janë përmbushur kushtet. Në këtë mënyrë, IPA ofron një lidhje në mes të kornizës politike për zgjerim dhe procesit të buxhetimit të BE-së. IPA përmban pesë komponente. Dy prej tyre- ndërtimi i kapaciteteve institucionale dhe bashkëpunimi ndër-kufitar – janë në disponim të të gjitha vendeve përfituese. Tri komponentët tjera – zhvillimi rajonal, zhvillimi i burimeve njerëzore, dhe zhvillimi rural- i janë vënë në disponim vetëm vendeve kandidate. Pasi që këto tri grupe të IPA-s në veçanti bëjnë përgatitjen për menaxhimin e fondeve strukturore të BE-së dhe mbështetjen bujqësore, ato kërkojnë kapacitete dhe struktura administrative të zhvilluara. Fondet shpërndahen në linjë me kornizën financiare tre-vjeçare indikative të lidhur me kornizën politike të zgjerimit. Kjo ofron informacione mbi qëllimet e Komisionit për ven-det dhe komponentët. Mbi këtë bazë, dokumentet shumëvjeçare indikative të planifikimit pastaj përgatiten për çdo vend (plus një për programin për shumë vende). Këto dokumente përmbajnë objektivat specifike të Komisionit dhe zgjedhjet e ndihmës së para-anëtarësimit, të cilat revidohen dhe azhurnohen për çdo vit. IPA po ashtu vepron si katalizator për të joshur më shumë investime vendore dhe të huaja, përfshirë edhe shumën financiare për zhvillim të Bankës Evropiane të Investimeve prej €25 milionë për ndërmarrjet e vogla dhe amvisëritë private për kreditë rurale dhe të banimit në Evropën juglindore. “Këto aktivitete janë plotësisht në linjë me Instrumentin për e BE-së për Asistencë të Para-Anëtarësimit e fokusuar në joshjen e investitorëve privatë në këtë rajon.” Banka Evropiane e Investimeve, nëntor 2007. Kush mund të merr pjesë? Pjesëmarrja në dhënien e kontratës apo grantit është e hapur për të gjithë qytetarët e Shteteve Anëtare, personat juridikë të themeluar në Shtetet Anëtare të BE-së apo Zonës Ekonomike Evropiane (EEA), vendi që është përfitues i IPA-s apo Instrumentit të Partneritetit Evropian të Fqinjësisë, dhe organizatave ndërkombëtare.¹¹

1.4 Qëllimi i IPA-s

IPA është e programuar në atë formë dhe mundësi për të maksimizuar fokusin, precizitetin dhe ndikimin në përmbushjen e nevojave të Para-Anëtarësimit nëpërmes një kornize të vetme të

¹¹ http://www.eeas.europa.eu/archives/delegations/kosovo/documents/publications/ipa_sq.pdf, f.6

thjeshtëzuar. IPA sjellë një shkallë të pajtueshmërisë dhe konsistencës në veprimin e Bashkimit Evropian, duke arritur rezultate edhe më të mira me burimet në dispozicion.

IPA si ndihmëse financiare i zëvendëson pesë instrumentet e mëhershme të Para-Anëtarësimit të BE-së: Phare, ISPA, SAPARD, dhe CARDS. IPA do t'i ndihmojë vendeve kandidate që të zbatojnë në tërësi legjislacionin e BE-së ("*Community acquis*") në kohën që ata bëhen shtete anëtare. Vendet kandidate potenciale, siç është rasti i Kosovës ndihmohen që të përafrojnë legjislacionin e tyre në mënyrë progresive me legjislacionin e BE-së. Instrumenti i ri është po ashtu i përcaktuar që në mënyrë progresive t'iu besojë administratave të vendeve përfituese menaxhimin e fondeve të BE-së.

Përveç rritjes së ndenjes së pronësisë në projektet e Para-Anëtarësimit, kjo po ashtu, do t'ju ndihmojë vendeve që të përgatiten për metodat e menaxhimit që ata do t'i përdorin pasi që të vijjnë në pozitë që të përfitojnë nga fondet si shtete anëtare të BE-së.

1.5 Puna e IPA-s

Në fakt çfarë pune bën IPA brenda shteteve të caktuara? IPA fokusohet në nevoja; kështu që, prioritetet e saj janë të bazuara në vlerësime të qarta. Elemente kryesore janë Partneritetet Evropiane/të anëtarësimit që BE-ja i ka lidhur me çdo vend përfitues, dokumenti strategjik i Komisionit për Zgjerim, dhe raportet vjetore për secilin shtet.

Kriteri i shpërndarjes merr parasysh kapacitetin e çdo vendi për të përdorur dhe menaxhuar me fondet, dhe respektimin e kushteve të anëtarësimit. Dispozita e suspendimit mund të aplikohet nëse nuk janë përmbushur kushtet. Në këtë mënyrë, IPA ofron një lidhje në mes të kornizës politike për zgjerim dhe procesit të buxhetimit të BE-së.

1.6 Përparësitë e IPA-s

Instrumenti për Asistencë të Para-Anëtarësimit i jep BE-së më shumë ndikim nga investimet e saj duke u ofruar ndihmë vendeve në rrugën e tyre drejt anëtarësimit.¹²

Nga aspekti administrativ, IPA i ofron BE-së një kornizë koherente për menaxhim dhe decentralizim gradual apo delegim të menaxhimit tek vendi përfitues. Po ashtu, ajo lejon fleksibilitet në aplikimin e asistencës.

¹² http://www.eeas.europa.eu/archives/delegations/kosovo/documents/publications/ipa_sq.pdf, f.11

IPA ofron lidhje të fortë në mes të aspekteve të buxhetimit dhe financimit si dhe politikave të zgjerimit. Gjithashtu, ua bën të qartë vendeve përfituese se çfarë asistence mund të presin, në qoftë se i plotësojnë kërkesat e nevojshme. Në këtë mënyrë, IPA i fuqizon udhëzimet që i ofron BE për vendet kandidatë dhe potenciale kandidatë, për prioritetet që duhet të ndiqen.

Por, mbi të gjitha, IPA ndihmon që këto vende, që nuk janë vetëm fqinjë të tyre, por edhe anëtarë potencial të ardhshëm për anëtarësim në BE, të zhvillojnë standardet dhe vlerat që i ndërton BE. Në këtë mënyrë, IPA është një investim real për të ardhmen- për vendet përfituese, dhe për vetë BE. IPA i sjellë fokus të ri asistencës së BE-së për zgjerim.

“BE vazhdon mbështetjen e reformave dhe zhvillimit të Evropës Juglindore përmes IPA-s. Mesatarisht, alokimi vjetor për Ballkanin Perëndimor në periudhën 2007–2011 do të jetë €800 milionë. Kjo është shuma më e madhe për kokë banori e ofruar deri tani nga Komisioni për ndonjë rajon të botës”. *Olli Rehn, Konferenca për Zhvillimin e Shoqërisë Civile në Evropën Juglindore, Bruksel, 17 prill 2008.*¹³

¹³ http://www.eeas.europa.eu/archives/delegations/kosovo/documents/publications/ipa_sq.pdf, shikuar më 2.11.2020

KREU I DYTË– PROGRAMET DHE NDIHMESA FINANCIARE

2.1 PHARE- PROGRAMI I PARA-ANËTARËSIMIT PËR MAQEDONINË E VERIUT

Në këtë pjesë të studimit do të trajtojmë programin e ndihmesës financiare që merr Maqedonia e Veriut si një shtet i cili sapo ka zgjedhur kontestin disa vjeçar me Greqinë dhe si pasojë e kësaj ajo fitoi një imazh pozitiv në aspekt të diplomacisë evropiane.

Njësia IPA dhe NPAA në Ministrinë e Financave është pjesë e strukturës operationale të Sistemit të Menaxhimit të Decentralizuar (DIS) me fondet nga komponenti i parë i Instrumentit për Ndhimën e Para-Anëtarësimit (IPA) Ndhimja për Tranzicionin dhe Ndërtimin e Institucioneve (TAIB) për vitin 2007-2013, si dhe për fondet IPA II për periudhën 2014-2020. Njësia IPA dhe NPAA koordinon të gjitha aktivitetet për menaxhimin e decentralizuar të projekteve të Ministrisë së Financave, të cilat financohen nga IPA TAIB. Më konkretisht, njësia koordinon proceset e planifikimit dhe përgatitjen e projekteve të Ministrisë së Financave të financuara përmes IPA, zbatimit teknik dhe monitorimit të zbatimit të projektit, në përputhje me rregullat e BE-së për menaxhimin e decentralizuar të fondeve IPA.¹⁴

Maqedonia e Veriut është shtet kandidat, më vërejtje të mëdha në fushën e menaxhimit dhe me fondet. Rasti i burgosjes së drejtorit të caktuar nga një parti politike pikërisht për vjedhje, manipulim të fondeve ndërrojë keq imazhin e këtij shtetit para syve të BE-së. Nota e dobët në lidhje me menaxhimin e fondeve për shkak të një zyrtari ndikoi keq në gjithë shtetit. Në bashkëbisedim me ish-ministrin e Financave, Xhevdet Hajredini, lidhur me temën të cilin e kemi marrë përsipër për studim në bisedë e sipër thoshte, madje dhe të njëjtën ai e ka potencuar dhe ne media: se për t'i kaluar filtrat e nevojshëm, nevojitet përvojë dhe kuadër profesional i mbështetur nga institucionet përkatëse shtetërore. Një kuadër i dobët si rasti i fundit që përfundoj më burgim është imazh-krijues negativ dhe mbyll derën për të trokitur për ndihmesë financiare shteti jonë në këto zyra për fonde. Ai thotë se: *“Për këtë qëllim, nevojitet një administratë me kapacitete optimale. Jo se administrata në Maqedoni nuk disponon me njerëz, madje ka më shumë të punësuar sesa duhet krahasuar me vendet tjera të Evropës juglindore për kokë banori, por problemi qëndron në atë se administrata te ne rri dhe nuk punon. Thjesht, administratorët në*

¹⁴ <https://www.finance.gov.mk/mk/node/314>, shikuar më 3.11.2020

*Maqedoni nuk dinë të punojnë sipas vlerave që kërkohen nga BE-ja, sepse ata janë punësuar në baza partiake, për qëllime politike, si aktivistë partiakë dhe jo si profesionistë”.*¹⁵

*Cilët janë Projektet e Ministrisë së Financave të financuara nga IPA TAIB
IPA TAIB 2009?*¹⁶

Brenda Programit Kombëtar për komponentin 1 të IPA - TAIB për vitin 2009, Ministria e Financave paraqitet si përfituese e projekteve të mëposhtme:

"Projekti për forcimin e kapaciteteve të Ministrisë së Financave - Sektori për Politikën Makroekonomike, për analizën makroekonomike dhe formulimin e politikave, në mënyrë që të përmirësojë procesin e hartimit të politikave dhe përmbushjen e kriterëve për pranimin në BE." Realizimi i këtij projekti do të përmirësojë kapacitetet analitike të Ministrisë së Financave për hartimin e një kornize koherente makro-fiskale në një periudhë afatmesme dhe afatgjatë. Projekti filloi në dhjetor 2012, përmes një marrëveshje binjakëzimi të lidhur me një partner binjakëzimi - një konsorcium nga Finlanda dhe Holanda. Kohëzgjatja e planifikuar e projektit është 24 muaj. Shuma totale e projektit është 902,500 Euro (pa TVSH), nga të cilat 855,000 Euro sigurohen përmes IPA, dhe 47,500 Euro janë bashkëfinancim kombëtar. Në lidhje me këtë projekt, u implementua një Projekt për asistencë teknike për instalimin dhe rregullimin e një aplikacioni për analizë makroekonomike, në shumën totale prej 17,350 euro (pa TVSH) të siguruar përmes IPA.

Projekti i Asistencës Teknike i Koordinatorit Kombëtar të Autorizimit / Fondit Kombëtar për të forcuar rolin e mbikëqyrjes mbi sistemet e menaxhimit dhe kontrollin e strukturave operative për të gjithë përbërësit e IPA-s. Projekti filloi në Shkurt 2014 me një afat të prillit 2015. Shuma totale e projektit është 250,187 euro (pa TVSH) e siguruar përmes IPA.

Prokurimi i mobiljeve dhe pajisjeve për zyre për Ministrinë e Financave dhe VSM është realizuar, në shumën totale prej 16,931 euro (pa TVSH) të siguruar përmes IPA.

Sa ndihmesë ka marrë Maqedonia e Veriut, në vitin 2012?-2013?

Brenda Programit Kombëtar për komponentin 1 të IPA - TAIB për 2012-2013, Ministria e Financave paraqitet si përfituese e projekteve të mëposhtme:¹⁷

¹⁵ <https://www.evropaelire.org/a/24436260.html>

¹⁶ <https://www.finance.gov.mk/mk/node/314>, shikuar më 3.11.2020

¹⁷ <https://www.finance.gov.mk/mk/node/314>, shikuar më 3.11.2020

"Projekti i ndërtimit të kapaciteteve për menaxhim efektiv dhe auditim të fondeve të BE". Projekti synon të forcojë kapacitetet e NAO, NF, CFCD dhe Strukturat Operative për menaxhim efektiv të fondeve të BE, si dhe për menaxhimin e instrumentit të ri që do të vendoset me Rregulloren e re të BE dhe Kornizën Financiare për periudhën 2014-2020. Projekti do të zbatohet përmes një kontrate binjakëzimi 24-mujore përfituesit e së cilës janë NAO, Fondi Kombëtar dhe CFSD dhe një kontratë për prokurimin e pajisjeve dhe automjeteve për inspektim në vend për nevojat e Fondit Kombëtar. Kontrata e binjakëzimit për projektin është në fazën e zbatimit të procedurës së tenderit, ndërsa për kontratën e prokurimit përgatitja e dokumentacionit të tenderit është në proces.

Në doganë këtë vit kemi projekt jashtëzakonisht të madh: Projekti për mbështetjen e sektorit për politikën tatimore dhe doganore në harmonizimin e mëtejshëm me legjislacionin e BE-së në fushën e së drejtës tatimore. Projekti është pjesë e Zhvillimit të Sektorit Privat të Sektorit Privat dhe është planifikuar të zbatohet përmes një marrëveshjeje shërbimi. Projekti është në fazën e zbatimit të procedurës së tenderit.

Përmirësimi i arkëtimit të të ardhurave, politikës tatimore dhe doganore



Twinning Project MK 18 IPA FI 02 19

"Improving Revenue Collection and Tax and Customs Policy"

Informacione themelore:

Emri i projektit: "Përmirësimi i arkëtimit të të ardhurave, politikës tatimore dhe doganore"

Përfitues: Ministria e Financave, Drejtoria e të Ardhurave Publike, Drejtoria Doganore

Realizuar nga: *Agency for European Integration* (Agjencia për Integrim Evropian nga Austria)

Periudha e realizimit: 21 janar 2020 – 20 janar 2023

Vlera: 3.500.000,00 EUR

Projekti është financuar nga Bashkimi Evropian përmes Programit Nacional IPA për 2018 IPA 2018 / 040-860 / 01.03 / MK / PFM

Përshkrim i shkurtër:

Qëllimi kryesor i projektit tuining "Përmirësimi i arkëtimit të të ardhurave, politikës tatimore dhe doganore" është të përmirësojë dhe harmonizojë legjislacionin tatimor dhe doganor në përputhje

me legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian dhe praktikat më të mira, të përmirësojë analizën ekonomike dhe parashikimin e të ardhurave, si dhe modelimin dhe përforsimin e kapaciteteve operacionale dhe administrative të institucioneve kryesore në sistem. Prandaj projekti ka për qëllim thjeshtimin e procedurave tatimore dhe doganore, duke përfshirë deklaratimet dhe arkëtimin duke zvogëluar procedurat dhe shpenzimet administrative, si dhe përmirësimin e shërbimeve tatimore dhe doganore të ofruara për qytetarët.

Komponentët:

Komponenti 1: Harmonizimi i legjislacionit tatimor dhe doganor me rregulloren, standardet dhe praktikat më të mira të Bashkimit Evropian;

Komponenti 2: Përforsimi i kapaciteteve të Ministrisë së Financave për zbatimin e analizës dhe parashikimin e politikës tatimore.

Komponenti 3: Përmirësimi i kapacitetit operativ dhe administrativ të Drejtorisë Doganore për të përforsuar legjislacionin dhe procedurat nacionale, menaxhimin e kontabilitetit dhe shërbimet informatike.

Komponenti 4: Përmirësimi i kapacitetit operativ dhe administrativ të Drejtorisë së të Ardhurave Publike me qëllim të përforsimit të legjislacionit nacional, shërbimeve dhe procedurave informatike.

Ekspertë nga Austria, Kroacia, Sllovenia, Holanda dhe vendet e tjera anëtare të BE-së do të bashkëpunojnë me ekspertë të Ministrisë së Financave, Drejtorisë së të Ardhurave Publike dhe Drejtorisë Doganore, në një numër aktivitetesh të cilat janë planifikuar brenda afatit kohor të projektit.¹⁸

Projekt për të mbështetur Departamentin e Sistemit Financiar në përafrimin e mëtejshëm me legjislacionin e sigurimeve të BE (Direktiva 2009/138 / KE) dhe rritjen e operacioneve të tregut. Projekti është pjesë e Zhvillimit të Fletës Sektoriale të Sektorit Privat dhe filloi me zbatimin në Mars 2016 përmes një kontrate binjakëzimi me një kohëzgjatje prej 18 muajsh Bashkimi Evropian i ofron 664 milion euro Maqedonisë në kuadër të fondeve IPA 2 për periudhën e ardhshme 7 vjeçare.¹⁹ Në bazë të dokumentit strategjik i cili u firmos sot, qytetarët evropianë në fakt ofrojnë rreth 320 euro për kokë banori në Maqedoni, me qëllim, evropianizimin e vendit. Ndiheva evropiane synon përmirësimin e demokracisë dhe qeverisjes, sundimin e të

¹⁸ <https://www.finance.gov.mk/sq/node/8543>, Për informacione shtesë, Këshilltar i përhershëm tuining znj. Romana Robnik, romana.robnik@finance.gov.mk, Asistent i këshilltarit të përhershëm tuining, znj. Hagiq-Rahiq

¹⁹ <https://www.koha.mk/ekspertet-fondet-ipa-te-orientohen-ne-perforcimin-e-kapaciteteve/>, shikuar më 3.11.2020

drejtës dhe të drejtat e njeriut, mjedisin jetësor, zhvillimin ekonomik, rural, bujqësisë dhe shumë fusha të tjera. “Qytetarët e shtetit tuaj duhet të ndiejnë se këto para do të shpenzohen mirë, me çdo projekt të suksesshëm të zbatuar këtu, shteti do të jetë më afër BE-së. Për ne është shumë e rëndësishme gjithashtu të ketë transparencë, sepse taksa-paguesit e shteteve anëtare në Portugali, në Lituani, Francë... duhet të jenë të kënaqur me mënyrën se si shpenzohen paratë e tyre”, deklaroi Aivo Orav, Ambasador i BE-së në Maqedoni. “Është jashtëzakonisht i rëndësishëm mesazhi i një partneriteti të fuqishëm ndërmjet Maqedonisë dhe BE-së, një interesim i vazhdueshëm i BE-së për zgjerimin në Ballkanin Perëndimor përfshi Maqedoninë”, u shpreh Fatmir Besimi, Zv/kryeministër për çështje evropiane.

Megjithatë Maqedonia nuk mund të lavdërohet me aftësinë e thithjes së parave evropiane. Respektivisht, nga 610 milion eurot e alokuara në kuadër të IPA 1 nga viti 2007-2013, Maqedonia shfrytëzoi vetëm 37 %, ndërkohë që kontratat kanë hapësirë për realizim, deri në 2017. Edhe pse zv/kryeministri Besimi nuk deshi të zbardhte shifra, sipas raportit të progresit të Komisionit Evropian, deri në fund të vitit 2013 Maqedonia ka humbur 21 milion euro. Sipas KE-së mungesa e kapaciteteve administrative për të thithur fondet IPA do të shkaktojë edhe humbje të tjera në të ardhmen. Ambasadori i BE-së Aivo Orav theksoi gjithashtu se Maqedonia, ndihmën evropiane duhet ta përdorë së pari për fushat kritike që janë nënvizuar nga raporti i përvitshëm i KE-së. “Raporti i Progresit të këtij viti nuk le hapësirë për interpretime të ndryshme pasi gjuha është shumë e qartë. Ruhet rekomandimi por Komisioni gjithashtu ka konstatuar hapa prapa këtë vit. Prandaj ne inkurajojmë autoritetet që t’i adresojnë këto çështje seriozisht. Ato janë liria e mediave, sundimi i të drejtës, lufta kundër korrupsionit dhe dialogu politik”, tha Aivo Orav, Ambasador i BE-së në Maqedoni. Në kuadër të IPA 1, Maqedonia firmosi sot edhe marrëveshjen e fundit për bashkëpunim ndërkufitar me Greqinë, në vlerë prej 1,6 milion eurosh. Maqedonia si shtet që synon të bëhet pjesë e familjes evropiane ka arritur të shfrytëzojë vetëm 40% nga programi i fondeve evropiane IPA, mjete këto të dedikuara për përfundimin e kapaciteteve demokratike të shtetit.

Në periudhën nga 2014 deri në 2020, Maqedonia mori mundësinë të përdorë 664.2 milion euro nga fondet e para-anëtarësimit të Bashkimit Evropian përmes programit IPA2 ose rreth 320 milion euro për kokë banori. Kjo është dukshëm më shumë sesa programi IPA 2007-2014, i cili ofroi mundësinë për të përdorur 614.5 milion euro si mbështetje të drejtpërdrejtë nga taksapaguesit evropianë për të rregulluar vendin me standardet evropiane.

Kjo u theksua në debatin publik "IPA2 (2014-2020) sfidat dhe mundësitë për përdorim", të organizuar nga Komisioni për Çështjet Evropiane të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë. Përfaqësues të parlamenteve kombëtare të vendeve në rajon po marrin pjesë gjithashtu në debatin dy-ditor. Siç tregohet, programi IPA2 do të mbështesë reformat e anëtarësimit në BE me 205.9 milion EUR, 298.8 milion EUR të parashikuara për zhvillimin rajonal dhe socio-ekonomik, punësimin, politikat sociale, arsimin, promovimin e barazisë gjinore dhe zhvillimin. 53.2 milion euro janë siguruar për burimet njerëzore, dhe 106.3 milion euro janë për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

BE-ja ka identifikuar bashkërisht shtatë sektorë prioritarë për Republikën e Maqedonisë. 122.9 milion euro do të ndahen për përparësinë e parë të demokracisë dhe qeverisjes në shtatë vitet e ardhshme, 83 milion euro për shtetin e së drejtës dhe të drejtat e njeriut, 112.9 milion euro për mjedisin dhe veprimet klimatike, 112.9 milion euro për transportin. 73 milion për konkurrencën dhe inovacionin, 53 milion për arsimin, punësimin dhe politikat sociale dhe 106.3 për bujqësinë dhe zhvillimin rural.²⁰

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë Trajko Veljanoski tha se ai e kupton debatin e sotëm si vazhdim të gjithçkaje që përmbahet në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për vendin, si lavdërim ashtu edhe vërejtje.

Marrja e më shumë fondeve në programin IPA2 rrit përgjegjësinë tonë për t'i përdorur fondet në maksimum në arritjen e qëllimit strategjik - anëtarësimin e plotë në Bashkimin Evropian. Prania e përfaqësuesve të parlamenteve nacionale nga rajoni në debatin publik, nga ana tjetër, tregon përkushtimin tonë për integrimin në BE dhe jo vetëm deklarativisht, tha Veljanoski.

Ai tregoi se shpreson që Qeveria dhe institucionet të miratojnë qasjet e reja në përdorimin e fondeve të parashikuara në programin IPA2 me kohë.²¹

Përgjegjësia e shtetit është të përdorim mjetet sa më shumë që mundemi dhe unë personalisht pres që në periudhën e ardhshme të rritet përqindja e përdorimit të këtyre mjeteve në bujqësi, arsim dhe fusha të tjera, tha Veljanoski, duke theksuar nevojën për bashkëpunim rajonal, posaçërisht për projekte të mëdha të infrastrukturës. Për periudhën 2014 – 2020, Brukseli i ka

²⁰ <https://www.finance.gov.mk/mk/node/4647>, shikuar më 3.11.2020

²¹ <https://www.finance.gov.mk/mk/node/4647>, shikuar më 3.11.2020

ndarë Maqedonisë 664 milionë euro për shfrytëzim nga programi IPA, mjete këto të destinuar kryesisht për përforcimin e kapaciteteve në administratën publike, transport, bujqësi, por ekspertet thonë se në fokus mbetet lufta kundër korrupsionit dhe sundimin e shtetit ligjor, për këtë arsye qeveria mjetet nga fondet IPA duhet t'i orientojë në përforcimin e kapaciteteve në institucioneve që janë përgjegjëse për të luftuar korrupsionin. Aleksandar Kolevski i kontaktuar përmes imejl adresës time deri te nga Qendra Maqedonase për Edukim Evropian, thotë se qeveria aktuale të pakën në mënyrë deklarative tregohet më e interesuar në shfrytëzimin e mjeteve evropiane, por sipas tij, më shpresëdhënëse është fakti se Brukseli së fundmi është treguar më i vendosur që këto mjete të realizohen në mënyrën e duhur. Maqedonia e veriut si shtet duhet të shërohet nga sëmundja kronike në kuptimin e vonësive me hartimin e projekteve dhe realizimin e planeve që kanë të bëjnë me mjetet evropiane. Ka më shumë institucione që nuk janë aq transparente sa duhet në menaxhimin e buxhetit, kjo është e pa tolerueshme për shtetet me demokraci të zhvilluar pjesë e së cilës familje synon të behet Maqedonia. Pikërisht kjo bllokun dhe shfrytëzimin maksimal të mjeteve nga IPA fondet”, në bashkëbisedimin përmes imejl adresës më njeriun e parë të këtyre projekteve. Nga ana tjetër, dhe Pero Dimshoski ish zyrtarë i lartë në dikasterin integriteteve thotë se duhet të behen përpjekje maksimale që të shfrytëzohet këto mjete, veçanërisht në këtë periudhë delikate në të cilën ndodhet Maqedonia, përkatësisht të dëshmohet se me profesionalizëm arrin t'i bëjë ballë luftës kundër korrupsionit.

“Në drejtësi, procesi hetimor është me shumë rëndësi që procesi i hetimeve të mbulohet me fakte dhe dëshmi relevante. Mendoj se detyrë e qeverisë është që të hartoj plan konkret që në këtë lëmi të orientohen mjetet nga fonde evropiane sfida me të cilën ballafaqohet Maqedonia është krimi dhe kjo e keqe duhet të ç'rrenjohet”. Mençuria do të jetë që mjetet të destinohen në këtë drejtim, sepse nëse kemi ç'rrenjosë korrupsionin kemi çliruar shtetin nga prangat që e bllokojnë zhvillimin e saj në të gjitha dimensionet” vlerëson Dimshoski. Përderisa, Fatmir Bytyqi, i cili njihet në opinion si ekspert i ekonomisë i cili njëherësh ka qenë i angazhuar dhe si konsulent për shfrytëzimin e fondeve nga programi IPA, për Radion Evropa e Lirë, thotë se duhet të përforcohen kapacitetet e institucioneve përkatëse që pjesa e mbetur e fondeve IPA të shfrytëzohet maksimalisht. “Njerëzit e duhur duhet të vendosen në vendin e duhur. Fatkeqësisht një gjë të tillë nuk e kemi parë në të kaluarën, por edhe tani në disa institucione po vazhdon avazi i vjetër, përkatësisht fondet e Bashkimit Evropian që shihen vetëm nga aspekti politik dhe jo ai pragmatik, që ka të bëjë me shfrytëzimin real për përforcimin e kapaciteteve demokratike të vendit. “Duket se po bëhen përpjekje nga ana e qeverisë aktuale, ka një ndryshim të vogël, por

akoma jemi larg asaj që do të duhej të ishte” thotë Bytyqi. Më së shumti fonde nga programi IPA, Maqedonia ka arritur të shfrytëzoj në pjesën që ka të bëjë me përforsimin e kapaciteteve për realizimin e reformave ndërkohë, që ngec shumë sa i përket thithjes së fondeve evropiane nga programet që kanë të bëjnë në lëmin e bujqësisë.²²

Në bazë të hulumtimit që kam bërë më njerëz të qeverisë, dhe njerëz që janë afër njohjes me këto programe të ndihmesave financiare, gjë të cilën e bën Qendra për Arsim Evropian. Në bazë të takimit që kam bërë me to, në zyrat e kësaj qendre, shënimet e nxjerra, nga bashkëbisedimi më to, me dalin se sipas tyre nga të gjitha mjetet e parapara për vitin 2016, që arrijnë vlerën deri në 58.5 milionë euro, vetëm 42 për qind nga to janë shfrytëzuar në projekte konkrete. Si shkak i shfrytëzimit të dobët të mjeteve evropiane, konsiderohet kapaciteti i pamjaftueshëm i institucioneve të Maqedonisë për t’u ballafaquar me obligimet për realizimin e projekteve konkrete. Kthimi i mjeteve është pasojë e keqmenaxhimit dhe se nuk ka kuadër profesionit për të zbatuara ato në tërësi. Dhe maqedonasit dhe shqiptarët nuk kanë përgatitur ende ekip profesionist që do merret më këto ndihmesa, andaj gati gjysa e shumës kthehet pas. Në këto projekte ndodh që ka korrupsion të madh në aspekt të menaxhimit dhe ketë e kemi të njohur dhe në raportin e Be-së për Maqedoninë...

*Shënim: “E vëreni, unë flas për fonde të 2007-s dhe 2008-s, të cilat Maqedonia nuk arrin t’i realizojë, ndërkohë që vendet tjera të rajonit tashmë shfrytëzojnë mjete të 2010-s, madje edhe të 2011-s. Andaj, duhet parë realitetin me sy, sado i hidhur që të jetë ai - Maqedonia humbet interesin e Bashkimit Evropian, ndërkohë që sytë orientohen kah Serbia”, thotë Dimova nga Qendra për Arsim Evropian.*²³Këto të dhëna janë përmes bashkëbisedimit përmes imejlit dhe të njëjtat me kërkesë të komisionit të temës mund ti dorëzoj screen.

Ndërkohë, nga qeveria Qeverisë së Maqedonisë së Veriut, thotë se vendi ka bërë përpjekje maksimale për të shfrytëzuar fondet gjegjëse për çka ka dhe rezultate konkrete në realizimin e reformave në disa segmente të shoqërisë në Maqedoni.

“Qeveria e Maqedonisë i jep një theks të veçantë këtij instrumenti në realizimin e reformave dhe projekteve të ndryshme, veçanërisht me atë që ka të bëjë me reformat në legjislacion, në administratë, bashkëpunimin ndërkufitar, si dhe projektet tjera që dalin nga bashkëpunimi, sa i përket realizimit të IPA-fondeve, gjatë procesit të aderimit të Maqedonisë në

²² <https://www.koha.mk/ekspertet-fondet-ipa-te-orientohen-ne-perforcimin-e-kapaciteteve/>, shikuar më 3.11.2020

²³ Ditëve të fundit doli në media së pikërisht Qendra për arsim Evropian është keqpërdoruesja më e madhe mjetet, madje kishte lajm se janë dhënë mijëra euro për trajnim të gomarit, që paraqet skandal të paparë ndonjëherë...

BE”, thotë zëdhënësi i qeverisë. Këto fjalë janë shpesh dekor politik dhe në aspekt të zbatimit të punëve del një rezultat tjetër të cilin do e japin në përfundim.

Drejtoresha e Qendrës Maqedonase për Arsimim Evropian, **Lidija Dimova**, duke qenë se njeh nga afër këto punë, thotë se nëse do të angazhoheshin autoritetet qeveritare në drejtim të riorganizimit të mjeteve ekzistuese të fondeve evropiane (IPA) duke orientuar 15% të këtyre mjeteve për sektorin civil, do të siguroheshin mbi 7 mijë vende pune. *“Meqë në fondet IPA-II, Maqedonia ka 600 milionë euro në dispozicion për shtatë vjetët e ardhshëm dhe nëse në mënyrë të drejtë shfrytëzohen këto mjete, ne garantojmë se së paku 7 mijë 700 persona do të mund të punësohen me orar të plotë pune, si dhe rreth 250 mijë persona do të angazhohen përkohësisht, e gjithë kjo me paratë evropiane”*, thotë Dimova. Njësia për Koordinimin e Kundër Mashtrimit të Fondeve të BE-së (AFKOS) është themeluar në Sektorin për Inspektimin Financiar në Sektorin Publik dhe Koordinimin e Kundër Mashtrimit të Fondeve të BE-së në Ministrinë e Financave të Republikës së Maqedonisë Veriore si pikë kontakti për bashkëpunim me Zyrën e Komisioni Evropian Kundër Mashtrimit (OLAF).

Maqedonia e Veriut ka themeluar AFKOS - Njësia për koordinimin e luftës kundër mashtrimit të fondeve të BE-së.²⁴ Kompetencat e AFKOS përcaktohen në nenin 50 të Marrëveshjes Kornizë ndërmjet Republikës së Maqedonisë Veriore të përfaqësuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë Veriore dhe Komisionit Evropian për procedurat për zbatimin e ndihmës financiare nga Bashkimi për Republikën e Maqedonisë Veriore. (IPA II) (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” Nr. 99/2015). Fusha e punës së Njesisë për bashkërendimin e luftës kundër mashtrimit të fondeve të BE-së përcaktohet në Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e Financave nr. 01-6174 / 5 nga 05.12.2018.

Ajo thekson se Qeveria e Maqedonisë, pos riorganizimit të këtyre mjeteve, duhet të shprehë dhe guxim për demokratizimin e institucioneve shtetërore dhe jo këtë ta bëjë sa për "sy e faqe" para faktorit ndërkombëtar.

Nga ana tjetër, profesori i USHT-së **Albert Hani**, nga Qendra për Menaxhim të Konfliktëve, thotë se ka më shumë arsye pse sektori civil në Maqedoni pothuajse nuk ka aspak qasje në fondet evropiane.

“Flitet për çështjen e transparencës, përgjegjësisë dhe shumë mënyra të tjera të punës që ne nuk i kemi etabluar si sistem, si në organizatat joqeveritare, ashtu dhe në institucionet

²⁴ <https://www.finance.gov.mk/mk/node/8003>

shtetërore. Thjesht, ne nuk mund t'i marrim këto mjete, po edhe nuk dimë t'i marrim, sepse nuk jemi të përgatitur për t'i menaxhuar mjetet evropiane”, shprehet Hani. Por, Lidija Dimova thotë se duke u nisur nga fakti se OJQ-të kanë vështirësi për të konkurruar për shfrytëzimin e fondeve evropiane, Qeveria duhet të kontribuojë me ndërtimin e një infrastrukture financiare përmes “Fondit për zhvillim të demokracisë”, dhe të mundësohet shfrytëzimi i kapaciteteve të vetë institucioneve shtetërore që do t'u dedikohen projektet. “Ne propozojmë që fillimisht të destinohen mjete për ndërtimin e kapaciteteve të vetë sektorit civil, që është dhe pjesa më e ndjeshme, sepse nuk ka aktivitete. Pastaj, Qeveria duhet të sigurojë mjete për bashkëfinancim, si dhe nevojitet të krijohen mekanizma që mos favorizohet ndonjëra organizatë qeveritare që është e afërt me politikat qeveritare”, potencon Dimova. Edhe Albert Hani nga sektori civil pohon se Qeveria duhet të paraqesë shembull si duhet menaxhuar mjetet e BE-së dhe më pas gjithçka do të jetë më e lehtë. “Së pari autoritetet shtetërore duhet të jenë ato që do të demonstrojnë shembull të mirë se si duhet të menaxhohen fondet evropiane, duke pasur një qasje më profesionale ndaj IPA-fondeve”.

“Kjo do të thotë se fillimisht shteti duhet të ndryshojë sistemin e punës duke qenë më transparent dhe më të përgjegjshëm në implementimin e projekteve që financohen nga BE-ja, mënyrë e punës që do të ndiqej dhe nga OJQ-të. Së dyti, nevojitet një bashkëpunim më intensiv mes sektorit publik dhe sektorit civil, si dhe nevojitet një bashkëpunim rajonal”, thotë Hani.

Sektori civil disa herë ka ngritur zërin se Maqedonia nuk arrin të shfrytëzojë as 30 për qind të mjeteve IPA, si pasojë e mosrealizimit të reformave dhe mungesës së një strategjie konkrete për shfrytëzimin e këtyre mjeteve.

Sektori civil në Maqedoni ka kapacitet për të ndihmuar Qeverinë që të tërheqë mjetet evropiane dhe njëherësh me këtë dhe të sigurojë vende pune për të rinjtë, veçanërisht ata që njohin më shumë gjuhë për të shfrytëzuar praktikën e vendeve që tashmë janë pjesë e familjes evropiane. anë përfunduar të gjitha punët ndërtimore të financuara përmes grantit IPA për infrastrukturën rurale, në kuadër të Projektit për përmirësimin e shërbimeve komunale - MSIP, të zbatuara nga Ministria e Financave. Bëhet fjalë për 133 projekte kapitale të realizuara në 78 komuna në vend, që kanë për qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës në zonat rurale dhe zgjidhjen e problemeve të infrastrukturës.

Vlera e përgjithshme e këtyre projekteve është 16.9 milionë euro, nga të cilat 12.7 milionë euro janë grante - mjete të pakthyeshme nga Bashkimi Evropian, ndërsa 4.2 milionë euro janë siguruar nga Buxheti.²⁵

Shumica e projekteve të realizuara janë për ndërtimin dhe rikonstruimin e rrugëve lokale, për të cilat në 58 komuna janë investuar 12.4 milionë euro. Në ndërtimin e ndërtesave publike janë investuar 5.9 milionë euro, në infrastrukturën komunale 3.8 milionë euro etj.

Pjesa më e madhe e këtyre projekteve tashmë janë vënë në përdorim, ndërsa disa prej tyre së shpejti do të vihen zyrtarisht në përdorim. Për shembull, sot në komunën e Petrovecit zyrtarisht do të lëshohet një rrugë e re lokale dhe dy rrugë të rikonstruara me vlerë 260.000 euro. Përndryshe, grant mjetet për zhvillimin e infrastrukturës rurale sigurohen nga Bashkimi Evropian me kërkesë të Qeverisë dhe shfrytëzohen përmes Projektit për përmirësimin e shërbimeve komunale, të zbatuara nga Ministria e Financave me mbështetjen e Bankës Botërore.²⁶

Për t'i përafuar vendet kandidate për anëtarësim në BE, u krijuan tri programe të mbështetjes për këto vende. Programi i parë ishte PHARE, i cili u pasua nga ISPA, SAPARD dhe tani IPA. Fjala PHARE është shkurtesë (Pologne, Hongrie Aide à la Reconstruction Économique) e cila do të thotë "Mbështetja për Rindërtimin Ekonomik për Poloninë dhe Hungarinë". Ky program është krijuar për këto dy vende në vitin 1989, ndërsa më vonë programi është zgjeruar në 10 vendet kandidate të Evropës Qendrore dhe Lindore për anëtarësim në BE dhe më vonë (1996) në 13 vende, siç janë: Polonia, Hungaria, Republika Çeke, Estonia, Letonia, Lituania, Sllovakia, Sllovenia, Bullgaria, Rumania, Shqipëria, Maqedonia, Bosnja dhe Hercegovina. Ky program është krijuar për të ndihmuar tranzicionin ekonomik të vendeve të Evropës. Fillimisht ishin alokuar 4.2 miliardë euro për vitet 1990-1994, ndërsa në vitet 1995- 1999 ky program u rrit në 6.693 miliardë euro. Në vitet 2000-2006 ky program u zgjerua në 11 miliardë euro. Përveç vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore në vitin 1994 pjesë e PHARE u bënë edhe Qipro, Malta, Turqia, Shqipëria, Bosnja Hercegovina dhe Maqedonia. Në vitin 2001 pjesë e programeve PHARE u bënë edhe ish-Republika Federale e Jugosllavisë dhe Kroacia.²⁷ Për dallim nga vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, fondet e PHARE për Ballkanin ishin më tepër simbolike. Programi PHARE kishte tri objektiva kryesore: 1. Forcimin e administratës publike dhe


²⁵ <https://www.finance.gov.mk/sq/node/8055>, shikuar më 3.11.2020

²⁶ <https://www.finance.gov.mk/sq/node/8055>, shikuar më 3.11.2020

²⁷ A.Etem, M. Nazmi, 2008, Tetovë, f. 25

institucionale për të funksionuar efektivisht brenda BE-së, 2. Mbështetja për harmonizimin e legjislacionit të vendeve candidate me atë të BE-së dhe shkurtimi i kohës së tranzicionit dhe 3. Nxitja e kohezionit ekonomik dhe social.²⁸ Shohim më poshtë tabelën nr. 3 e cila na jep detaje se si janë këto shifra: Tabela nr.3

INSTRUMENTET E PARA-ANËTARËSIMIT (MILIONË EUR) ²⁹						
VITET	200	2001	2002	2003	2005	2006
INSTRUMENTET E PARA-ANËTARËSIMIT	3,120	3,120	3,120	3,120	3,120	3,120
PHARE	1,560	1,560	1,560	1,560	1,560	1,560
STRUKTURALE (ISPA)	1,040	1,040	1,040	1,040	1,040	1,040
BUJQËSIA (SEPARD)	520	520	520	520	520	520



Grafikoni për instrumentet e para-anëtarësimit (milione eur)³⁰

2.2 ISPA- PROGRAMI I PARANËTARËSIMIT PËR MAQEDONINË E VERIUT

Një ndihmë e tillë për vendet përfituese do të shpërndahet përmes mjeteve të përshtatshme instrumente. Deri në vitin 2007, programet e para-anëtarësimit luajtën një rol të tillë si PHARE, ISPA dhe SAPARD, si instrumente të jashtëm për ekonomik dhe kohezioni social. Përmes tyre, projekte në fushën e infrastruktura, industria, mjedisi, shërbimet, bujqësia, zhvillimi rural dhe bizneset e vogla³¹,

Që nga viti 2007, të gjitha programet e para-anëtarësimit janë integruar në instrumentin e vetëm të para-anëtarësimit - Instrumenti i para-anëtarësimit ndihma (IPA). Baza ligjore e IPA përcaktohet nga Rregullorja (KE) nr. Rregullorja e Këshillit (KE) Nr. 1085/2006 e datës 17

²⁸ europa.eu, Bruksel, 2013

²⁹ europa.eu, Bruksel, 2006

³⁰ europa.eu, Bruksel, 2006

³¹ Temjanovski R. (2005), Shfrytëzimi i fondeve IPA për arritjen e zhvillimit të ekuilibruar ekonomik dhe shoqëror, me referencë të veçantë për politikën e transportit të Republikës së Maqedonisë, fq.12

korrik 2006. Instrumenti është themeluar për të përmirësuar efektivitetin e ndihmës së jashtme të Komunitetit, të tilla si dhe të bëjë më të lehtë për të menaxhuar atë ndihmë. Për zbatimin e IPA është parashikoi një rregullore të vetme zbatuese dhe mënyrën e bashkëpunimit të përcaktuara në marrëveshjet kornizë midis Komisionit dhe shtetit.³²

Politikat Strukturore për Para-Anëtarësimin ose siç njihet ISPA ka prejardhjen nga një fjalë frënge që do të thotë *Instrument Structurel de Pré-Adhésion*. ISPA është krijuar në vitin 1999 me objektivin kryesor për përgatitjen e vendeve anëtare për pranimin e fondeve të dhuruara nga BE-ja dhe për gjetjen e zgjidhjeve në fushën e mjedisit dhe transportit. Projektet ISPA-s karakterizohen se janë më të mëdha sesa projektet e PHARE apo projektet SAPARD, pasi ato duhet të kenë një ndikim të konsiderueshëm në përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit ose rrjeteve të infrastrukturës së transportit. Në teori, shpenzimet e përgjithshme të projekteve individuale të cilat i ka financuar ISPA nuk mund të ishin më të vogla se 5 milionë euro. (*europa.eu, Bruksel, 2012*) Investimet në mbrojtjen e mjedisit dhe infrastrukturës së transportit janë shpërndarë në mënyrë të barabartë, dmth., vendet e veçanta kanë qenë të obliguara që të ndajnë në pjesë të barabartë fondet e ISPA në të dy sektorët, në fushën e mjedisit dhe atë të transportit. Drejtoria e Përgjithshme e Komisionit Evropian për politikën rajonale i ka menaxhuar fondet e ISPA. Karakteristikë kryesore e ISPA-s është se fondet për financimin e pjesshëm të projekteve të mëdha investuese të lidhura me mbrojtjen e mjedisit dhe transportit kanë qenë më të mëdha. Shprehja "projekte të mëdha" tregon se aktivitetet e ISPA-s kanë qenë të fokusuar që të kenë një ndikim të rëndësishëm në sektorët përkatës, prandaj është vënë edhe minimumi i financimit prej 5 milionë euro. Ndarja e fondeve të ISPA u bazua në kriteret e mëposhtme: Popullsia, GDP-ja për kokë banori e llogaritur llogaritet mbi bazën e fuqisë blerëse. Në këtë hartë Maqedonia nuk gjendet...

Ideja ishte të modernizohej e gjithë para-anëtarësimi përmes IPA-s ndihma nën një kornizë të vetme dhe nën të njëjtën rregullore që do të vendoset vendet kandidate dhe vendet potenciale kandidate. Kjo është arsyeja pse IPA e tyre zëvendësoni instrumentet e mëparshme: Ndihma për Poloninë dhe Hungarinë për Rindërtimi Ekonomik (Phare), Instrumenti i Para-Anëtarësimin për Politikat Strukturore (ISPA), Programi Special i Para-Anëtarësimin për Bujqësi dhe Zhvillimi

³² Instrumenti për Ndihmën e Para-Anëtarësimin - IPA (2007-2013), Qeveria e Republikës së Maqedonisë - Sekretariati për Çështjet Evropiane, Në dispozicion në: <http://www.sea.gov.mk/Default.aspx? ContentID = 26>, Përdorur: (27.04. 2013)

Rural (SAPARD) dhe Instrumenti për Para-Anëtarësim si dhe Ndhimja e Komunitetit për Rindërtim, Zhvillim dhe stabiliteti (CARDS).³³

Lloji i ndihmës së dhënë nga ky instrument varet nga nëse vendi ka statusin e një kandidati potencial apo statusin e kandidat për anëtarësim.³⁴ Këto efekt të kësaj ndihmesë financiare e shohim në tabelën nr. 4:

HARTA E VENDEVE FITUESE NGA ISPA	
BULLGARI	8-12%
ÇEKIA	5.5-8.0%
ESTONIA	2.0-3.5%
HUNGARIA	7.0-10.0%
LITUANIA	4.0-6.0%
POLONIA	30-37%
RUMANIA	20-26%
SLLOVENIA	1-2%
SLLOVAKIA	3.5-5.5%

*Burimi:*³⁵

Tabela nr.4 përqindja e ndarë sipas sferave

2.3 SAPARD- PROGRAMI I PARANËTARËSIMIT PËR MAQEDONINË E VERIUT

Zgjerimi i Bashkimit Evropian në 2004 ishte zgjerimi më i madh si për nga territori ashtu edhe për nga numri të shteteve dhe popullatave. Sidoqoftë, dhjetë vendet që janë bashkuar me BE në 2004 kurrë nuk ka marrë burime nga buxheti i BE-së ekuivalente me rreth 4 për qind të PBB-së së tyre kombëtare, që është kufiri i sipërm i shumës të fondeve që një vend mund të marrë nga BE për qëllime kohezioni në përputhje me aftësinë pranuese të shtetit ndaj këtyre fondeve. Tre shtetet Ballkanike në periudhën e para-zgjerimit në vitin 2004, ishin shprehur përfituesit më të mëdhenj të fondeve evropiane përmes përqindjes së PBB-së. Në vitin 2003, ata morën ndihmën e para-anëtarësimit nga buxheti i BE ekuivalent me 0.8% të PBB-së, e cila është larg nga sa më sipër kufiri i 4% të PBB-së.

Ndhimja e para-pranimit e BE-së për Slloveninë ishte më e ulët se 0.2% e PBB-së së vendit në 2003. Numra të tillë tregojnë se kapaciteti makroekonomik i absorbimit nuk është

³³ Aneta Shuljakova, Doktoratura, shih linkun: <http://www.fikt.uklo.edu.mk/assets/uploads/2017/08/>, shikuar më 28.09.2020 ora 10:00

³⁴ Instrumenti i ndihmës së para-anëtarësimit IPA-faktet, statusi, vendosja; Sekretariati për Çështje Evropiane, Qeveria e Republikës së Maqedonisë (2009), f.3.

³⁵ Publikuar në Gazetën zyrtare të Komisionit Evropian, L.72, mars 2000

një pengesë për përdorimin efektiv dhe efikas të burimeve të alokuara nga BE në këto vende në formën e ndihmës së para-anëtarësimit të kanalizuar përmes PHARE, ISPA dhe SAPARD.³⁶

Programi i Veçantë i Aderimit në fushën e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural- SAPARD, në origjinal *Special Accession Programme for Agriculture and Rural Development*, ishte një nga tri programet e BE-së për para anëtarësim që kishte për qëllim për të ndihmuar vendet kandidate në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural në Evropën Qendrore dhe Lindore. SAPARD është themeluar në qershor 1999 nga Këshilli i Bashkimit Evropian për të ndihmuar vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore që të zhvillojnë sektorët e tyre bujqësorë dhe zonat rurale, si dhe t'i ndihmojnë këto vende për zbatimin e legjislacionit të BE-së (*acquis communautaire*) në fushën e Politikës së Përbashkët Bujqësore (CAP) dhe legjislacionin përkatës.³⁷ Fondet nga ky program ishin të destinuar për arritjen e qëllimeve të përgjithshme të politikës bujqësore, përkatësisht për promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm të bujqësisë dhe zhvillimit solid rural. Qëllimi i masave të SAPARD është për të zhvilluar adaptimin dhe integrimin e sektorëve bujqësorë dhe ushqimorë si dhe zonat rurale të vendeve kandidate në tregun e përbashkët të BE. Kjo ishte gjithashtu asistencë e drejtpërdrejtë, me kusht që këto vende pas pranimit në BE do të jenë në gjendje të zbatojnë politikën e përbashkët bujqësore. Investime në ekonomitë bujqësore ishin të destinuar për prodhimin dhe përpunimin e qumështit, mish lope, derra dhe kafshët e vogla, si dhe prodhimin dhe përpunimin e perimeve, luleshtrydheve dhe manaferrave. Fondet e akorduara për investimet në ferma bujqësore ishin të destinuar për ndërtime të reja ose rinovimin e ndërtesave të fermave, blerja e pajisjeve për ndërtesa të fermave, blerja e makinerive bujqësore dhe blerja e bagëtive në ferma bujqësore në bazë të investimeve të qëndrueshme. Brenda investimet në përpunimin dhe marketingun e produkteve bujqësore dhe të peshkimit, këto investime janë mbështetur me pajisje të reja teknologjike, duke përfshirë pajisjeve kompjuterike dhe softuerë, por edhe adaptimin e objekteve të prodhimit. Nga këto projekte kanë përfituar personat juridik dhe fizik ose grupet e tyre të regjistruara, shoqatat e regjistruar për ndjekjen e aktiviteteve në njërën nga fushat e prodhimit, përpunimit dhe ruajtjen e mishit dhe prodhimi i produkteve të mishit, përpunimi dhe ruajtja peshkut, prodhimi i produkteve të peshkimit apo përpunimin e qumështit dhe prodhimi i produkteve bulmetore.³⁸

³⁶ Mrak M., Tilev D. (2008): Absorbition for EU pre-accession funds: Concept and implications for Kosovo. Thithja për fondet e para-anëtarësimit në BE: Koncepti dhe implikimet për Kosovën, fq.31.

³⁷ europa.eu, Bruksel, 2012

³⁸ europa.eu, Bruksel 2013

2.4 CARDS- PROGRAMI I PARANËTARËSIMIT PËR MAQEDONINË E VERIUT

Kuadri i dytë që përcakton ndihmën financiare për Maqedoninë është përcaktuar nga fakti që vendi ka një status zyrtar të kandidatit. Kjo do të thotë se ndihma financiare e BE-së kryesisht "drejtohet nga aderimi" që do të thotë se duhet të përgatishë vendin për të politikën e kohezionit të Unionit dhe kështu të mbështesë procesin e integrimi. Maqedonia fitoi statusin e një vendi kandidat për anëtarësim në dhjetor 2005³⁹ Deri atëherë ai kishte qasje të kufizuar.

Fondet evropiane, kryesisht deri në programin CARDS2 Asistenca Komunitare për Rindërtim, Zhvillim dhe Stabilizim ose siç njihet në literaturë Programi CARDS është themeluar në vitin 2000, në kuadër të Procesit të Stabilizim - Asociimit.

Ky program arriti vlerën e 4.6 miliardë eurove ofruar për të ndihmuar vendet e rajonit të Ballkanit në katër fusha. Fusha kryesore në të cilat janë përkrahur nga projekti i Bashkimit Evropian CARDS janë këto: Rindërtim, stabilizim demokratik, bashkërendim dhe kthim të emigrantëve

- Zhvillim institucional dhe legjislativ, duke përfshirë harmonizimin me normat dhe
- qasjet e BE -së për të përforcuar demokracinë dhe sundimin e ligjit; të drejtat e njeriut, shoqërisë civile dhe medie; si dhe funksionimin e ekonomisë së tregut të lirë Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror, duke përfshirë reformën strukturore
- promovim të marrëdhënieve të ngushta dhe bashkëpunimit rajonal midis vendeve të
- Ballkanit, mes tyre me BE-në dhe vendet kandidate të Evropës Qendrore. Programi CARDS ishte instrumenti kryesor i BE-së asistencës financiare për Ballkanin Perëndimor, që mbulojnë në mënyrë specifike vendet si Kroaci, Bosnje dhe Hercegovinë, Serbi, Mal të Zi, Maqedoni, Kosovë dhe Shqipëri. Programi CARDS është trashëguar nga Instrumenti i Para-Anëtarësimit IPA, i cili është edhe më tutje funksional.⁴⁰

³⁹ Matlievska M., Zhvillimi i Qëndrueshëm-Paradigma e Re Globale, Ekonomike, Fakulteti, Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi" - Shkup, (2011), f. 64

⁴⁰ europa.eu, Bruksel 2013

KREU I TRETE – IPA NË BALLKAN

3.1 IPA - PROGRAMI DHE SHTRIRJA E SAJ NË BALLKAN, KOSOVË DHE SHQIPËRI

3.1.1 IPA NË SHQIPËRI – VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

IPA NË SHQIPËRI

Gjatë viteve 2007-2013, BE-ja i ofroi Shqipërisë mbështetje financiare nëpërmjet Instrumentit të Para-Anëtarësimit (IPA), i cili përfshin pesë komponentë: (i) Asistenca e tranzicionit dhe ngritja institucionale (TAIB); (ii) Bashkëpunimi ndërkufitar; (iii) Zhvillimi rajonal; (iv) Burimet njerëzore; dhe (v) Zhvillimi rajonal. Nën statusin e Vendit Kandidat Potencial, Shqipëria ka përfituar nga Komponenti I dhe II i IPA-s, një total prej afërsisht 594 milion euro.⁴¹ Ja si duket tabela e asistencës financiare:


VITI PROGRAMUES I IPA I	NR PROJEKTEVE IPA	ALOKIMET IPA NË ML EUR	ALOKIMET (BASHKË-FINANCIMI)..	ALOKIMET TOTALE
2007	7	49.27 (34 mln në infrastrukturë)	1.5	50.77
2008	24	60.93 (26.5 mln në infrastrukturë)	6.2	67.17
2009	16	69.8 (37.1 mln në infrastrukturë)	80.1	149.9
2010	10	83.20 (68.2 mln në infrastrukturë)	129.3	212.51
2011	9	82.20 (60.5 mln në infrastrukturë)	97.1	179.15
2012	16	81.64 (37.2 mln në infrastrukturë)	15.2	96.84
2012 (menaxhim i centralizuar)	12	64.26 (22 mln në infrastrukturë)	39.4	103.64
2013 (menaxhim i centralizuar)	7	17.8 (17.8 mln në infrastrukturë)	6.9	24.7
TOTALI	101	508.86	375.7	884.56

Burimi⁴²: Shqipëria – asistenca financiare nën IPA II, Komisioni Evropian

⁴¹ <http://www.eupolicyhub.eu/ep-content/uploads/2018/12/Hub-Monitor-Brief-4.pdf>, shikuar 3.11.2020

⁴² Po aty, www.eupolicyhub.eu

**Tabela: PROJEKT KOMBËTARE PËR
PERIUDHËN 2007-2013 DHE KOSTOT
INDIKATIVE NR PROJEKTEVE IPA**



Grafikoni par periudhën 2007-2013

Fushat kryesore të asistencës së BE-së për Shqipërinë përfshin zhvillimin ekonomik dhe social sikur edhe stabilizimin demokratik. IPA siguron që projektet e ndërtimit të institucioneve do të vazhdojnë, për të rritur efikasitetin e organeve ekzekutive dhe legjislativ të Shqipërisë. Mbështetje i jepet Tiranës Zyrtare edhe në ofrimin e qartësisë juridike në pronësinë private si dhe në përmirësimin e zbatimit të sundimit të ligjit. Fondet e IPA-s promovojnë përfshirjen sociale dhe ekonomike të pakicave dhe grupeve të cënueshme, projekteve për antikorrupsion dhe zhvillim të shoqërisë civile për të kontribuar në stabilizimin demokratik. Duhet të themi se në Shqipëri funksionon **Drejtoria për Menaxhimin Financiar IPA dhe Kontrollin e Nivelit të Parë për ETCP**. Misioni i Drejtorisë për Menaxhimin Financiar IPA dhe Kontrollin e Nivelit të Parë për ETCP është që të sigurojë menaxhim efektiv dhe eficient financiar të kontratave të financuara nga fondet IPA. Funksionet kryesore të Drejtorisë për Menaxhimin Financiar IPA dhe Kontrollin e nivelit të parë për ETCP janë :

- a) Menaxhimi financiar i projekteve IPA në përputhje me rregulloret financiare, legjislacionin shqiptar dhe manualeve të procedurave.
- b) Validimet e shpenzimeve për projekt partnerët shqipëtarë në kuadër të programeve Territoriale ETCP.
- c) Validimet e shpenzimeve për projekt partnerët shqipëtarë në kuadër të programi të Bashkepunimit Ndërkufitar CBC.

Drejtoria ka në strukturën e saj:


- Sektorin për Menaxhimin Financiar IPA dhe CBC
- Sektorin për Kontrollin e Nivelit të Parë për ETCP.⁴³

Shembuj tjerë të sektorëve të mbështetur janë:

- Transporti,
- Mjedisi sikurse edhe
- Zhvillimi rural dhe rajonal...

Asistenca financiare e IPA-s (2007 - 2013) për Shqipërinë							
KOMPONENTI	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
INSITUCIONE	54.3	62.1	70.9	82.7	84.3	75.9	87.4
BASHKËPUNIMI RAJONAL	6.6	8.5	10.2	10.4	10.6	10.9	10.6
TOTALLI	61	70.7	81.2	93.2	95	95	98.1

Burimi: komisioni Evropian, faqja zyrtare, Bruksel, 2013



Grafikoni për IPA 2007-2013

Tabela nr 5, ndihmesa për Shqipërinë në periudhën 2007-2012

Gjithashtu, financimi i IPA-s synon forcimin e bashkëpunimit ndërkufitar të Shqipërisë me Greqinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut, dhe pjesëmarrjen e Shqipërisë në programin transnacional “Evropa Jug-Lindore” i cili promovon integrimin më të mirë përgjatë tërë rajonit. BE ka financuar ndërtesën e re të gjykatës në Vlorë të Shqipëri. Demokracia dhe sundimi i ligjit në vend do të konsolidohet edhe më tej përmes projektit 30-mujor të IPA-s në vlerë €4.5

⁴³ <https://cfcu.financa.gov.al/sq/drejtoria-per-menaxhimin-financiar-ipa-dhe-kontrollin-e-nivelit-te-pare-per-etcp/>

milionëshe i lansuar në maj të 2008 për të ndihmuar zhvillimin e një sistemi gjyqësor të pavarur, të paanshëm e modern.

Në këtë pjesë të studimit do të japim dhe informacionin lidhur me forumin e Politikave të Integritit që monitoron nga afër procesin e integritit në Bashkimin Evropian dhe institucionet e përfshira në të, duke u përqendruar kryesisht në koordinimin ndër-institucional ndërmjet njësive dhe dokumenteve dhe raporteve të tyre ligjore. Treguesit e monitorimit dhe rregullat metodologjike përfshijnë aktet normative dhe/ose legjislative të miratuara; aktivitetet e kryera (numri i takimeve, plan-veprimeve, raportet, strategjitë për të adresuar mangësitë e identifikuara nga raporti i KE, etj.); fazën e zhvillimit paraprakisht të instrumenteve; si dhe shqyrtimin institucional dhe publik të rezultateve të arritura.⁴⁴

Ky studim jo dhe aq i shkurtër i politikave financiare synon të japë një vlerësim kritik mbi programimin dhe zbatimin e fondeve IPA I në Shqipëri, duke identifikuar arritjet thelbësore, sfidat dhe pengesat potenciale të hasura gjatë zbatimit të programeve IPA në Shqipëri.⁴⁵ Gjithashtu, ai do të vlerësoj përgatitjet e administratës publike shqiptare në menaxhimin e fondeve, duke analizuar kapacitetet absorbuese të administratës qendrore dhe lokale, si dhe do të sugjeroj disa alternative të mundshme për të përmirësuar këtë sistem, duke përfshirë shoqërinë civile në procesin e programimit dhe zbatimit të fondeve IPA. Në këtë kuadër, sugjerohet që administrata shqiptare të eci në një hap me rekomandimet e vlerësuesve të Komisionit Evropian, si dhe ti përshtatë gradualisht këto rekomandime me situatat specifike, duke zhvilluar një qasje standarde për përgatitjen e strategjive sektoriale, duke përfshirë përmirësimin e përmbajtjes së këtyre strategjive, objektivat, planifikimet buxhetore, dhe duke praktikuar procesin e konsultimit dhe kontrollin e cilësisë, me qëllim dhënien e perspektivave koherente dhe gjithëpërfshirëse të prioriteteve kombëtare që mund të përdoren për programimin e IPA-ve.


⁴⁴ HUB MONITOR ISSUE BRIEF 1 ,Shtator, 2017, f.1

⁴⁵ http://www.eupolicyhub.eu/ep-content/uploads/2017/09/Mesimet_e_nxjerra_nga_nderhyrja_e_fondev.pdf, shikuar më 3.11.2020

Tabela: PROJEKT KOMBËTARE PËR PERIUDHËN 2007-2013 DHE KOSTOT INDIKATIVE				
VITI PROGRAMUES I IPA I	nr projekteve IPA	alokimet IPA në ml eur	Alokimet (bashkë-financimi)..	Alokimet totale
2007	7	49.27 (34 mln në infrastrukturë)	1.5	50.77
2008	24	60.93 (26.5 mln në infrastrukturë)	6.2	67.17
2009	16	69.8 (37.1 mln në infrastrukturë)	80.1	149.9
2010	10	83.20 (68.2 mln në infrastrukturë)	129.3	212.51
2011	9	82.20 (60.5 mln në infrastrukturë)	97.1	179.15
2012	16	81.64 (37.2 mln në infrastrukturë)	15.2	96.84
2012 (menaxhim i centralizuar)	12	64.26 (22 mln në infrastrukturë)	39.4	103.64
2013 (menaxhim i centralizuar)	7	17.8 (17.8 mln në infrastrukturë)	6.9	24.7
TOTALI	101	508.86	375.7	884.56

Burimi: Asistenca financiare për Shqipërinë, sipas Komisionit Evropian

⁴⁶ Tabela nr.6 Informata e pranimit të fondeve



Si rezultat i programimit nën komponentin IPA TAIB, Qeveria Shqiptare ka nënshkruar me Komisionin Evropian (KE) marrëveshjet vjetore përkatëse për çdo vit programues, duke i hapur rrugën zbatimit të 101 projekteve kombëtare (shiko tabelën 1), që adresojnë kriteret ekonomike, politike dhe standardet evropiane dhe bashkëpunimin rajonal. Mbështetja me fondet IPA kishte si qëllim të përgatiste vendet candidate potenciale dhe ato candidate të Ballkanit Perëndimor në menaxhimin të fondeve të ardhshme strukturore dhe ato të kohezionit, njëherë që

⁴⁶ Burimi: Shqipëria – asistenca financiare nën IPA II, Komisioni Evropian

ato bëheshin vende anëtare. Fondet janë dhënë në bazë të koherencës me politikat e BE-së dhe në mbështetje të përafrimit të legjislacionit të Bashkimit Evropian.⁴⁷ Në rastin e Shqipërisë, projektet e komponentit të parë (TAIB) u përzgjedhën në linjë me prioritetet e identifikuar në Dokumentin e Planifikimit Indikativ Shumëvjeçar (MIPD) dhe dokumenteve të tjerë të BE-së dhe të Shqipërisë, në vijim të analizës së kryer nga Komisioni Evropian në bashkëpunim me autoritetet shqiptare. Janë marrë në konsideratë gjatë përzgjedhjes së projekteve IPA elementë të tillë si urgjenca e ndërhyrjes me asistencë financiare, mbështetja e prioriteteve të identifikuar në dokumentet strategjike, mundësia për të punuar mbi projekte të mbështetura nga ndërhyrjet e mëparshme, si dhe niveli i përgatitjes dhe pronësia mbi projektet e propozuara. Janë përdorur njëmbëdhjetë forma të asistencës së para-anëtarësimit nën komponentin IPA TAIB siç vërehet në tabelën 2. Tabela 2: Komponenti 1 (TAIB) – Format e asistencës. Shuma e ndihmës financiare të fituara në periudha:

2014	2015	2016	2017	2018-2020
83,7	86,9	89,7	92,9	296,3

Tabela nr. 7 ⁴⁸

Ndërsa Maqedonia e Veriut :

85,7	88,9	91,6	94,9	303,1	664,2
------	------	------	------	-------	-------

Tabela nr. 8

Format e asistencës	vendet kandidate potenciale	vendet kandidate
Binjakëzimi/binjakëzimi i zbutur	√	√
TAIEX	√	√
Asistencë teknike	√	√
Investime në asqius	√	√

⁴⁷ HUB MONITOR ISSUE BRIEF 1 | Shtator | 2017, f.3

⁴⁸ Dokumenti strategjik tregues për vendet (2014-2020), miratuar më 30.6.2014. Dokumenti mbi Bosnjën dhe Hercegovinën nuk ishte miratuar ende në atë kohë.

Skema e granteve	√	√
Instrument për përgatitjen e projekteve	√	√
Lehtësime financiare	v	√
Kontribut financiar		√
Asistencë në formë mbështetje buxhetore		√
Instrument i asistencës teknike, administratë publike	√	√
Asistencë e duhur për kostot	√	√
Mbështetje për ipa III, IV dhe V, grantet		√

Tabela nr. 9

VITI PROGRAMUES	TITULLI I PROJEKTIT	SHUMA NË MLN EUR	INST PËRFITUES	VLERËSIMI POZITIV	PËRSER KONSIDEROHET I SUKSESSHËM
IPA 2007	PAMECA III	5.5	POLICIA	IMPAKTI POZITIV	NDIKIM TEK REALIZIMI I PRIORITETEVE
IPA 2007	MBËSHTJETJE BURGJEVE	10	MINISTRIA E DREJTËSISË	EFEKTIVITET	NDIKIM TEK REALIZIMI I PRIORITETEVE
IPA 2007	UJËSJELLËSI DHE KANALIZIMI	24	DREJTRIA E UJËSJELLËSIT	IMPAKT NË KOMUNITET	NDIKIM TEK REALIZIMI I PRIORITETEVE
IPA2008	RIKONTUKSION RRUGEVE RURALE	8	FSZH	IMPAKT NË KOMUNITET	NDIKIM TEK REALIZIMI I PRIORITETEVE
IPA 2008	SHKOLLA PROFESIONALE	7	MINISTRIA E ARSIMIT	EFIÇENCË NË ZBATIM	NDIKIM TEK REALIZIMI I PRIORITETEVE
IPA 2009	TRASHIGIMIA KULTURORE	5	MINISTRIA E TURIZMIT	IMPAKT NË AMBIENT	POLITIKË RAJONALE, UNESCP

Burimi: Lista e disa projekteve të IPA I – në infrastrukturë

VITI PROGRAMUES	TITULLI I PROJEKTIT	SHUMA NË MLN EUR	INST PËRFITUES	VLERËSIMI POZITIV	PËRSER KONSIDEROHET I SUKSESSHËM
IPA 2008	INFRASTRUKTURË	3	MINISTRI EKONOMISË	IMPAKT NË TREG	NDIKIM TEK REALIZIMI I PRIORITETEVE
IPA 2008	AUTORITETI I KONKURENCËS	1.5	DEP PËR TË HUAJT	IMPAT	NDIKIM TEK REALIZIMI I PRIORITETEVE

Burimi: Lista e disa projekteve të IPa I – projekte në asistencë teknike

Tabela nr .10 asistencat financiare për Shqipërinë

Më lartë kemi dhënë në forma përshkruese tabelore disa PROJEKTET E SUKSESSHME Asistenca e BE-së ka dhënë mbështetje të prekshme për zhvillimin social dhe ekonomik të Shqipërisë, në linjë me prioritetet kombëtare. Nga pikë-vështrimi analitik, investimet në infrastrukturë janë të prekshme dhe të dukshme në termat e përfitimeve të sjella për qytetarët shqiptarë dhe për qëndrueshmërinë e tyre. Fondet IPA mbështetën projekte të mëdha në fushën e transportit, mjedisit, bujqësisë, sistemit gjyqësor, rrugëve rurale, etj. Gjithashtu, shumë ndërhyrje të fondeve IPA adresuan aftësimin e krahut të punës, duke nxitur pritshmërinë dhe rritjen e konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve të vogla e të mesme. Për shembull, konstruksioni i rrugës së re që lidh Hanin e Hotit me Tamarën, ose përfundimi i punimeve për restaurimin e qendrave historike urbane të Elbasanit, Shkodrës, Beratit dhe Korçës, patën një efekt konkret dhe të menjëhershëm në përmirësimin e jetës së qytetarëve që u preken nga këto investime. Gjithashtu, instalimi i 14 ujësjellësve apo ndërtimi i 2 rrugëve sekondare, ajo e Vlorës dhe Rogozhinës, si dhe porti i Shëngjinit, kanë përmirësuar potencialet e vendit dhe kanë efekt direkt në ekonomi. Projektet e programit IPA 2013 janë ende në fazë zbatimi.⁴⁹

Fondet e IPA, sikurse asistenca e mëparshme e BE-së nëpërmjet programeve Phare dhe CARDS, i janë dhënë vendeve të përfshira në Procesin e Stabilizim Asociimit në formën e granteve, e cila përfshin kryesisht asistencën teknike dhe projektet infrastrukturorë. Në fillim të procesit administrata shqiptare nuk ishte e përgatitur për të programuar vet fondet IPA dhe është logjike që kërkohej mbështetje për ngritjen e kapaciteteve të stafit të institucioneve përfituese në ministritë e linjës. Në kohën kur IPA 2007 filloi programimin, administrata shqiptare ishte duke u përballur me sfida të ndryshme në kuadër të zbatimit të rregullave dhe kërkesave të BE-së. Ishte e nevojshme të kërkohej asistencë teknike për të përgatitur projekt serioz, të krijohehin lidhjet e nevojshme mes ministrive të linjës dhe institucioneve qendrore, si dhe të rritej ndërgjegjësimi mbi rëndësinë e pronësisë për menaxhimin e fondeve IPA. Fondet IPA janë dhënë mbi baza të nevojave/prioriteteve institucionale, të cilat ishin përfshirë në dokumentet strategjike, si MIPD dhe Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013. Procesi programues ishte zakonisht i gjatë, rreth një vit e gjysmë, nga identifikimi i prioritetëve deri në miratimin e

⁴⁹ HUB MONITOR ISSUE BRIEF 1 | Shtator | 2017, f.4

Marrëveshjes Financiare nga Këshilli i Ministrave dhe nënshkrimi nga Koordinator i Kombëtar i IPA-s, që i hapte rrugën procedurave të mëtejshme në funksion të zbatimit të projekteve.⁵⁰

Fushat kryesore e asistencës së BE-së për Shqipërinë përfshin zhvillimin ekonomik dhe social sikur edhe stabilizimin demokratik. IPA siguron që projektet e ndërtimit të institucioneve do të vazhdojnë, për të rritur efikasitetin e organeve ekzekutive dhe legislative të Shqipërisë. Mbështetje i jepet Tiranës Zyrtare edhe në ofrimin e qartësisë juridike në pronësinë papaja private si dhe në përmirësimin e zbatimit të sundimit të ligjit.

Fondet e IPA-s promovojnë përfshirjen sociale dhe ekonomike të pakicave dhe grupeve të cenueshme, projekteve për anti-korrupsion dhe zhvillim të shoqërisë civile për të kontribuar në stabilizimin demokratik. Shembuj tjerë të sektorëve të mbështetur janë:

Transporti,


Mjedisi sikurse edhe

Zhvillimi rural dhe rajonal.

Asistenca Financiare e IPA-s (2007-2013) për Shqipërinë							
Komponenti	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Institucione	54.3	62.1	70.9	82.7	84.3	85.9	87.4
Bashkëpunimi rajonal	6.6	8.5	10.2	10.4	10.6	10.9	10.6
Totali	61	70.7	81.2	93.2	95	95	98.1

Tabela nr.11 . Burimi; Commission of the European Communities, faqja zyrtare, Bruksel 2013.

⁵⁰ HUB MONITOR ISSUE BRIEF 1 | Shtator | 2017, f.2



Grafikoni me përqindje

Gjithashtu, financimi i IPA-s synon forcimin e bashkëpunimit ndërkuftar të Shqipërisë me Greqinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë, dhe pjesëmarrjen e Shqipërisë në programin trans-nacional “Evropa Jug-Lindore” i cili promovon integrimin më të mirë përgjatë tërë rajonit.

BE ka financuar ndërtesën e re të gjykatës në Vlorë të Shqipëri. Demokracia dhe sundimi i ligjit në vend do të konsolidohet edhe më tej përmes projektit 30-mujor të IPA-s në vlerë €4.5 milionëshe i lansuar në maj të 2008 për të ndihmuar zhvillimin e një sistemi gjyqësor të pavarur, të paanshëm e modern.

Zgjerimi i Bashkimit Evropian ka qenë gjithmonë proces dydrejtësh. Shtetet anëtare të reja përfitojnë nga fakti i anëtarësisë në këtë organizatë unike, blloku më i madh tregtar i botës dhe ushtrimi më i avancuar në qeverisjen e përbashkët.⁵¹ BE fiton duke u zgjeruar në territore më të gjëra, duke mirëpritur kultura të reja, dhe duke u lidhur me tregje të reja. Përgjatë viteve të fundit, ky proces dydrejtësh ka marrë një dimension shtesë pasi që BE ka filluar të integrojë vende nga Evropa Qendrore dhe Lindore. Shumë shtete kandidate është dashur të ndërmarrin reforma rrënjësore- ekonomike, politike dhe sociale, për tu kualifikuar për anëtarësim në BE. Reformat sjellin përfitime në vendet të cilat i plotësojnë kriteret, por shpesh kërkojnë investime të kushtueshme dhe paraqesin sfida afatshkurta për vendet në rrugën e tyre drejt anëtarësimit. Si përgjigje, BE ka ofruar shumë forma të ndryshme të asistencës në para dhe ekspertizë- për vendet që i marrin detyrat e anëtarësimit. Që nga 2007, e gjithë asistenca e BE-së për vendet me perspektivë për anëtarësim në BE- nga Ballkani Perëndimor- është sjellë nën një titull,

⁵¹ http://www.eeas.europa.eu/archives/delegations/kosovo/documents/publications/ipa_sq.pdf, shikuar më 3.11.2020

Instrumenti për Asistencë të Para-Anëtarësimit (IPA). Kjo ka sjellë një fokus të ri të BE-së për asistencë zgjerimit.⁵²

ASISTENCA FINANCIARE E IPA-S (2007-2013) NË TOTAL								
PROGRAMI		2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
TOTALI I PROGRAMEVE DHE TË VENDEVE		1.109.4	1.308.6	1.303.9	1.399.4	1.547.0	1.680.0	1.749.0
PROGRAMI PËR TRANZICION		108.9	135.7	166	138.9	173.4	168.8	183.8
PROGRAMI PËR BASHKËKPUNIM		0	0	0	4.9	5.2	5.6	6
MBËSHTEJTJE PËR SHPENZIME		44.7	51.9	47.6	52	75	80.5	84.5
TOTALI I PROGRAMEVE DHE TË VENDEVE		1.263.2	1.494.2	1.517.6	1.796.7	1.796.8	1.935.7	2.023.8

BURIMI: Komisioni Evropian, faqja zyrtare, f. 9, Bruksel 2011


Tabela nr. 12 fondi total i ndihmesës

ASISTENCA FINANCIARE E BË-SË NËPËRMJET IPA 2007-2012							
	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2007-2012
KROACIA	141.2	146	151.2	154.3	157.2	160.4	910.2
MAQEDONIA E VERIUT	58.5	70.2	81.8	92.3	98.7	105.8	507.3
TURQIA	497.2	538.7	566.4	653.7	781.9	899.5	3937.4
KOSOVA	68.3	184.7	1.6.1	67.3	58.7	70	564.1
SHQIPËRIA	61	707.7	81.2	93.2	95	96.9	498
BOSNJA	62.1	74.8	89.1	106	108.1	110.2	550.3
MALI I ZI	31.4	32.6	33.3	34	34.7	34.4	201.4
SERBIA	189.7	190.9	194.8	198.7	202.7	204.8	1183.6
VENDET E TJERA	109	135.7	160	157.7	160.8	164.2	887.4
TOTALI	1218.4	144.3	1463.9	1557	1707.8	1849.2	9240.7

BURIMI: Komisioni Evropian, faqja zyrtare, Bruksel, 2012

Tabela nr 13. Të dhënat e Zyrës KE për Kosovën

⁵² <http://www.eeas.europa.eu/>, shikuar më 3.11.2020



Grafikoni për Asistencën financiare BE-së nëpërmjet IPA 2007

Komisionari i BE-së për Financa, Olli Rehn, ka thënë se thelbi i çështjes në procesin e zgjerimit të BE-së është në reformat politike, ekonomike dhe institucionale që çojnë në rezultatet në terren, në secilin vend. “Ata duhet të reagojnë në këtë proces sfidues. Por ata nuk janë vetëm. BE qëndron në anën e tyre me mbështetje politike, këshilla teknike dhe asistencë të konsiderueshme financiare për t’iu ndihmuar atyre t’i ndërmarrin këto reforma”. Fusha e financimit nga IPA. IPA ofron asistencë në forma të ndryshme për vendet që ndërmarrin reforma politike dhe ekonomike në rrugën e tyre drejt anëtarësimit në BE: Investime, kontrata prokurime apo subvencione,

- Ekspertë të shteteve anëtare për të ndërtuar bashkëpunim administrativ,
- Veprime në mbështetje të vendit përfitues,
- Ndihmë në implementimin dhe menaxhimin e programeve; në raste të jashtëzakonshme, mbështetje buxhetore dhe Asistenca që lidhen me përmirësimin e kushteve në vendet përfituese dhe afrimi i tyre

- dhe qytetarëve të tyre me BE-në. Në qershor të vitit 2007 Komisioni Evropian ka finalizuar planin e parë strategjik të asistencës nën IPA për vitet 2007-2009. Ky program ishte i bazuar në nevojat specifike të secilit vend, dhe i ka renditur prioritetet për asistencën financiare. Programi për shumë vende po ashtu mbështetë projektet e përbashkëta rajonale. Projektet kryesore mbështeten në këto fusha: Projektet e përbashkëta të bashkëpunimit,

- Infrastrukturës, • Drejtësisë dhe çështjeve të brendshme,
- Tregut të brendshëm dhe tregtisë, • Ekonomisë së tregut,
- Mbështetjes së shoqërisë civile Arsimimit,
- Rinisë dhe hulumtimit,

- Planifikimi strategjik freskohet çdo vit.
- “Asistenca e ofruar do të përdoret në fushat në vijim: forcimi i institucioneve demokratike, sikur edhe sundimit të ligjit, përfshirë forcimin e tij; promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore dhe respektin e rritur për të drejtat e pakicave, promovimin e barazisë gjinore dhe jodiskriminimit; reformën e administratës publike; reformën ekonomike; zhvillimin e shoqërisë civile; përfshirjen sociale; pajtimin, masat për ndërtimin e besimit dhe rindërtimin; bashkëpunimin rajonal dhe ndër-kufitar.” Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme të BE-së, Bruksel, 17 korrik 2006. BE-ja mbështetë projekte për sigurinë e transportit detar edhe në Shqipëri. Punëtorët përballen me rreziqe të sigurisë me nivel të lartë të lëndimeve aksidentale në vendin e punës. Në maj 2008 është lansuar një projekt 18-muajsh për të përmirësuar kapacitetin inspektues për shëndetësi dhe siguri të autoriteteve turke, financuar me 1.3 milion euro nga IPA. Qëllimi i IPA-s IPA është dizajnuar për të maksimizuar fokusin, precizitetin dhe ndikimin në përmbushjen e nevojave të Para-Anëtarësimit nëpërmes një kornize të vetme të thjeshtëzuar. IPA sjellë një shkallë të pajtueshmërisë dhe konsistencës në veprimin e Bashkimit Evropian, duke arritur rezultate edhe më të mira me burimet në dispozicion. IPA zëvendëson pesë instrumentet e mëhershme të Para-Anëtarësimit të BE-së: Phare, ISPA, SAPARD, dhe CARDS. IPA do t’i ndihmojë vendeve kandidate që të zbatojnë në tërësi legjislacionin e BE-së (“*Community acquis*”) në kohën që ata bëhen shtete anëtare. Vendet kandidate potenciale, siç është rasti i Kosovës ndihmohen që të për afrojnë legjislacionin e tyre në mënyrë progresive me legjislacionin e BE-së. Instrumenti i ri është po ashtu i përcaktuar që në mënyrë progresive t’iu besojë administratave të vendeve përfituese menaxhimin e fondeve të BE-së. Përveç rritjes së ndenjes së pronësisë në projektet e Para-Anëtarësimit, kjo po ashtu, do t’ju ndihmojë vendeve që të përgatiten për metodat e menaxhimit që ata do t’i përdorin pasi që të vijnë në pozitë që të përfitojnë nga fondet si shtete anëtare të BE-së. Puna e IPA-s IPA fokusohet në nevoja; kështu që, prioritetet e saj janë të bazuara në vlerësime të qarta. Elemente kryesore janë Partneritetet Evropiane/të anëtarësimit që BE-ja i ka lidhur me çdo vend përfitues, dokumenti strategjik i Komisionit për Zgjerim, dhe raportet vjetore për secilin shtet. Kriteri i shpërndarjes merr parasysh kapacitetin e çdo vendi për të përdorur dhe menaxhuar me fondet, dhe respektimin e kushteve të anëtarësimit. Dispozita e suspendimit mund të aplikohet nëse nuk janë përmbushur kushtet. Në këtë mënyrë, IPA ofron një lidhje në mes të kornizës politike për zgjerim dhe procesit të buxhetimit të BE-së. IPA përmban pesë komponente. Dy prej tyre- ndërtimi i kapaciteteve institucionale dhe bashkëpunimi ndërkufitar – janë në disponim të të gjitha vendeve përfituese.

Tri komponentet tjera – zhvillimi rajonal, zhvillimi i burimeve njerëzore dhe zhvillimi rural - i janë vënë në dispozicion vetëm vendeve candidate. Pasi që këto tri grupe të IPA-s, në veçanti, bëjnë përgatitjen për menaxhimin e fondeve strukturore të BE-së dhe mbështetjen bujqësore, ato kërkojnë kapacitete dhe struktura administrative të zhvilluara. Fondet shpërndahen në linjë me kornizën financiare trevjeçare indikative të lidhur me kornizën politike të zgjerimit. Kjo ofron informacione mbi qëllimet e Komisionit për vendet dhe komponentet. Mbi këtë bazë, dokumentet shumëvjeçare indikative të planifikimit, pastaj përgatiten për çdo vend (plus një për programin për shumë vende). Këto dokumente përmbajnë objektivat specifike të Komisionit dhe zgjedhjet e ndihmës së Para-Anëtarësimit, të cilat revidohen dhe azhurnohen për çdo vit. Përparësitë e IPA-s Instrumenti për Asistencë të Para-Anëtarësimit i jep BE-së më shumë ndikim nga investimet e saj duke u ofruar ndihmë vendeve në rrugën e tyre drejt anëtarësimit. Nga aspekti administrativ, IPA i ofron BE-së një kornizë koherente për menaxhim dhe decentralizim gradual apo delegim të menaxhimit tek vendi përfitues. Po ashtu, ajo lejon fleksibilitet në aplikimin e asistencës. IPA ofron lidhje të fortë në mes të aspekteve të buxhetimit dhe politikave të zgjerimit. Gjithashtu, ua bën të qartë vendeve përfituese se çfarë asistence mund të presin, në qoftë se i plotësojnë kërkesat e nevojshme. Në këtë mënyrë, IPA i fuqizon udhëzimet që i ofron BE për vendet candidate dhe potenciale candidate, për prioritetet që duhet të ndiqen. Por, mbi të gjitha, IPA ndihmon që këto vende, që nuk janë vetëm fqinjë të tyre, por edhe anëtarë potencial të ardhshëm për anëtarësim në BE, të zhvillojnë standardet dhe vlerat që i ndërton BE. Në këtë mënyrë, IPA është një investim real për të ardhmen- për vendet përfituese, dhe për vetë BE. IPA i sjellë fokus të ri asistencës së BE-së për zgjerim. “BE vazhdon mbështetjen e reformave dhe zhvillimit të Evropës Juglindore përmes IPA-s. Mesatarisht, alokimi vjetor për Ballkanin Perëndimor në periudhën 2007–2011 do të jetë €800 milionë. Kjo është shuma më e madhe për kokë banori e ofruar deri tani nga Komisioni për ndonjë rajon të botës”.⁵³.

⁵³ Olli Rehn, Konferenca për Zhvillimin e Shoqërisë Civile në Evropën Juglindore, Bruksel, 17 prill 2008

3.2 IPA NË KOSOVË – VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

3.2.1 PËRKRAHJA FINANCIARE NË KOSOVË PËRMES PROGRAMIT IPA

Ministrja e Integritimit Evropian në Qeverinë e Kosovës, Dhurata Hoxha, në një bisedë për Radion Evropa e Lirë thotë se vetëm gjatë viteve 2017–2020, Kosova ka arritur dhe do t'i shfrytëzojë më shumë se 300 milionë euro nga fondet IPA.⁵⁴

Asistenca financiare në kuadrin e IPA II për Kosovën për vitet 2014–2020 kap shumën e 645.5 milionë. Asistenca financiare në kuadër të IPA II ndjek katër objektivat specifike në vijim: mbështetje për reformat politike, mbështetje për zhvillim ekonomik, social dhe territorial, forcimin e aftësisë së përfituesve për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi në Bashkimin Evropian duke mbështetur harmonizimin progresiv, zbatimin dhe miratimin e Acquis të Unionit si dhe forcimin e integritimit rajonal dhe bashkëpunimit territorial.⁵⁵

IPA do të plotësojë €50 milionë të dhënë nga BE për rehabilitimin e infrastrukturës transportuese në Kosovë që nga 1999 – përfshirë urën e re në autoudhën Prishtinë-Shkup.⁵⁶

Viti 2011 - Shkurt 2011: Zëvendësdrojtori i përgjithshëm për Zgjerim i Komisionit Evropian, z. Stefano Sannino viziton Prishtinën. Sannino u takua me përfaqësues të Qeverisë së Kosovës, lider politikë, përfaqësues të shoqërisë civile dhe përfaqësues ndërkombëtarë të përfshirë në procesin e Kosovës drejt integritimit në BE. Ai inkurajoi udhëheqësit politikë dhe Qeveritarë për të përkrahur agjendën Evropiane dhe reformat si një prioritet i lartë afatshkurtër, i mesëm dhe afatgjatë, për të ardhmen e vendit.

- Shkurt 2011: Mbahet në Prishtinë takimi i dytë me radhë i Nënkomitetit për Drejtësi, Liri dhe Siguri në kuadër të Dialogut të Procesit të Stabilizim-Asociimit.

- Mars 2011: Kryeministri Thaçi dhe shefi i Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Kosovë, z. Renzo Daviddi, nënshkruajnë në Prishtinë Programin Vjetor 2010 të Instrumentit për Asistencë të Para-Anëtarësimin (IPA), paketa financiare e të cilit kap vlerën prej gjithsej €63,9 milionë.

⁵⁴ <https://gazetablic.com/kosova-ka-shfrytezuar-mbi-300-milione-euro-nga-fondet-ipa/>, shikuar më 3.11.2020

⁵⁵ Po aty

⁵⁶ http://www.eeas.europa.eu/archives/delegations/kosovo/documents/publications/ipa_sq.pdf, f. 9

- Mars 2011: Mbahet në Prishtinë takimi i dytë me radhë për bujqësi, zhvillim rural, peshkari, pylltari dhe sigurinë e ushqimit në kuadër të dialogut të procesit të Stabilizim - Asociimit.

- Mars 2011: Mbahet në Prishtinë takimi i dytë me radhë për Transport, Mjedis, Energji dhe Zhvillim Rajonal në kuadër të Dialogut të Procesit të Stabilizim - Asociimit.

- Mars 2011: Qeveria e Republikës së Kosovës miraton Rregulloren nr. 01/2011 për Departamentet për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave në Kuadër të Ministrive.

- Prill 2011: Mbahet në Bruksel takimi i dytë me radhë i Nënkomitetit për Tregun e Brendshëm, Konkurrencën, Mbrojtjen e Shëndetit dhe të Konsumatorit, në kuadër të Dialogut të Procesit të Stabilizim-Asociimit.

- Maj 2011: Ministrja e Integrimiëve e Kosovës ia dorëzon shefit të Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Kosovë, Kontributin (Inputin) e parë të autoriteteve të Republikës së Kosovës për Raportin e Progresit 2011 për Kosovën, ku përmbledhen arritjet më të rëndësishme në adresimin e sfidave të Raportit të kaluar të Progresit.

- Maj 2011: Mbahet në Prishtinë takimi i dytë me radhë i Nënkomitetit për Inovacion, Kapital Njerëzor, Politika Sociale dhe Shoqërinë Informativë në kuadër të Dialogut të Procesit të Stabilizim-Asociimit.

- Maj 2011: Mbahet në Bruksel takimi i dytë me radhë i Nënkomitetit për Tregti, Industri, Dogana dhe Tatime në kuadër të Dialogut të Procesit të Stabilizim-Asociimit.

- Qershor 2011: Mbahet në Prishtinë takimi i dytë me radhë i Nënkomitetit për Ekonomi, Financa dhe Statistika në kuadër të Dialogut të Procesit të Stabilizim- Asociimit.

- Qershor 2011: Qeveria e Republikës së Kosovës miraton Rregulloren nr. 04/2011 për Koordinimin e Donatorëve, e cila përcakton strukturat institucionale vendore në këtë fushë dhe përgjegjësitë e tyre.

- Korrik 2011: Mbahet në Prishtinë Takimi i dytë me radhë Plenar i Dialogut të Procesit të Stabilizim-Asociimit në mes të autoriteteve të Republikës së Kosovës dhe Komisionit Evropian, ku diskutohen të arriturat që nga publikimi i Raportit të Progresit 2010 për Kosovën dhe caktohen prioritetet e agjendës evropiane për periudhën në vijim.

- Korrik 2011: Mbahet në Prishtinë takimi i dytë me radhë i Komitetit të Përbashkët për Monitorim të asistencës së BE- së për Kosovën.

- Korrik 2011: Nënshkruhet në Shkup projekti i përbashkët Kosovë – Maqedoni për Bashkëpunim Ndërkufitar (BNK) në kuadër të komponentit të dytë të Instrumentit për Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA). - Gusht 2011: Ministria e Integritimit Evropian dhe Zyra Ndërlidhëse

të Komisionit Evropian në Kosovë lansojnë ciklin e programimit të pjesës nacionale të Instrumentit për Asistencë të Para-Anëtarësimit (IPA) 2012.

- Shtator 2011: Ministria e Integritimit Evropian ia dorëzon Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Kosovë, Kontributin (Inputin) e dytë me radhë të autoriteteve të Republikës së Kosovës për Raportin e Progresit 2011 për Kosovën, ku përmbledhen arritjet më të rëndësishme në adresimin e sfidave të Raportit të kaluar të Progresit.

- Shtator 2011: Ministria e Integritimit Evropian viziton Londrën për të diskutuar perspektivën Evropiane dhe procesin në cilin po kalon Kosova drejt integritimit Evropian. - Shtator 2011: Ministria e Integritimit Evropian e Kosovës dhe Ministria e Integritimit Evropian e Shqipërisë, nënshkruan në Prizren projektin e përbashkët Kosovë – Shqipëri për Bashkëpunim Ndërkufitar (BNK), në kuadër të komponentit të dytë të Instrumentit për Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA).

- Tetor 2011: Komisioni Evropian publikoi raportin e radhës për Kosovën

Viti 2012 - 28 shkurtit 2012: Këshilli i Bashkimit Evropian ka marrë parasysh mendimin e Komisionit Evropian për fillimin e Studimit të Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës.

- 7 maj 2012: Komisioni Evropian i ka dorëzuar Qeverisë së Kosovës pyetësin për përgatitjen e Studimit të Fizibilitetit. - 18 maj 2012, Komisioni Evropian ka dorëzuar pyetje shtesë. - 8 qershor 2012, Qeveria e Kosovës i ka dorëzuar në Komision Evropian përgjigjet në pyetësin për Studimin e Fizibilitetit. Kontributi i Kosovës për përgatitjen e Studimit të Fizibilitetit përbëhet nga përgjigjet në pyetësin dhe 80 anekse relevante. Përgjigjet në 444 pyetje në 105 fusha të ndryshme janë përgatitur brenda 30 ditëve.

- 8 qershor 2012: Është përgatitur Dokumenti final me përgjigje për Komisionin Evropian që përbëhet nga 1,942 faqe, nga të cilat 504 janë përgjigje në pyetje specifike dhe janë 1,483 faqe anekse. Përgjigjet janë koordinuar nga Ministria e Integritimit Evropian. Të gjitha institucionet shtetërore, të nivelit qendror dhe lokal, kanë kontribuar në përgatitjen e përgjigjeve. Përgjigjet prezantojnë situatën faktike dhe të saktë të secilit sektor të pyetësit.

- 22 qershor 2012: Në Kosovë ka qëndruar misioni faktmbledhës i cili ka mbledhur fakte rreth gjendjes në vend në raport me mundësinë e zhvillimit të mëtejshëm të procesit të Stabilizim-Asociimit, gjegjësisht të negociimit dhe implementimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimi.

- 28 gusht 2012: Qeveria e Kosovës ka dorëzuar kontributin final për Studimin e Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit. Raporti final i dorëzuar paraqet aktin

përmbyllës dhe kontributin final të institucioneve të Kosovës i cili përmbledh progresin e arritur në periudhën qershor – shtator.

- 10 tetor 2012: Studimi i Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Komisioni Evropian i sugjeron Këshillit të BE-së që të vendos për nisjen e negociatave me Kosovën për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit. - 5 dhjetor 2012: Këshilli i BE-së i kërkoi Kosovës që t'i plotësojë disa kërkesa shtesë për nisjen e negociatave për MSA-në. Kriteri kryesor ishte plotësimi i kushtit, “normalizimi i marrëdhënieve Kosovë-Serbi”.

Viti 2013 Institucionet e Kosovës kanë vazhduar dialogun me Serbinë për normalizimin e marrëdhënieve të ndërmjetësuara nga baronesha Catherine Ashton. Kosova pret që pas këtyre negociatave të marr dritën jeshile për nisjen e negociatave për MSA-në dhe procesin e liberalizimit të vizave.

3.3 PROGRAMET KRYESORE TË BE-SË NË KOSOVË

Në periudhën 1999-2013 Bashkimi Evropian është donatori më i madh në Kosovën e pasluftës së vitit 1999. Kosova në vitin 1999 doli e shkatërruar nga lufta. Sipas UNHCR 120 mijë shtëpi dhe objekte banimi ishin djegur dhe shkatërruar gjatë luftës. Popullata kishte nevojë të mëdha për strehim dhe nevojë elementare për ushqim, por edhe shërbime publike. Prandaj, me të mbaruar lufta mbështetja kryesore e BE-së në Kosovë kishte të bënte me strehimin dhe ndërtimin e infrastrukturës elementare për jetë. Më 10 qershor 1999, Kosova u vendos nën administrimin e OKB-së, ndërsa në bazë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së u themelua Administrata e Përkohshme e njohur si UNMIK. Komisioni Evropian ka drejtuar Agjencinë Evropiane për Rindërtim, si dhe shtyllën e BE-së brenda UNMIK-ut, e cila ishte përgjegjëse për rindërtimin ekonomik. ECHO është agjencia humanitare e BE-së e cila ka ofruar ndihmë humanitare për Kosovën. Shtetet anëtare të BE-së gjithashtu kanë dhënë kontribut për rindërtimin e Kosovës, përmes menaxhimit të programeve të rëndësishme të asistencës.

3.3.1 Përkrahja e BE-së për Kosovën në vitin 1999

Programi i veprimit i Komisionit Evropian në Kosovë për vitin 1999 arrinte në rreth 127 milionë euro. Kjo shumë ishte menaxhuar dhe zbatuar nga Task Force e Komisionit Evropian për rindërtimin e Kosovës, deri në shkurt të vitit 2000 kur ishte themeluar Agjencia Evropian për Rindërtim (AER). Sektorët në të cilët janë alokuar fondet e BE-së në vitin 1999 ishin: 62.5

milione euro, për rindërtimin ekonomik, 5 milione, për shërbimet e përgjithshme publike, 6 milione, për administratë lokale dhe transport, 1 milion, spitali në Mitrovicë dhe 35.5 milione, programi i integruar i rehabilitimit.

3.3.2 Përkrahja e BE-së për Kosovën në vitin 2000

Viti 2000 nisi me jetësimin e Agjencisë Evropiane për Rindërtim e cila menaxhoi një fond të BE-së në vlerë 263 milione euro. Kjo ishte një lidhje e projekteve të ndryshme individuale të cilat janë aprovuar gjatë tërë vitit, varësisht prej fondeve në dispozicion dhe suksesit të projekteve fillestare. Sektorët në të cilët janë alokuar fondet e BE-së në vitin 2000 ishin: 191.5 milione euro, në energjetikë, strehim dhe trajtim të mbeturinave, 25 milione, për zhvillim të ndërmarrjeve, 3.5 milione, nevoja urgjente dhe 10 milione euro, në shëndetësi.

3.3.3 Përkrahja e BE-së për Kosovën në vitin 2001

Programi i AER-it për vitin 2001 arrin vlerën 285 milione euro.

Në fakt, kjo paraqet një lidhje të dy projekteve të ndryshme të cilat janë aprovuar kah fundi i vitit 2000, me idenë se ato do të përfshihen në buxhetin e vitit 2001 dhe do të zbatohen në vitin 2001. Sektorët në të cilët janë alokuar fondet e BE-së në vitin 2001 ishin: 44.5 milione euro, për zhvillimin e ndërmarrjeve, energjetikë, qeverisje lokale dhe shoqëri civile, 100 milione euro strehim, ambient, ujësjellës, bujqësi dhe 171 milione euro, faza e dytë për energjetikë, transport dhe bujqësi.

3.3.4 Përkrahja e BE-së për Kosovën në vitin 2002

Kostoja e projekteve të BE-së për vitin 2002 ishte 136 milione euro. Ky program vjetor bazohej në rindërtimin substancial dhe ndihmën e zhvillimit të zotuar për Kosovën që nga viti 1999. Programi i vitit 2002 është i përqendruar ka mbështetja institucionale dhe rindërtimi i kapaciteteve, për ta përgatitur Kosovën për të për të kaluar në një ekonomi të tregut në përputhje me Procesin e Stabilizim-Asociimit.

Sektorët në të cilët janë alokuar fondet e BE-së në vitin 2002 ishin: 9.7 milione, Reforma e administratës publike, 5 milione, shëndetësia, 7 milione, drejtësia dhe çështjet e brendshme, 55 milione, energjetika, 6 milione, transporti, 5 milione ambienti dhe ujësjellësit, 10 milione, zhvillimi ekonomik, 9 milione, zhvillimi rural, 16 milione, strehimi, 4.5 milione, edukimi, 4.3 shoqëria civile, 2 milione, asistencë teknike dhe administrative dhe 2.5 milione rezervat e programit.

3.3.2.5 Përkrahja e BE-së për Kosovën në vitin 2003

Gjatë vitit 2003 ndihmat e BE-së në Kosovë ishin përqendruar në ndërtimin e kapaciteteve institucionale, reformën e administratës publike dhe zhvillimin ekonomik për të përgatitur edhe më tej Kosovën për tu bërë një ekonomi e tregut.

Vlera e ndihmës së BE-së për zhvillimin e Kosovës në vitin 2003 ishte 46 milionë euro. Sektorët në të cilët janë alokuar fondet e BE-së në vitin 2003 ishin: 5 milionë, reforma e administratës publike, 5 milionë, drejtësia dhe punët e brendshme, 14 milionë, energjetika, 4.5 milionë, ambienti, 10 milionë, zhvillimi ekonomik, 6.5 milionë, zhvillimi rural, 3 milionë, edukimi universitar, 1 milionë, shoqëria civile dhe 2 milionë, asistenca teknike.

3.3.6 Përkrahja e BE-së për Kosovën në vitin 2004

Programi vjetor i Kosovës për vitin 2004 përqendrohet në ndërtimin e institucioneve, promovimin e qeverisjes së mirë dhe zhvillimin ekonomik. Programi i BE-së është zbatuar edhe në partneritet me donatorët e tjerë, veçanërisht me shtetet anëtare të BE-së, institucionet e Kosovës dhe UNMIK-un. Vlera e ndihmës së BE-së për zhvillimin e Kosovës në vitin 2004 ishte 49 milionë euro.

3.3.7 Përkrahja e BE-së për Kosovën në vitin 2005

Programi veprues i Komisionit Evropian për vitin 2005 për Kosovën është ndërtuar mbi rezultatet e programeve të mëparshme të Komisionit Evropian për Kosovën dhe ishte komplementar me komponentët e programit veprues. Programi i BE-së për vitin 2005 ishte në harmoni me Programin Regional CARDS dhe iniciativën për Paktin e Stabilitetit. Vlera e programit të BE-së për vitin 2005 ishte 54 milionë euro. 5 milionë, të drejtat e minoriteteve dhe kthimi, 1 milion, shoqëria civile dhe mediat, 5.6 milionë, drejtësia dhe punët e brendshme, 1.5 milion, menaxhimi i integruar i kufijve, 11 milionë, reforma e administratës publike, 1.5 milion, doganat dhe tatimet, 11.7 milionë, strategjia publike e zhvillimit të ndërmarrjeve, 5.2 milionë, ekonomia rurale, 4 milionë, energjia, 3 milionë, ambienti, 1 milion, arsimit i lartë, 2 milionë, arsimit profesional dhe trajnimi dhe 1.5 milion, ndihma e përgjithshme teknike.

3.3.8 Përkrahja e BE-së për Kosovën në vitin 2006

Programi i BE-së për Kosovën në vitin 2006 është përqendruar në ndërtimin e institucioneve, promovimin e qeverisjes së mirë dhe zhvillimin ekonomik për të gjitha komunitetet. Programi gjatë këtij viti konsolidon fazat e mëparshme të ndihmës së BE-së për Kosovën. Vlera e programit të BE-së për vitin 2006 ishte 46.5 milionë euro. 5 milionë, të drejtat e pakicave dhe kthimet, 0.5 milion, shoqëria civile dhe mediat, 6 milionë, drejtësia dhe çështjet e brendshme, 1.5 milion, menaxhimi i integruar i kufirit, 8 milionë, reforma e administratës publike, 8.5 milionë, strategjia ekonomike e zhvillimit të ndërmarrjeve, 5 milionë, ekonomia rurale, 4.9 milionë, energjetika dhe transporti, 3 milionë, ambienti, 1.5 milion, edukimi dhe trajnimi profesional dhe 2.6 milionë, asistenca e përgjithshme teknike. Për të shtuar ndikimin e asistencës së IPA-s dhe për t'u fokusuar më shumë në rezultate të arritshme, Komisioni Evropian i ka fokusuar përpjekjet e tij

në sektorët specifikë. Një qasje sektoriale synon lehtësimin e bashkëpunimit në mes të donatorëve dhe përfituesve, aty ku është e mundur, duke eliminuar dyfishimin e përpjekjeve dhe në mënyrë rritet efikasiteti dhe efektiviteti. Deri më tani, numri i programeve të plota sektoriale të zhvilluara nga vendet përfituese të IPA-s është i kufizuar. Megjithatë, duke filluar që gjithnjë e më shumë të përqendrohet në sektorë prioritarë, Komisioni Evropian do të mund të mbështesë më shumë zhvillimin e programeve të tilla, në të cilat mund të bazohet asistenca e BE-së dhe e donatorëve të tjerë. Nismat e marra parasysh nga Komisioni do të ndihmonin Kosovën të lëvizë para në fushën e vizave, tregtisë, mbikëqyrjes ekonomike dhe fiskale, programeve të BE-së, Dialogut të Procesit të Stabilizim-Asociimit (PSA) dhe bashkëpunimit ndërkufitar. Këto fusha përputhen me agjendën evropiane të Kosovës. Për t'i përmbushur prioritetet e zgjedhura për mbështetje në periudhën e programimit 2011- 2013, Komisioni Evropian është fokusuar kryesisht në ndihmën e tij në këta sektorë: 1. Drejtësia dhe Punët e Brendshme (me fokus në liberalizimin e vizave dhe gjyqësor), 2. Zhvillimi i sektorit privat (me fokus në tregti dhe mjedisin biznesor) .

3.3.9 Përkrahja e BE-së për Kosovën në vitet 2007-2013

Në vitin 2007 Kosova ka përfituar financiarisht nga BE-ja 68.3 milionë euro, në vitin 2008 184.7 milionë euro, në vitin 2009 106.3 milionë euro, në vitin 2010 67.3 milionë euro, në vitin 2011 68.7 milionë euro dhe në vitin 2012 70 milionë euro. Përkrahja financiare e BE-së nga viti 2007 ka filluar të bëhet nëpërmes fondeve të IPA. Më shumë detaje do të jepen në kapitullin e veçantë për IPA programin. Synimi i përgjithshëm i asistencës financiare të BE-së në Kosovë është të mbështesë përpjekjet e saj për reforma drejt arritjes së pajtueshmërisë me standardet e BE-së dhe progresin në zbatimin e reformave të agjendës evropiane. Agjenda Evropa 2020 u jep vendeve në procesin e zgjerimit një frymëzim të rëndësishëm për reforma. Politika e zgjerimit të përpiluar nga BE-ja mbështesin strategjinë Evropa 2020, duke zgjeruar tregun e brendshëm dhe rritjen e bashkëpunimit në fusha ku bashkëpunimi ndërkufitar është i rëndësishëm. Zakonisht raportet e progresit që i përgatit Komisioni Evropian për Kosovën merren si udhërrëfyes për asistencën financiare të BE-së. Ta zëmë konkluzionet e Raportit të Progresit të Komisionit për vitin 2010 për Kosovën konfirmojnë se “Kosova ka bërë progres për sa i përket kriterëve politike. Kosova ka shtuar përkushtimin e saj ndaj agjendës evropiane dhe reformimit të politikave. Kosova gjithashtu ka bërë progres sa i përket reformës së sistemit gjyqësor, me miratimin e katër ligjeve të rëndësishme. Ndikimi i krizës ekonomike në ekonominë e Kosovës ka qenë i kufizuar. Kosova ka arritur progres të kufizuar drejt krijimit të një ekonomie funksionale të tregut. Progresi në

përafrimin e legjislacionit dhe politikave të Kosovës me standardet evropiane vazhdon të jetë i përzier. Në fushën e tregut të brendshëm të BE-së ka pasur pak progres sa i përket zhvillimit të kornizës ligjore”.⁵⁷. “Megjithatë, raporti gjithashtu konfirmon që kapaciteti i administratës publike mbetet i dobët dhe gjyqësori nuk funksionon efektivisht. Ekzistojnë disa strategji sektoriale; disa prej tyre janë miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Megjithatë, Kosova synon t’i ndërlidhë strategjitë e saja me procesin buxhetor. Kosova e modifikon listën e prioritetëve duke pasur parasysh edhe alokimin e asistencës nga IPA. Komisioni Evropian ka hartuar një qasje të bazuar në sektorë (QBS) në Kosovë. Janë përdorur pesë kritere të vlerësimit për të vlerësuar mundësinë e futjes në përdorim të QBS-së, e këto janë: 1. Ekzistenca e strategjive sektoriale që përshkruajnë objektivat e qeverisë dhe që mund të përdoren për të zhvilluar plane vjetore në bazë të prioritetëve të caktuara, 2. Strategjitë sektoriale të mbulojnë të gjitha fushat e rëndësishme për procesin e anëtarësimit, 3. Buxheti kombëtar duhet të reflektojë strategjitë sektoriale dhe të zhvillohet brenda një perspektive afatmesme, idealisht të lidhura për procesin e planifikimit të shpenzimeve kombëtare, 4. Duhet të ketë një proces të formalizuar, të udhëhequr nga qeveria, që përfshin të gjitha palët e interesuara relevante, 5. Ekzistimi i një sistemi të monitorimit me fokus në rezultate dhe që mund të përdoret për të vlerësuar progresin drejt arritjes së objektivave strategjike. (Zyra e Komisionit Evropian në Prishtinë). Vlerësimi erdhi në përfundimin se dy të parat nga pesë kriteret e realizueshmërisë janë përmbushur, dhe nxori këto rekomandime: • Strategjitë sektoriale të Kosovës duhet të mbulojnë të gjithë sektorët e lidhur me acquis (legjislacionin e BE-së) dhe prioritetet e Dokumentit Planifikues Indikativ Shumëvjeçar (MIPD), pasi që aktualisht ka boshllëqe të konsiderueshme në mbulim.

- Cilësia e strategjive ekzistuese ka nevojë të përmirësohet, kryesisht përmes zhvillimit të planeve realiste të veprimit dhe duke shtuar tregues të cilat mund të përdoren për monitorimin e performancës.
- Të gjitha strategjitë sektoriale prioritare duhet të jenë të ndërlidhura me Kornizën afatmesme të Shpenzimeve (KASH) dhe të monitorohen financiarisht nga Ministria e Financave.
- Qeveria duhet të themelojë Njësinë e Planifikimit të Strategjive në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.

⁵⁷ Raporti i Progresit për Kosovën, Bruksel, f. 25, 2010

IPA NË MAQEDONINË E VERIUT

Programet e kuadrit të gjerë për asistencën e IPA-s në Maqedoni përfshijnë këto fusha: Reformën e administratës publike,

- Drejtësinë dhe policinë,
- Përmirësimin e infrastrukturës lokale,
- Ndihmën e vendit për të adoptuar dhe zbatuar legjislacionin dhe standardet e BE-së dhe
- Përgatitjen për zbatimin e politikave të BE-së për kohezion dhe zhvillim rural.

ASISTENCA FINANCIARE E IPA -s (2007-2013) pËr MAQEDONINË E VERIUT							
KOMPONENTI	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
INTITUTUCIONE	41.6	41.1	38.1	36.3	24.5	32.9	27.9
BASHKËPUNIMI RAJONAL	4.1	4	5.5	5.6	5.7	5.9	5.2
ZHVILLIMI RAJONAL	7.4	12.3	20.8	29.4	35	39.4	51.8
RESURSE HUMANE	3.2	6	7.1	8.4	9.4	10.5	11.2
ZHVILLIMI RURAL	2.1	6.7	10.2	12.5	14	19.9	21
TOTALI	58.5	70.2	81.8	92.3	98.7	105.8	117.2

BURIMI: Komisioni Evropian, faqja zyrtare, Bruksel 2013

Tabela nr.14 ndihmesa financiare për Maqedoninë e Veriut

IPa fondet në periudhën 2007 - 2013

VENDI	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
SHQIPËRIA	61	70.7	81.2	94.1	94.4	94.5	95.3
BOSNJA	62.1	74.8	89.1	105.3	107	107.8	63.6
KROACIA	141.2	146	151.2	153.5	156.5	156.1	93.5
MAQEDONIA E VERIUT	58.5	70.2	81.8	91.6	98	101.8	113.2
KOSOVA	68.3	184.7	106.1	67.3	58.7	68.8	71.4
SERBIA	189.2	538.7	566.4	653.7	779.9	860.2	902.9
ISLANDA	0	0	0	0	12	12	5.8
TURQIA	497.2	538.7	566.4	653.7	779.9	860.2	902.9
PROGRAM I SHFRYTËZUAR SHUMË	129.5	137.7	188.8	141.7	186.2	176.2	177.2

Tabela nr. 15

Burimi: ⁵⁸

⁵⁸ PA 2007-2013, Komisioni Evropian, Në dispozicion në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/instruments/overview_en, shikuar më: (12.05.2017).

Nën programin kombëtar të vitit 2007, 9 milionë janë dhënë për të asistuar reformat në polici në nivelin qendror dhe lokal. Projekti për përgatitjen që vlen 3 milionë euro, ka ndihmuar në implementimin më të shpejtë të projekteve dhe në përgatitjen e programeve të ardhshme të IPA-s. Në dhjetor 2007 Komisioni Evropian akordoi 19 milionë euro në kuadër të programit të IPA-s për Zhvillimin Rural që të ndihmojë modernizimin e sektorit të bujqësisë në mënyrë të qëndrueshme në Maqedoni. Po në këtë muaj, Komisioni miratoi programet në vlerë prej 56.8 milionë euro për zhvillimin rajonal (përfshirë transportin dhe mjedisin) dhe zhvillimin e burimeve njerëzore në Maqedoni. Projekti i parë i IPA-s i lansuar në Maqedoni, ka qenë ofrimi i asistencës për zhvillimin e policisë – duke demonstruar rëndësinë që BE-ja i jep reformave të policisë në vend. Ky projekt, me këshillim të vazhdueshëm për policinë në nivel qendror, rajonal dhe lokal, sikur edhe për Ministrinë e Brendshme, është faza e fundit e mbështetjes së gjatë për reformat në drejtësi dhe çështje të brendshme. Edhe një projekt tjetër ka ofruar komunikim të ri për policinë përmes ofrimit të pajisjeve të reja për radio-komunikim.

Komisioni Evropian në vitin 2009 dha rekomandimin e parë për të Këshilli për fillimin e negociatave të pranimit me Maqedoninë. Në Nëntor 2015 Maqedonia mori rekomandimin e shtatë për fillimin e negociatave të pranimit për anëtarësim në Bashkimin Evropian, por të kushtëzuara nga zbatimin e Marrëveshjes së Përzahinos⁵⁹ dhe progresin thelbësor në zbatimin e reformave. Unioni është një partner strategjik tregtar i Maqedonisë me 60% të eksportet e vendit dhe 48% të importeve. Më shumë eksportohen nga Maqedonia produkte, shumica e të cilave janë lidhjeve ferronikel, hekur, çeliku dhe tekstilet. Sa i përket importeve të dominuar nga nafta, elektrike energjia, hekuri i mbështjellë i sheshtë, produktet prej çeliku dhe automjetet. Evropiane Unioni përmes disa programeve të destinuara për ndërmarrjet maqedonase mbështet rritjen ekonomike të vendit. Midis tyre është Programi Kuadër për kërkimin FP7, Programi i Menaxhimit të Qarkullimit të TAB, Dhoma e ndihmë për eksport në vendet evropiane dhe Rrjetin e Ndërmarrjeve në Evropë. Kjo përfshin programin *Njerëzit për Njerëzit*, i cili synon të forcimin e rolit të shoqërisë civile në procesin demokratik dhe Programin Kombëtar IPA i cili siguron mbështetje shtesë për pjesëmarrja në procesin e integritimit në BE dhe zhvillimi i partneriteteve dhe rrjeteve. Në të njëjtën kohë, një program IPA është hartuar për përdorues të shumtë në rregull për të përmbushur nevojat rajonale, përfshirë ato të shoqëria

⁵⁹ Marrëveshja Politike e Përzahinos e 2 qershorit të vitin 2015 është një marrëveshje e arritur nga katër liderët e partive më të mëdha në Maqedoni, Nikola Gruevski, Zoran Zaev, Ali Ahmeti dhe Menduh Thaçi, të ndërmjetësuar nga Komisioneri i Zgjerimit të BE-së Johannes Hahn, Ambasadori i BE-së Aivo Orav dhe Ambasadori i Sh.B.A.-së Jess Bailey. ,e nënshkruar më 2 qershor në rezidencën e Bashkimit Evropian në Shkup. Qëllimi i marrëveshjes është zgjidhja e krizës politike, pas së cilës vendi do të shkojë përpara në rrugën Euro-Atlantike.

civile.⁶⁰ Korniza e parë e kornizën mbulon periudhën në të cilën Maqedonia kishte statusin e një potenciali kandidat për anëtarësim në BE. Kjo do të thotë se ndihma financiare nga BE në ajo periudhë ishte "nxitur nga kërkesa".⁶¹

Pas përvetësimit dhe marrjes së termit Statusi i vendit kandidat dhe struktura e ndihmës financiare kanë ndryshuar të destinuara për Maqedoninë. Kjo do të thoshte më shumë mbështetje për procesin pranimit në Bashkim dhe një theks i intensifikuar në përgatitjen e vendit mbi politikën e kohezionit të BE-së. E rëndësishmja, ndihma është rritur gjithashtu marrë për frymë.

Me një rritje të tillë të ndihmës financiare për Maqedoninë, çështja e domosdoshme u imponua si përparësi aftësia thithëse e tokës në mënyrë që këto të thotë në mënyrë efektive dhe të përdoren në mënyrë efektive. Ndihma e dhënë nga BE për vendet përfituese jepet përmes një procesi programimi ose planifikimi.⁶² Kjo do të thotë se burimet financiare duhet të planifikohen në përputhje me rrethanat proceset e reformave në vend. Fondet nga fondet IPA janë e pakthyeshme dhe varet nga aftësia thithëse e tokës sa dhe nëse ato do të përdoren. Sa më pak që përdoren aq më i vogël është kapaciteti thithës i një vendi dhe anasjelltas aq më shumë përdoren ato aq më shumë ai vend ka një kapacitet më të lartë absorbues dhe aq më i suksesshëm është përdorim i efikas dhe efektiv i fondeve. Do të thotë se një vend nuk do t'i përdorë ato dhe nuk mbetet për më vonë, por ata fondet që ajo humb.⁶³

Duke qenë se në vitin 2013 përfundoi periudha e programimit e cila mbulon IPA 1, dmth është periudha 2007-2013, është një periudhë në bazë të të cilave mund të bëhen analiza dhe mund të dallohen ato kryesore vëzhgime mbi përdorimin e fondeve nga fondet evropiane. Periudha e programimit 2014-2020 që mbulon IPA 2 është duke u zhvilluar, kështu që në këtë pikë është shumë herët për të nxjerrë përfundime përfundimtare në lidhje me ciklin e dytë të Instrumentit për Ndihmën e Para-Anëtarësimit Brenda IPA-s për periudhën 2007-2013 Bashkimi Evropian siguroi 622 milion euro për Maqedoninë, me vendin që ka përfitimet nga Programi rajonal i synuar IPA për më shumë përdoruesit. Në Tabelën 2 tregohen alokimet e fondeve përmes IPA-s 2007-2013 në Maqedoni treguar sipas viteve dhe sipas përbërësve të shprehur në euro.

⁶⁰ Aneta Shuljakova, Doktoratura: <http://www.fikt.uklo.edu.mk/assets/uploads/2017/08/> shikuar më 28.09.2020 ora 11:00

⁶¹ Matlievska M., Zhvillimi i Qëndrueshëm - Paradigma e Re Globale, Fakulteti Ekonomik, Universiteti "Shën Cirili dhe Metodi" - Shkup, (2011), f. 64.

⁶² Qendra Maqedonase për Edukim Evropian, "Ku janë paratë nga IPA 2007-2013", Fondacioni i Shoqërisë së Hapur - Maqedoni, Shkup, (2013), f. 9.

⁶³ CARDS – Community Assistance for Reconstruction, Development and Stabilisation, Ndihma e komunitetit për rindërtimin, zhvillimin dhe stabilizimin.

IPA 2007-2013 NË MAQEDONINË E VERIUT							
MAQEDONIA E VERIUT	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
KOMPONENTI I, NDËRTIMI INTITUCIONAL	41.641. 613	41.122. 001	39.310. 500	36.917. 068	29.403. 410	28.659. 161	27.058. 357
KOMPONENTI II, BASHKËPUNIMI KUFITAR	4.158.3 87	4.077.9 99	4.371.5 01	4.467.5 26	3.583.3 73	50.267. 471	5.093.0 41
KOMPONENTI III, ZHIVILIMI RAJONAL	7.400.0 00	12.300. 000	20.800. 000	29.400. 000	39.300. 000	40.949. 983	50.276. 471
KOMPONENTA E IV RESURSE NJERËZORE	3.200.0 00	6.000.0 00	7.100.0 00	8.400.0 00	8.800.0 00	10.288. 000	10.636. 000
KOMPONENTA E V ZHIVLLIMI RURAL	2.100.0 00	6.700.0 00	10.200. 000	12.500. 000	16.000. 000	17.991. 604	20.157. 606
GJITHSEJ	58.500. 000	70.200. 000	81.782. 001	91.684. 594	98.028. 286	101.472 .121	113.221 .606

Tabela nr 16. Korniza financiare

Burimi: IPA, korniza e reviduar financiarish disa herë në kuadër të vitit 2013, Komisioni Evropian

Sa efektivisht dhe me efikasitet janë përdorur fondet IPA periudha e programimit 2007-2013 mund të analizohet nga aspekti i projektet e rëna dakord në lidhje me ato të programuara dhe të realizuara. Në tabela. tregon një marrëdhënie të tillë në Maqedoni sipas përbërësve. Nga të dhënat në Tabelën. dhe Grafiku mundet vëren një nivel të ulët të shfrytëzimit të fondeve IPA dhe në projekte të përfunduara dhe në vazhdim, dmth ai nivel është rreth 7% në komponenti i pestë deri në 57% në përbërësin e dytë. Si pasojë e përdorim i ulët i fondeve nga komponenti i pestë për zonat rurale zhvillimi i ndjekur nga mundësia e humbjes së fondeve, Komisioni Evropian me kërkesë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë rishpërndarë 18 milion euro nga e pesta në përbërësin e parë. Kjo parashikon diçka të përbashkët menaxhimin e këtyre fondeve nga Komisioni Evropian me Botën bankë, ndërsa kontributi i qeverisë ishte parashikuar të ishte 5 mln kështu që vlera totale e projektit ishte 23 milion euro. Në praktikë, kjo nënkuptonte administrimin e pasurive në vend të kësaj


Agjencia Kombëtare për Mbështetjen e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural menaxhimi i është transferuar Bankës Botërore për projekte në të njëjtin sektor, por në përbërësin e parë. Ky është një hap prapa sepse me fondet në vend që të menaxhojnë institucionet kombëtare, ata menaxhojnë ato ndërkombëtare organizatat.

Tabela: nr 17

Fondet e disponueshme dhe të përdorura nga përbërësit


MJETE E SHFRYTËZUARA: TË KRYERA DHE PREJTET NË PROCES					
EURO	MJETE TË PROGRA MUARA	ME MARRËVE SHJE	PJESËMARRJE ME MARRËVESHJE	TË SHFRYTËZ UARA	PJESËMARRJE ME MJETE
KOMPONENTA 1	244.112.1 10	91.878.188	38%	63.390.658	26%
KOMPONENTA 2	30.276.70 3	17.191.151	57%	2.528.547	25%
KOMPONENTA 3	200.426.5 45	55.846.836	28%	2.769.394	1%
KOMPONENTA 4	54.424.00 0	5.687.182	24%	5.618.101	19%
KOMPONENTA 5	85.649.34 1	5.687.182	7%	5.618.101	7%
GJITHSEJ	614.888.6 08	186.965.954	30%	89.811.284	15%

Tabela nr .18 Burimi, Aneta Shuljakova PHD⁶⁴



Grafikone me përqindje

⁶⁴ Vlerat e lartpërmendura janë nga Komisioni Evropian, Komunikimi nga Komisioni për Parlamentin Evropian dhe instrumentin e Këshillit për ndihmën e para-anëtarësimit (IPA), Kuadri financiar tregues shumëvjeçar i rishikuar për 2012-2013, COM (2011). Vlerat e Programit të Informacionit dhe Komunikimit nuk janë përfshirë në llogaritjen e përdorimit.



Pjesëmarrja kombëtare është e detyrueshme me një përqindje të caktuar të bashkëfinancim në projektet evropiane. Sa kombëtar do të jetë pjesëmarrja varet nga vetë projekti, dmth dispozitat dhe kriteret që janë referojuni asaj. Në Tabelën dhe Figura shfaqet struktura e financimit sipas komponentëve, aty ku mund të shihet dhe pjesëmarrjen kombëtare të Republikës së Maqedonisë sipas përbërësve.

KREU I KATËRT - ASPEKTI I NDIHMËS FINANCIARE

4.1 EFEKTET E PËRKRHAJES FINANCIARE NGA CARDS DHE IPA PËR MAQEDONINË E VERIUT, KOSOVËN DHE SHQIPËRINË

FAZAT E FINANCIMIT NGA IPA Secili program i IPA0-s do të zgjasë deri në pesë vjet. Fazat kyçe në afatin kohor të IPA-s janë:

Programimi,

- Nënshkrimi i marrëveshjes financiare,
- Kontraktimi,
- Implementimi dhe Përfundimi i pagesës.
- Orari zyrtar i IPA-s fillon kur është nënshkruar marrëveshja e financimit vjetor, për shembull, në programin e IPA-s 2009 datat kryesore janë si më poshtë:

Data përfundimtare për të kontraktuar është 24 shtator 2012,

Data përfundimtare për zbatim është 24 shtator 2014,

- Data përfundimtare për pagesë: 24shtator 2015...

4.2 PËRGATITJA E NJË MODELI TË PROJEKTIT TË IPA-s

Për të aplikuar për fonde të IPA-s, puna e parë që duhet bërë është:

- Analiza e nevojave –

Ky është seksioni duhet arsyetuar nevojën për projekt idenë. Duhet të shpjegohet situata aktuale, atë çka nuk është arritur për shkak të kësaj situatë, a duhet situata të ndryshojë që të jetë në përputhje me BE-në dhe strategjinë e Qeverisë?

-Përfshirja në projekt –

Kjo tregon se kush është pala interesuar e cila do të menaxhoj dhe do të drejtoj projektin përpara dhe kush do të përfshihet në këtë projekt? Në këtë pjesë duhet dhënë përgjigje në këto pyetje: Kush është ideatori i këtij projekti? Kush tjetër, për shembull Departamentet e tjera, Agjencitë, organizatat e tjera kanë ndikim në projekt? Shkurtimisht shpjego interesat që njerëzit kanë në projektet

- Objektivat-

Në këtë pjesë duhet dhënë përgjigje çfarë do të ndryshojë ose do të përmirësohet për shkak të projektit?

- Grupi i synuar –

Në këtë pjesë duhet dhënë përgjigje në këto pyetje Përshkruani se kush do të përfitoj nga aktivitetet e projektit?

Përshkruani se kush janë përfitues të projektit dhe të shpjegoni se si ata do të përfitojnë nga aktivitetet e projektit. A ka një grup më të gjerë që po ashtu do të përfitojnë nga aktivitetet e projektit?

- Përcaktimi i instrumentit të IPA-s –

Në këtë fazë duhet të identifikohet cili është lloji kryesor i instrumentit IPA që mund të përdoret - mund të jenë më shumë se një. Në këtë fazë duhet dhënë përgjigje në këto pyetje: Identifiko cili instrument është më i përshtatshmi për të paraqitur komponentët e projektit • tuaj ndërmjet shërbimit, të punëve, furnizimit, një skemë granti ose binjakëzimit? Shpjegoni pse ai është instrumenti më i rëndësishëm dhe llojin e aktiviteteve që do të • furnizohen?

- Afatet kohore –

Këtu përcaktohen të gjitha afatet kohore për hartimin dhe zbatimin e projektit për financim nga IPA. Në këtë fazë duhet dhënë përgjigje në këto pyetje: Cila është data ideale që projekti duhet të fillojë?

- Kohëzgjatja e projektit në muaj?
- Afati kohor ndërmjet programimit dhe fillimit të zbatimit të projektit të IPA.

- Buxheti –

Ekzistojnë dy lloje kryesore të financimit nga IPA: Financimi direkt nga Zyra e Komisionit Evropian.

4.3 MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Monitorimi dhe vlerësimi i projekteve të IPA-s bëhet kryesisht nga Zyra e Komisionit Evropian, por edhe nga misione faktmbledhëse të Bashkimit Evropian. Monitorimin e duhur dhe vlerësimin e programeve dhe projekteve, si nga ana e përfituesve dhe nga Komisioni Evropian, është çelësi për të siguruar rezultatet e dëshiruara ose për përshtatjen e aktiviteteve në mjedisin që

ndryshon me shpejtësi. Nga rezultatet e monitorimit do të varet edhe vazhdimi dhe zgjerimi i fondeve të IPA.

Duke u bazuar në mësimet e nxjerra nga instrumentet e para anëtarësimit CARDS dhe IPA bashkërendimi i donatorëve është jashtëzakonisht i nevojshëm. Duhet të ketë lidhje të qarta për zhvillimit të Kosovës dhe planeve të veprimit, si buxheti dhe Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASh). Zhvillimi i strategjive sektoriale në sektorët kyçë duhet të ndihmojë në identifikimin e nevojave dhe të sigurojë rëndësinë e projekteve. Planifikimi i duhur dhe renditja e asistencës së IPA-s vazhdon të jetë e rëndësishme për të siguruar qëndrueshmëri dhe pronësi. Një raport i sintetizuar i projekteve të financuara nga BE-ja në Kosovë, monitoruar gjatë periudhës 2009 – 2010, i nxjerrë nga vëzhgues të jashtëm në nëntor të vitit 2010, ofron një analizë të përmbledhur të projekteve individuale të IPA-s në vitin 2009 dhe 2010. Ky raport ofron një vlerësim të dobishëm të ecurisë së projekteve të IPA-s në Kosovë dhe zhvillimin e tyre deri më sot. Raporti arrin në përfundimin se në vitin 2010 me rezultatin e përgjithshëm mesatar të projekteve të IPA-s është përmirësuar me 6% dhe se pjesa e 'shumë mirë' dhe 'mirë' e kryerjes së projekteve është rritur me 9,5% në krahasim me vitet e mëparshme. Raporti thekson se veçanërisht efektiviteti i projekteve të IPA-s është përmirësuar. Raporti sugjeron se kjo është për shkak të rezultateve më të mira të projekteve dhe përdorimit të tyre nga përfituesit. Kjo konfirmon që qasja e Komisionit Evropian duke vazhduar të vë theks të veçantë në ndikimin dhe rezultate të prekshme, është duke funksionuar. Raporti konfirmon gjithashtu se edhe pse projekte janë vlerësuar mirë edhe në kategoritë 'relevancë dhe cilësi të projektimit', këto dy kritere kërkojnë më shumë vëmendje. Kjo tregon se më shumë përpjekje janë të nevojshme, si gjatë programimit ashtu edhe gjatë hartimit të termave të referencës.

Për këtë qëllim, Komisioni është duke shqyrtuar vendosjen e një mekanizmi të vlerësimit homolog, në fillim të vitit 2011. Monitorimi i jashtëm ka vlerësuar ndikimin në përgjithësi, apo perspektivën e impaktit të projekteve, ku ndikimi deri më sot ende nuk mund të matet, si 'i mirë'. Kosova duhet të punojë mbi këtë bazë. IPA duhet të përqendrohet në një numër të kufizuar të prioriteteve kyçe, të cilat duhet të harmonizohen ngushtë me agjendën evropiane të Kosovës për reforma dhe të lidhura gjithnjë me strategji sektoriale të përlllogaritura/buxhetuara. Përzgjedhja e projekteve duhet të pasqyrojë planifikim të përmirësuar, krijimin e prioriteteve, rrjedhshmëri, dhe bashkërendim më të mirë me donatorët e tjerë. Mundësia që të lidhen donatorët e tjerë me menaxhimin e IPA-s në fushat ku këto kanë një avantazh krahasues do të shqyrtohet më tej. Pas konferencës së donatorëve në Bruksel, në korrik 2008, pronësia e Kosovës në projektet e IPA-s

duhet të vazhdojë të fuqizohet, dhe koordinimi i donatorëve duhet të marrë parasysh një ulje graduale e pranisë së ndihmës dypalëshe dhe rritje e përqendrimit në efektivitetin e fondeve IPA.

Ndërsa Kosova dhe Maqedonia e Veriut po i afrohen Evropës gjithnjë e më shumë dhe përafrimi me standardet evropiane bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm, duhet të merren parasysh implikimet administrative dhe financiare të përafrimit me Acquis (legjislacionin e BE-së) për administratën e Kosovës. Kapaciteti absorbues i administratës duhet të merret parasysh me rastin e dizajnit të programeve për të përfituar maksimalisht nga ndihma e dhënë, përfshirë kapacitetin e saj për zhvillimin e mekanizmave të brendshëm për vlerësim të kapaciteteve institucionale. Monitorimi i duhur i programeve dhe projekteve, si nga përfituesit ashtu edhe nga Komisioni, është një kërkesë kryesore për të garantuar rezultatet e dëshiruara apo për t'ia përshtatur aktivitetet rrethanave me ecuri të shpejtë.⁶⁵

4.4 KOORDINIMI INSTITUCIONAL PËR PROJEKTET E IPA-s

Komisioni Evropian, përfituesit e IPA-s, shtetet anëtare të BE-së dhe donatorë të tjerë janë pajtuar se ka nevojë për një ndryshim në qasjen ndaj planifikimit dhe programimit të asistencës IPA, pra duhet lëvizur nga qasja e bazuar në projekte drejt një qasjeje me bazë sektoriale ose programore. Në prill të vitit 2010, Komisioni Evropian ka informuar autoritetet e Kosovës, si dhe Shtetet Anëtare të BE dhe donatorë të tjerë të pranishëm në Kosovë, në lidhje me rishikimin e qasjes së tij planifikuese dhe ka ftuar palët e interesuara për kontributin e tyre. Në qershor të vitit 2010, palët e interesuara janë ftuar për të komentuar një draft të parë të këtij MIPD. Palët e interesuara janë konsultuar përsëri në nëntor 2010. Në përgjithësi, komentet e palëve të tjera të interesuara kanë treguar një dakordim të gjerë mbi prioritetet e ardhshme të IPA-s në Maqedoninë e Veriut.

Të gjitha komentet, analizat përfshirë kryesisht ato nga vetë administrata e Kosovës, por edhe shtetet anëtare të BE-së dhe shoqëria civile, janë marrë plotësisht në konsideratë në hartimin e këtij MIPD. Me qëllim të ristrukturimit të përpjekjeve të Maqedonisë së Veriut dhe donatorëve, dhe kështu për të përmirësuar efektivitetin dhe impaktin e programeve në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni qeveritë kanë vendosur të fillojnë një qasje të bazuar në sektorë në planifikimin dhe zbatimin e asistencës. Ministria e Integritit Evropian dhe donatorët janë pajtuar për të ngritur një

⁶⁵ MIE, Faqja zyrtare, Prishtinë, 2013, shikuar më 26.11.2020

mekanizëm, i cili konstrukton ndërveprimin në kuadër të Qeverisë së Kosovës, si dhe në raport me donatorët. Ky mekanizëm ka këto objektiva:

- Krijimin e një forumi, ku administrata e Kosovës së bashku me komunitetin e donatorëve të mund të diskutojnë fushat prioritare për mbështetje në përputhje me Planin e Veprimit për Partneritet Evropian (PVPE), KASH-in dhe dokumentet e tjera kyçe strategjike të Qeverisë;

- Përmirësimin e aktiviteteve mbështetëse për Kosovën në mesin e komunitetit të donatorëve për të shmangur mbivendosjen dhe/ose duplikimin e aktiviteteve;
- Mundësimin e shfrytëzimit optimal të burimeve të pakta (njerëzore dhe financiare) që janë në dispozicion në Kosovë dhe për Kosovën. Kosova ka ngritur një Platformë për Administrimin e Ndhmës së Jashtme, me mbështetjen e komunitetit të donatorëve, veçanërisht Komisionit Evropian dhe SHBA-së.

Kjo iniciativë do të përmirësojë menaxhimin dhe koordinimin e ndihmave, për të lehtësuar ndërlidhjen në mes të ndihmës së donatorëve dhe Planit të Veprimit për Partneritet Evropian (PVPE), për të përmirësuar harmonizimin e PVPE-së me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH), për të reduktuar kostot e transaksioneve në mbledhjen dhe raportimin për ndihmën e donatorëve, për të përmirësuar shtrirjen e asistencës së donatorëve për strategjitë sektoriale të Qeverisë, dhe për të ofruar informata të përditësuara dhe në dispozicion të publikut për aktivitetet e ndihmës së planifikuar dhe në vazhdim. Deklarata e Komisionit Evropian mbi Strategjinë e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2007- 2008 dhe dokumentet relevante strategjike (2008, 2009, 2010, 2011, 2012) kanë theksuar rëndësinë e mundësisë që shoqëria civile të luajë rolin e saj në një demokraci pjesëmarrëse.

“Instrumenti i Shoqërisë Civile“ (*Civil Society Facility - CSF*), financuar si nga IPA me shumë përfitues ashtu edhe programet vjetore të IPA-s, është krijuar si mjet për të mbështetur financiarisht zhvillimin e shoqërisë civile. CSF-ja përfshin veprime për të forcuar lirinë e shprehjes, pasi që kjo paraqet një parakusht themelor për një demokraci funksionale. Duhet vendosur kornizë të përshtatshme ligjor që t’u mundësojë mediave të veprojnë lirisht. Një rrjet i tryezave të asistencës teknike (TACSO) është themeluar në Ballkanin Perëndimor. Ky rrjet është funksionalizuar në vjeshtë të vitit 2009. Gjithashtu janë themeluar Grupet Këshillëdhënëse Vendore, të përbërë nga përfaqësuesit e delegacioneve të BE-së, qeverive, shoqërisë civile dhe donatorë të tjerë.⁶⁶

⁶⁶ MIE, faqja zyrtare, Prishtinë, 2013

Duhet të demonstrohen rezultate konkrete në luftën kundër korrupsionit, pastrimit të parave dhe krimit të organizuar. Kosova gjithashtu duhet të forcojë kapacitetet, pavarësinë dhe profesionalizmin e administratës publike dhe të përmirësojë mjedisin e saj biznesor. Të gjitha këto prioritete janë vendosur edhe sektorë prioritar për financim nga IPA. Sipas Komisionit Evropian, Kosova ka nevojë të krijojë një politikë të qëndrueshme makro-ekonomike dhe fiskale. Reforma dhe investime të konsiderueshme duhet të ndiqen për të mundësuar në plan afatgjatë përballimin e presionit konkurrues dhe forcat e tregut brenda BE-së. Progresi në përafrimin e legjislacionit dhe politikave të Kosovës me standardet evropiane është e përzier. Korniza ligjore është zhvilluar më tej në disa fusha, por në fusha të tjera është akoma në një fazë të hershme. Zbatimi i standardeve evropiane mbetet i kufizuar. Komunikata e Komisionit “Kosova - përmbushja e perspektivës evropiane”, nxjerr në pah prioritetet për Kosovën për të siguruar progres në agjendën e saj evropiane të reformave dhe identifikon masat që BE-ja mund të ndërmarrë për të ndihmuar në këtë. Komisioni ka propozuar një numër masash për të avancuar marrëdhëniet BE – Kosovë.

Është propozuar të ecet përpara me një qasje të strukturuar drejt liberalizimit të vizave, për të zgjeruar Masat Autonome Tregtare dhe për të propozuar direktivat negociuese për një marrëveshje tregtare pasi që Kosova t’i përmbushë kërkesat përkatëse, për të shqyrtuar mundësinë që Kosova të marrë pjesë në programet e BE-së për ‘*Kulturë dhe Evropa për Qytetarët*’, dhe që të lidhen me iniciativat e BE-së në fusha si punësimi, arsimit, ndërmarrësia dhe rinia. Gjithashtu, është propozuar të avancohet dialogu politik me Kosovën dhe të zgjerohet fushëveprimi i asistencës financiare për Kosovën, të përfshihet nën komponentin e dytë të IPAs – bashkëpunimi ndërkufitar. Këshilli i BE-së ka marrë parasysh propozimet për të mundësuar shfrytëzimin e instrumenteve të Komunitetit për të ndihmuar zhvillimin politik dhe socio-ekonomik të Kosovës, në harmoni me konkluzionet Këshillit Evropian të dhjetorit 2007 dhe qershorit 2008. Këshilli i BE-së ka theksuar rëndësinë e masave lidhur me vizat dhe tregtinë, pa paragjykuar qëndrimet e Shteteve Anëtare për statusin. Ata e kanë inkurajohet Komisioni për të hapur mundësitë për Kosovën të marrë pjesë në programet e BE, integrimin e Kosovës në kornizën e mbikëqyrjes ekonomike dhe fiskale, aktivizimin e komponentit të dytë të IPA-s dhe fuqizimin e Dialogut të Procesit të Stabilizim-Asociimit, në vazhden e konkluzioneve të Këshillit për Çështje të Përgjithshme, të datës 8 dhjetor 2009.⁶⁷

⁶⁷ ZNKE, Prishtinë 2013

PËRFUNDIMI

Në këtë punim në nivel të temës së magjistraturës u përqendruam tek efektet e ndihmesave nga BE-ja, tek ekzaminimi i aftësisë së Republikës së Maqedonisë që në mënyrë efektive dhe të përdorin në mënyrë efektive mbështetjen financiare nga Bashkimi Evropian, që është, tek testimi i kapacitetit thithës për t'u përdorur Fondet evropiane. Në këtë drejtim, u bë një përpjekje e madhe shkencore për t'u lidhur teoria shkencore e politikës së kohezionit me zbatimin praktik të parimet moderne të menaxhimit të fondeve evropiane në qeveritë lokale në Republikën e Maqedonisë, Kosovës dhe Shqipërisë.

Përfundimet që dalin nga ky studim janë disa shosh: na aspekt të tri shteteve synimet kryesore të IPA-s nuk dallojnë shumë nga një vend në tjetrin. E para si në Maqedoninë e Veriut, Kosovë dhe Shqipëri synimet e IPA-s janë këto:

Forcimin e institucioneve demokratike,

- Intensifikimin e reformave administrative dhe ekonomike,
- Promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore,
- Përmirësimin e respektit për të drejtat e minoriteteve dhe
- Zhvillimin e shoqërisë civile.

Theksuam në detaje se komponentat e IPA-s janë këto:

Ndihma në tranzicionit dhe ndërtimin e institucioneve,

- Bashkëpunimi ndër-kufitar,
- Zhvillimi rajonal, • Zhvillimi i resurseve njerëzore dhe
- Zhvillimi rural.

Janë gjithsejtë 8 vende në të cilat aplikohet IPA: ato janë: Kosova, Shqipëria, Kroacia, Maqedonia, Turqia, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia. Kjo është e fati i përbashkët këtyre shteteve në aspekt të marrjes së ndihmesës financiare.

Mund të japim përfundim se definitivisht Bashkimi Evropian i kushton rëndësi të madhe ruajtjes së mjedisit, prandaj në përputhje me Strategjinë Evropë 2020, Kosova gjithashtu duhet të sigurojë që sfidat lidhur me ndryshimin klimatike të adresohen, në veçanti duke ulur intensitetin e liritimit të gazrave ndotës gjatë zhvillimit të saj ekonomik, Shqipëria dhe Maqedonia duhet të pastrojnë gjyqësinë e kësisoj rrjetin korruptim të ndërlidhur shpesh me keqpërdorimet e fondeve evropiane. Këto dy shtete marrin notë negative pikërisht për shkak të rrjetit korruptim dhe

keqmenaxhimit. Konstatohet me bindje të thellë se synimet që kanë të bëjnë me uljen e ndotjeve dhe zvogëlimin e emetimit të gazrave ndotës do të merren parasysh në të gjithë sektorët relevantë, në veçanti në sektorët e transportit, energjisë, mjedisit dhe bujqësisë. Për më tepër, e gjithë ndihma financiare duhet të jetë në përputhje me parimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe për të përmbushur kërkesat e legjislacionit të BE-së (acquis) përkatëse nga fusha e mjedisit dhe klimës.

68

REKOMANDIMET

IPA II 2014-2020? Maqedonia e Veriut tashmë përfituese e asistencës financiare të Komisionit Evropian IPA ka përfituar mjaft dhe për periudhën 2007-2013. Kosova ka përfituar rreth 605.4 milion euro dhe nën menaxhimin direkt të Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Prishtinë konsiderohet se Kosova ka bërë një progres të mirë në implementimin e IPA-s. Megjithatë ende mbetet shumë për tu bërë në RMV, sidomos në forcimin e strukturave ligjore, menaxhuese dhe për IPA II sugjerohet që të kihen parasysh rekomandimet e mëposhtme:

1. Koordinim më i mirë I IPA-s me donator të tjerë sidomos në investimet dhe zhvillimin e sektorëve konkurrues për RMV-në siç janë sektori i energjisë dhe bujqësisë,
2. Forcimi i përvetësimit dhe zotërimit të projekteve të IPA-s nga pala RMV-ja,
3. Rritja dhe shtimi i projekteve dhe bashkëpunimeve ndër-kufitare me qëllim pajtimin dhe forcimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë e sidomos me Bullgarinë,
4. Vazhdimi i forcimit dhe zhvillimeve politike dhe socio-ekonomike të RMV-së sidomos për përmbushjen e standardeve dhe kritereve për arritjen e Marrëveshje së Stabilizim- Asociimit,
5. Përkrahja e liberalizimit të vizave,
6. Zgjerimin e Masave Tregtare dhe nënshkrimin e marrëveshjeve tregtare dhe
7. Vazhdimi i përkrahjes financiare dhe asistencës teknike për zhvillimin dhe implementimin e projekteve zhvillimore në politikë, ekonomi dhe vendosje të rendit dhe ligjit.

Rekomandimet për menaxhimin e IPA II (2014-2020) në Maqedonia e Veriut duhet: Koordinim më i mirë i IPA-s me donator të tjerë sidomos në investimet dhe zhvillimin

- e sektorëve konkurrues për Kosovën siç janë sektori i energjisë dhe bujqësisë, Forcimi i kapaciteteve vendore për përvetësimin dhe zotërimin e projekteve të IPA-s,

- Rritja dhe shtimi i projekteve dhe bashkëpunimeve ndër-kufitare me qëllim pajtimin

⁶⁸ (europa.eu), shikuar më 28.11.2020

- dhe forcimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, Vazhdimi i forcimit dhe zhvillimeve politike dhe socio-ekonomike të Kosovës

- sidomos për përmbushjen e standardeve dhe kritereve për arritjen e Marrëveshje së Stabilizim-Asociimit, Përkrahja e projekteve që shpejtojnë procesin e liberalizimit të vizave,

- Zgjerimin e Masave Tregtare dhe nënshkrimin e marrëveshjeve tregtare me BE-në

- dhe vendet anëtare të saj dhe Vazhdimi i përkrahjes financiare dhe asistencës teknike për zhvillimin dhe

- implementimin e projekteve zhvillimore në administratë publike, ekonomi dhe vendosje të rendit e ligjit.

Njohja e përparësive kombëtare të zhvillimit, zhvillimit përparësitë e rajonit, përparësitë për të cilat ka Bashkimi Evropian zhvillimin e vendit, përparësitë për të cilat ka Bashkimi Evropian rajoni, qëllimet e mijëvjeçarit dhe përparësitë e zhvillimit për vendin e të tjerëve donatorët është një përcaktues i rëndësishëm i përdorimit të fondeve evropiane. Në fund mund të them se për suksesin e punës së projektit të komunës është shumë e rëndësishme që të mbajë dëgjime publike mbi strategjitë, planet e veprimit dhe identifikimi dhe zhvillimi i projektit. Duhet të bëhet në formë e organizuar dhe në intervale më të shpeshta. Duke përfshirë publikun përmes këtyre dëgjimeve publike, informacion në lidhje me nevojat dhe përparësitë që duhen adresuar përmes projekteve. Strategjitë, planet e veprimit dhe projektet e komunave duhet të jenë pasqyrojnë situatën reale dhe nevojat në komunë, për të mos qenë të tilla shkruar nga zyra..

BIBLIOGRAFIA

Libra:

1. A.Etem, M. Nazmi dhe P. Ali – “Proceset e Integritit Euroatlantik dhe Republika e Maqedonisë Tetovë, 2008
2. A.Maite, C. Ana & O. Vicente- “EU Enlargement and Inëard FDI”, 2016, Castellón
3. A.Abdulla. – “Bashkimi Evropian, e drejta , institucionet dhe politika”, Tetovë, 2010
4. B.Edmond, prof.as – “Sistemi Evropian për transfer të kredive” Prishtinë 2002
5. B.Tanja and H. Vera- “Good Governance and Bad Neighbors?” 2011, Berlin
6. D. François - “Politikat Bashkimit Evropian” koleksioni, “Evropa” 2007
7. D. Maurice – “Bashkimi Evropian ne shekullin e XXI, institucionet Ekonomike”, 2001
8. D.Rory Domm – “Next steps on Bosnia-Herzegovina: key elements to a revised EU strategy”, 2011, Sarajevo
9. D.Yves dhe L. Christian – “Institucionet e Bashkimit Evropian”, botimi i 5 Tiranë, 2017
10. Department of Economic Policy, Finance And Development- “EU enlargement and theories of economic integration”, 2010, Siena
11. E.Arolda – “EU enlargement in the Western Balkans: strategies of borrowing and inventing”, 2008, Berlin
12. F.Zlatan- “Road to EU: Enlargement and Competitiveness of Ëestern Balkan Companies”, Zagreb, 2005
13. G.José Luis Gallizo, S. Ramon & S.Manuel- “Financial Convergence in Transition Economies: EU Enlargement”, 2010, Zaragoza
14. Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave Seria e analizave politike – “Kosova dhe kapacitetet e saja për integrim në BE”, 2016 Prishtinë
15. K.Ahmet, “EU Pre-Accession Instruments: Development Of Absorption Capacities In Kosovo”, Prishtina, 2008
16. L.Simon, - “Enlargement and the Challenge of EU Development Policy”, 2008, Leeds
17. M. Paskal - “Bashkimi Evropian” (ideja, integrimi, identiteti dhe e ardhmja), Tiranë, 2012
18. M.Ani & G. Panagiotis- Administrative convergence and reforms in South-Eastern European States”, 2011, Budapest
19. M.Helena Marques – “Trade and factor floës in a diverse EU: What lessons for the Eastern Enlargement(s)?” 2008, Manchester

20. M.Mojmir, T. Dragan, “Absorption for EU Pre-Accession Funds: Concept and Implications for Kosovo, 2008
21. Office of the Committee For European Integration, “Pre-Accession Funds Polish Experiences”, Warszawa, 2012
22. P.Anca – “Visualising the EU: the Central and East European Enlargement Experience”, 2008
24. P.David – “From Negotiations to Accession”, 2007, Belfast
25. R. Blerim – “Gjeopolitika dhe teknika e zgjerimit te UE-së”, Bruksel, 2015
26. S. Nasir – “Biznesi Ndërkombëtarë”, Shkup, 2015
27. V.Lidia – “The European Union Enlargement Process: Culture in between National Policies and European Priorities”, 2007, Philadelphia
28. Volk, Tina- “Agriculture in the Western Balkan countries”, Brussels, 2016
29. Eastern Balkans – Filand’s Development Policy Framework Program for the years 2009-2013”, 2009

Revista shkencore, raporte

1. Balkan and Near Eastern Studies- Journal, London, 2016
2. EU Information and cultural centre and EU Kosovo Relations, January , 2014
5. European Commission, “Annual Programme for Kosovo under the IPA Transition Assistance and Institution Building Component for 2014”, Brussels 2014.
6. European Commission, “Instrument for Pre-Accession Assistance (IPA) Revised Multi-Annual Indicative Financial Framework for 2016”, Brussels 2016
7. European Commission, “The Multi-Country Strategy Paper and the Territorial Cooperation Strategy Paper” Brussels 2013
8. Përgatitur nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile(FKSHC) – “Analiza e Shoqërisë Civile ne Maqedoni” Prishtinë, 2015
10. Zgjerimi i BE, Maqedoni “Raporti i Progresit dhe Konkluzionet”, Bruksel, 2011
11. Zyra e botimeve zyrtare e Komuniteteve Evropiane “Lufta për ndryshimin e klimës UE-j trason rrugën”, Luksemburg, 2008.
- 12.Компонента 5 – Рурален развој, Секретаријат за европски прашања, Достапно на: <http://www.sea.gov.mk/Default.aspx?ContentID=82>, Пристапено: (27.04.2013).
13. Kosovo in the stabilization and association process, Kosovar Civil Society Foundation, Достапно на: <http://www.kcsfoundation.org/?page=2,111#.WP0bDUWGNdi>, Пристапено: (12.05.2017)

14. Managing projects, Planning of Project Coordination, European Commission, Достапно на: http://ec.europa.eu/chafea/management/Fact_sheet_2010_04.html, Пристапено: (7.06.2017).
15. Multi-annual Indicative Planning Document (MIPD) 2011-2013, Достапно на: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/mipd_fyrom_2011_2013_en.pdf, Пристапено: 22.05.2017.
16. Национална програма - К1, Секретаријат за европски прашања, Достапно на: <http://www.sea.gov.mk/Default.aspx?ContentID=77>, Пристапено: (27.04.2013)
17. Планирање и програмирање на ИПА помошта за периодот 2014-2020 (ИПА II), Секретаријат за европски прашања, Достапно на: <http://www.sep.gov.mk/content/?id=154#.VqfNxJorJdh>, Пристапено: (30.01.2017)
18. Повеќегодишна индикативна финансиска рамка 2007-2013 за Република Македонија (Достапно на: http://www.aaipa.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=62&Itemid=483&lang=mk, пристапено на: 20.01.2017)
19. Tonnisson K., The applicability of neë public management principles in Estonian local government, University of Tartu, (2006).
20. Темјановски Р. (2005), Искористување на ИПА фондовите за постигнување на рамномерен економски и социјален развој, со посебен осврт на транспортната политика на РМ, стр.12.
- A. 21. The efficient use of funds for local and regional authorities under the IPA-II regulation, Aston Centre for Europe, Aston University, UK, (2014).

BURIMET E REFERIMIT

1. A.Maite, C. Ana & O. Vicente- “EU Enlargement and Inëard FDI”, 2008, Castellón
2. E.Arolda – “EU enlargement in the western Balkans: strategies of borrowing and inventing”, 2008, Berlin
3. F.Zlatan- “Road to EU: Enlargement and Competitiveness of ëestern Balkan Companies”, Zagreb, 2005
4. G.José Luis Gallizo, S. Ramon & S.Manuel- “Financial Convergence in Transition Economies: EU Enlargement”, 2010, Zaragoza
5. M.Mojmir, T. Dragan, “Absorption for EU Pre-Accession Funds: Concept and Implications for Kosovo, 2008

6. P.Anca – “Visualising the EU: the Central and East European Enlargement Experience”, 2008
7. V.Lidia – “The European Union Enlargement Process: Culture in between National Policies and European Priorities”, 2007, Philadelphia
- 22.Uzunov V., The absorption capacity of the Republic of Macedonia for utilization of IPA funds, The use of EU funds in Macedonia, European Policy Institute, (2012).
- 23.User Guide - Methodology for the assessment of capacity of municipalities in Turkey & the western Balkans to absorb EU IPA funding, Annex 1: The questions at a glance, (2008).
- 24.Упатство за внатрешни процедури за имплементација на проекти од крајните приматели/корисници од ИПА компонента 1, Министерство за труд и социјална политика, (2014)
25. Atanasova G., Bache I. , Europeanization and FYR Macedonia: towards a compound polity?, Southeast European and Black Sea Studies, (2010)
26. Флориана Н. ЕЦАС, Белгија; Практичен прирачник за партнерство; МЦМС. (2006)
27. Извештај на Европската Комисија за Албанија, (2016), стр.89.

PËRMBAJTJA

ABSTRAKTI.....	3
HYRJE DHE QASJA TEORIKE	4
SHTRIMI I PROBLEMIT.....	9
QËLLIMI I STUDIMIT	111
HIPOTEZA / HIPOTEZAT E PUNIMIT	122
PYETJET KERKIMORE TE PUNIMIT	12
METODAT DHE METODOLOGJIA E KËRKIMIT	12
MUNDËSITË DHE KUFIZIMET.....	13
RËNDËSIA E STUDIMIT.....	14
KREU I.....	14
1.1 IPA - PROGRAMI DHE PËRKRAHJA FINACIARE NË BALLKANIN PERËNDIMOR	14
1.2 Çka është IPA?.....	17
1.3 Fusha e financimit nga IPA	22
1.4 Qëllimi i IPA-s	24
1.5 Puna e IPA-s	25
1.6 Përparësitë e IPA-s.....	25
KREU I DYTË– PROGRAMET DHE NDIHESA FINANCIARE	27
2.1 PHARE- PROGRAMI I PARANËTARËSIMIT PËR MAQEDONISË E VERIUT.....	27
2.2 ISPA- PROGRAMI I PARANËTARËSIMIT PËR MAQEDONINË E VERIUT	38
2.3 SAPARD- PROGRAMI I PARANËTARËSIMIT PËR MAQEDONINË E VERIUT ...	40
2.4 CARDS- PROGRAMI I PARANËTARËSIMIT PËR MAQEDONINË E VERIUT.....	42
KREU I TRETË – IPA NË BALLKAN	43
3.1 IPA - PROGRAMI DHE SHTRIRJA E SAJ NË BALLKAN, KOSOVË DHE SHQIPËRI43	
3.1.1 IPA NË SHQIPËRI – VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM	43
IPA NË SHQIPËRI.....	43
3.2 IPA NË KOSOVË – VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM.....	57
3.2.1 PËRKRAHJA FINANCIARE NË KOSOVË PËRMES PROGRAMIT IPA	Error!
Bookmark not defined.	
3.3 PROGRAMET KRYESORE TË BE-SË NË KOSOVË.....	60
3.3.1 Përkrahja e BE-së për Kosovën në vitin 1999	60
3.3.2 Përkrahja e BE-së për Kosovën në vitin 2000	61
3.3.3 Përkrahja e BE-së për Kosovën në vitin 2001	61
3.3.4 Përkrahja e BE-së për Kosovën në vitin 2002	61
3.3.6 Përkrahja e BE-së për Kosovën në vitin 2004	62
3.3.7 Përkrahja e BE-së për Kosovën në vitin 2005	62
3.3.8 1`Përkrahja e BE-së për Kosovën në vitin 2006	62
3.3.9 Përkrahja e BE-së për Kosovën në vitet 2007-2013.....	63
IPA NË MAQEDONI NË E VERIUT	71
KREU I KATËRT - ASPEKTIN I NDIHMËS FINANCIARE	71
4.1 EFEKTET E PËRKRAHJES FINANCIARE NGA CARDS DHE IPA PËR MAQEDONINË E VERIUT, KOSOVËN DHE SHQIPËRINË	71
4.2 PËRGATITJA E NJË MODELI TË PROJEKTIT TË IPA-s.....	71
4.3 MONITORIMI DHE VLERËSIMI	72
4.4 KOORDINIMI INSTITUCIONAL PËR PROJEKTET E IPA-s	74
PËRFUNDIMI	77

REKOMANDIMET	78
BIBLIOGRAFIA	80
BURIMET E REFERIMIT.....	82
PËRMBAJTJA.....	84